

FJALA E GVERNATORIT

Në përmbushje të detyrave ligjore dhe siç është bërë tashmë traditë, Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 2001 paraqet zhvillimet e detajuara të ekonomisë shqiptare; monetare; të çmimeve të konsumit; të sektorit bankar etj.. Raporti Vjetor, gjithashtu, i shërben Bankës së Shqipërisë për të bërë publike qëndrimet e saj në lidhje me jetën ekonomike dhe financiare të vendit.

Në vitin 2001, Shqipëria mbushi 10 vjet të anëtarësimit të saj në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore. Për këtë ngjarje, Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë organizuan një konferencë të përbashkët ku u analizua rruga e zhvillimit të Shqipërisë në këto dhjetë vjet, reformat e zhvilluara si dhe sfidat që e presin atë në të ardhmen deri në përmbushjen e objektivit të saj, integrimin në Bashkimin Europian.

Gjatë këtij viti, 12 vendet anëtare të Bashkimit Monetar Europian u përgatitën për zëvendësimin e monedhave të tyre me monedhën më të re, euro. Shqipëria, duke qenë vend europian dhe duke patur lidhje të ngushta tregtare me Bashkimin Europian, gjithashtu, u përfshi në këtë fazë përgatitore. Synimi i vetëm ishte që të shmangej çdo shenjë paniku dhe që monedha e re të pritej sa më natyrshëm. Tashmë që procesi ka përfunduar mund të themi se Banka e Shqipërisë e drejtoi mirë dhe pa probleme këtë proces.

Viti 2001 ishte i katërti vit rradhazi gjatë të cilit programi i zhvillimit ekonomik të vendit u respektua në tërësinë e tij. Për këtë vit, autoritetet përkatëse kanë vlerësuar që rritja ekonomike të ketë arritur 7.3 për qind. Rritja e ekonomisë i dedikohet kryesisht gjallërimit të sektorit privat të ekonomisë, ndërkohë që sektori shtetëror po tkurret si pasojë e privatizimeve dhe likuidimeve. Po kështu, rritja e investimeve publike, sidomos në tremujorin e dytë të vitit, vlerësohet të ketë dhënë ndikim të ndjeshëm në gjallërimin ekonomik. Eksportet u rritën me 19.4 për qind dhe në këtë rritje ka kontribuar edhe rritja e eksporteve nga prodhimi i brendshëm me 8 për qind. Importet janë rritur me 23.7 për qind, duke çuar në thellimin e deficitit tregtar. Megjithatë, pozitiv është fakti që janë rritur importet e makinerive dhe pajisjeve. Këto të fundit përbëjnë rreth 18 për qind të totalit të importeve gjithsej.

Si pasojë e rritjes ekonomike të vendit, ku kontributin kryesor e ka dhënë sektori privat, por edhe prej rritjes së investimeve publike, janë krijuar vende të reja pune. Numri i të punësuarve ka arritur në 1.07 milionë vetë ose 0.9 për qind më shumë se një vit më parë. Nga ana tjetër, shkalla e papunësisë është ulur në 14.4 për qind nga 16.9 për qind që ishte në fund të vitit 2000.

Deficiti i llogarisë korente është rritur më tej (me 54 për qind ose 6.1 për qind e PBB-së) gjatë vitit 2001, si pasojë kryesisht e thellimit të deficitit tregtar. Financimi i llogarisë korente është mundësuar nga rritja e dërgesave të emigrantëve si dhe nga hyrjet e larta kapitale. Megjithatë, ky deficit vlerësohet të jetë rreth 18.8 për qind më i ulët se parashikimi. Ndërkohë, dërgesat e emigrantëve vlerësohen rreth 615 milionë dollarë amerikanë ndërsa investimet e huaja direkte për këtë vit, rreth 220 milionë dollarë amerikanë.

Inflacioni arriti në fund të vitit nivelin 3.5 për qind, duke respektuar objektivin e vitit 2001. Objektivi i Bankës së Shqipërisë është që në periudhë afatmesme të mbajë inflacionin mesatarisht në nivelin 3 për qind. Për të arritur këtë objektiv Banka e Shqipërisë mbështetet në dy shtylla kryesore: *normën e rritjes së ofertës së parasë dhe treguesit ekonomikë e financiarë*.

Duke ditur që inflacioni është kryesisht një fenomen monetar, ndjekja e ecurisë së rritjes së ofertës monetare ndikon edhe në respektimin ose jo të objektivit për inflacionin. Rritja e ofertës monetare përfaqëson objektivin e ndërmjetëm për Bankën e Shqipërisë dhe për të caktohet çdo vit dhe një nivel sasior orientues. Në vitin 2001, oferta monetare u rrit me 19.9 për qind duke e tejkaluar objektivin e vendosur për të. Megjithatë, inflacioni u arrit të kontrollohej. Kjo ndodhi për arsye se rritja e faktuar e këtij agregati u shkaktua edhe si pasojë e veprimit të ngjarjeve të veçanta, ku si më të spikatur mund të përmendim prezantimin fizik të euros dhe ngjarjet që shoqëruan këtë proces.

Inflacioni, sidomos për ekonomi si Shqipëria që janë ende nën ndikimin e rregullimeve strukturore, shkaktohet edhe nga fenomene të natyrës *shock*. Detyra e bankës qendrore është që t'i paraprijë, sa më shumë të jetë e mundur, të tilla ngjarjeve. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë bazohet edhe në një grup treguesish ekonomikë e financiarë, të cilët mund të ofrojnë sinjale mbi presione të mundshme inflacioniste. Në këtë grup treguesish përfshihen ecuria e kursit të këmbimit, rritja e ekonomisë, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë, zhvillimet në ekonomitë e vendeve të tjera, me të cilat është më e integruar ekonomia e vendit e deri tek faktorët e natyrës psikologjike, të krizës politike, madje edhe në rezultatet e vrojtimeve të kryera nga vetë Banka e Shqipërisë, të cilat e ndihmojnë në të kuptuarin më të mirë të fenomeneve ekonomike e financiare.

Në përgjigje të këtyre sinjaleve Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2001, vlerësoi se përfundoi periudha e deflacionit dhe vendi ka hyrë në fazën e zhvillimeve me inflacion pozitiv. Për këtë arsye ajo reagoi dy herë, duke ndërruar llojin e ankandit të repove dhe më pas duke rritur me 0.5 pikë përqindjeje normën e repove, për të frenuar reduktimin e normave të interesit në ekonomi. Këto veprime ndikuan deri-diku në zbutjen e presioneve inflacioniste në ekonomi.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë vlerëson që duhet të rrisë shkallën e kujdesit në lidhje me zhvillimet e çmimeve të konsumit në vend. Një sërë faktorësh dhe

ngjarjesh kanë krijuar probleme. Më të spikaturat dhe shumë të trajtuara janë kriza energjitike në vend, ndikimi që pati dhe që ende nuk mund të quhet i kapërcyer, i krizës politike, moti i keq etj..

Në përfundim duhet të theksoj, që pavarësisht nga përmirësimi i treguesve, reforma e sistemit bankar nuk eci me ritme tepër të kënaqshme. Ky vlerësim lidhet drejtpërdrejt me shtyrjen e procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve si dhe me nevojën për të zëvendësuar pronarin e Bankës Kombëtare Tregtare. Të dyja përfaqësojnë bankat më të mëdha të sistemit bankar dhe problemet që po shoqërojnë pronësinë e tyre, për fat të keq, do të ndikojnë në ecurinë e reformës së sistemit bankar dhe në gjallërimin më tej të aktivitetit të tij. Këto çështje domosdoshmërisht kërkojnë një vëmendje të plotë nga autoritetet përkatëse. Ndërkohë, diskutimi dhe miratimi së shpejti i ligjit për sigurimin e depozitave është një hap pozitiv në drejtim të rritjes së mëtejshme të sigurisë së depozituesve dhe që do të ndihmojë edhe në rritjen e besimit në sistemin bankar.

Shkëlqim Cani
Guvernator

KAPITULLI I – EKONOMIA BOTËRORE


I.1. ZHVILLIMET NË EKONOMINË BOTËRORE GJATË VITIT 2001

Ekonomia botërore gjatë vitit 2001 u përball me një ngadalësim të përgjithshëm të rritjes së saj. Dilemat dhe sfidat që qëndronin përballë ekonomive më të zhvilluara të globit, të cilat shërbejnë si motor për ekonominë botërore u shtuan edhe më tej pas sulmit të 11 shtatorit në SHBA. Kjo datë ndau zhvillimet ekonomike në dy periudha. Qëllimi ishte i njëjtë, të sigurohej rritje ekonomike e kënaqshme. Mjetet dhe intensiteti i veprimit me to ndryshuan. Pas 11 shtatorit autoritetet duhet të merrnin masa edhe për frenimin e përhapjes së panikut dhe ruajtjen e besimit të tregjeve.

I.1.1. Ekonomia botërore gjatë gjysmës së parë të vitit 2001

Nevoja për rishikimin e parashikimeve për rritjen e ekonomisë botërore lindi që në pjesën e parë të vitit 2001, si pasojë e ngadalësimit të theksuar të ekonomisë amerikane, e pamundësisë për rimëkëmbje të ekonomisë japoneze dhe e rritjes modeste të ekonomisë europiane. Mendimi i përhapur ishte se rritja e shpejtë e ekonomisë botërore gjatë viteve 1999 dhe 2000 do të zbehej në vitin në vazhdim, por ngadalësimi i vërejtur ishte gjithësesi më i fortë nga ç'pritej. Për këtë arsye në muajin maj 2001, parashikimet e bëra në tetor të vitit 2000, për vitin 2001, u korrigjuan në masën më të madhe duke ulur shifrat e projektuara me nivele që varionin nga 0.2 deri në 1.7 për qind të PBB-së.¹

Grafik I-1: Parashikimet për rritjen e ekonomisë botërore në tetor 2000 dhe maj 2001 (në %).



*Shënim: EQL- Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

¹ Burimi: World Economic Outlook, FMN, Tetor 2001.

Në SHBA arsyet kryesore që çuan në thellimin e ngadalësimit ishin:

- çmimet më të larta të energjisë;
- një rishikim i parashikimeve të fitimeve të korporatave;
- rënie në tregjet e aksioneve dhe sidomos në aksionet e teknologjisë;
- shtërngim i kriterëve për dhënie kredish;

Këta faktorë së bashku rezultuan në ngadalësimin e kërkesës së brendshme dhe në dobësimin e besimit të konsumatorit dhe të biznesit.

Në Europë, ngadalësimi i ekonomisë botërore dhe dobësia e tregjeve financiare, ndikuan aktivitetin ekonomik gjatë gjysmës së parë të vitit. Ngadalësimi i rritjes ekonomike si pasojë e efektit negativ të çmimeve të energjisë mbi fuqinë blerëse, u ndje sidomos në Gjermani, ku besimi i biznesit dhe aktiviteti industrial treguan rënie gjatë kësaj periudhe. Megjithë ngadalësimin e dukshëm, supozimet për vazhdimin e rritjes ekonomike në atë kohë mbështeteshin në rritjen e konsumit si pasojë e rritjes së të ardhurave. Mbi këto të fundit ndikuan uljet e taksave mbi të ardhurat personale në disa vende të Europës (kryesisht Itali dhe Gjermani). Investimet mendohej se do të vazhdonin, të nxitura nga ulja e normave afatgjata të interesit dhe rëndësia relative e kreditimit nga ana e sistemit bankar.

Tabelë I-1: Disa tregues të ekonomisë reale për Eurozonën (2001).²

Njësia	PBB-T1*	PBB-T2*	Pr. Ind. -T1	Pr.Ind- T2	Papunësia** (qershor)
Gjermani	1.4	0.6	5.5	1.4	7.9
Francë	2.7	2.3	1.5	1.2	8.6
Itali	2.8	1.9	2.9	-0.8	9.5
BME	2.4	1.7	4.1	0.8	8.4

Shënim: * Ndryshimet vjetore në %.

** E standardizuar si përqindje e punonjësve në punësimin civil.

I.1.2. Ekonomia botërore gjatë gjysmës së dytë të vitit 2001

Sulmet terroriste të 11 shtatorit tronditën ekonominë e SHBA dhe ekonominë botërore në përgjithësi. Humbjet materiale që pësuan SHBA janë gjithësesi të pakta, krahasuar me panikun e tregjeve dhe të investitorëve dhe uljen në besimin e blerësve dhe prodhuesve.

² Burimi: Buletini Mujor i Bankës Qendrore të Gjermanisë, Nëntor 2001.

Tabelë I-2: Humbjet e pësuar nga sulmi i datës 11 shtator.

Në miliardë usd	Vlera
Struktura, pajisje dhe software	16.2
Private	14.9
Shteti dhe pushteti lokal	1.5
Qeveria Federale	0.7
Humbje të tjera nga sigurimet	5.2
Sigurim jete dhe të ngjashme	2.6
Kompensim i punonjësve	1.8
Pronarë shtëpish etj.	0.6
Qeveria e përgjithshme	0.2
Totali	21.4

I.1.3. Reagimi i tregjeve³

Duke qenë se tregjet e aksioneve në SHBA qëndruan mbyllur deri më 17 shtator 2001, reagim i menjëhershëm u vu re në tregjet e kredisë dhe të parasë si edhe në tregjet e aksioneve jashtë SHBA. Siç ka ndodhur edhe në kriza të tjera financiare (në vitet 1987, 1997 dhe 1999) investitorët rritën kërkesën për mjete me rrezik të ulët dhe *cash*, duke shitur në masë aksionet me rrezik të lartë ose mesatar.

Tabelë I-3: Tregjet e aksioneve.

Në %		1 korrik - 10 shtator	11 shtator- 21 shtator	22 shtator – 27 nëntor
S&P	(USA)	-11.7	-11.6	19.0
NASDAQ	(USA)	-21.1	-16.1	36.0
Euro STOXX	(Europë)	-18.2	-17.3	27.6
FTSE 100	(BM)	-11.9	-11.9	18.8
MSCI Asia	(Azi)	-7.8	-14.4	26.8
MSCI Latin America		-15.4	-13.8	17.5


Siç duket edhe nga tabela, tregjet në mbarë botën gjatë 10 ditëve të para të passulmit kanë humbur po aq pikë sa ç'kanë humbur gjatë 2 muajve paraardhës. Nga ana tjetër, ata kanë rikuperuar humbjet gjatë dy muajve në vazhdim duke reflektuar kështu kalimin e panikut fillestar si edhe politikat favorizuese monetare dhe fiskale që janë ndjekur nga qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të prekura nga ngadalësimi ekonomik.

³ Burimi: World Economic Outlook, FMN Tetor 2001.

I.1.4. Vendimet me normat e interesit

Dy bankat qendrore më të mëdha, Rezerva Federale dhe Banka Qendrore Europiane ndërmorën një sërë uljesh të normave të interesit, të cilat u përqendruan më tepër gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ulja e normave u bë me qëllim që të përkraheshin investimet dhe të shtohet nxitja ekonomike. Banka Qendrore Europiane, gjatë uljes së normave, ndoqi një politikë më të kujdesshme nga Rezerva Federale duke mbajtur gjithnjë parasysh objektivin e inflacionit. Shqetësimi për rritjen e këtij të fundit rridhte nga ecuria e ofertës monetare, e cila gjithësesi nuk rezultoi “e rrezikshme” për inflacionin në Eurozonë.

Grafik I-2: Veprimet e Bankës Qendrore Europiane dhe të Rezervës Federale në SHBA me normën e rifinancimit.⁴




I.1.5. Çmimet e mallrave primare dhe të naftës

Në tregun ndërkombëtar të mallrave primare, çmimet e ushqimeve, ato të lëndëve të para bujqësore dhe të metaleve, në fund të muajit nëntor, ishin përkatësisht 1.8, 17 dhe 16 për qind më të ulëta se në muajin janar. Ndonëse trendi rënës nuk është vërejtur gjatë gjithë vitit, ai ka qenë i dukshëm gjatë muajve shtator dhe tetor, duke reflektuar kështu pikën më të ulët të ekonomisë botërore dhe të kërkesës ndërkombëtare gjatë vitit. Mendohet që gjatë vitit 2002 këto çmime do të pësojnë rritje si pasojë e rigjallërimit të aktivitetit ekonomik dhe rritjes së kërkesës.

⁴ Burimi: 1. Banka Qendrore Europiane: <http://www.ecb.int>.

2. Rezerva Federale: <http://www.federalreserve.gov/boarddocs/press/general/2001>.

Grafik I-3: Çmimi i naftës në vitet 2000, 2001 dhe parashikimet për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2002 (usd për barrelë)⁵.



Gjashtëmuajori i dytë i vitit dhe sidomos periudha gusht-nëntor është karakterizuar nga një rënie drastike e këtij çmimi (deri në nivelin 19.33 usd/barrelë). Ndonëse parashikimet për gjashtë muajt e parë të vitit 2002 qëndrojnë pak mbi nivelin e fundvitit 2001, ato mbeten në nivele të ulëta (min 19.55 usd/barrelë), siç dëshmojnë edhe çmimet e opsioneve *futures* për naftën.

Ecuria e çmimit të naftës në tremujorin e fundit ishte disi e ndryshme nga ajo që pritej. Në muajt shtator-tetor, në pritje të shpërthimit të konfliktit të armatosur në Lindjen e Mesme, u hodh ideja e një embargoje të mundshme nga ana e vendeve prodhuese të naftës. Duke qenë se sulmi amerikan dhe i aleatëve u përqendrua mbi Afganistan, duke lënë të paprekur Irakun dhe rrjetin e fuqishëm të prodhimit të naftës, dhe duke qenë se Rusia dhe eksportues të tjerë të mëdhenj të naftës i ruajtën të pandryshuara nivelet e prodhimit, frika për një ngritje të çmimit nuk u materializua gjatë dy muajve që ndoqën sulmin terrorist mbi SHBA. Rënia e vazhduar e çmimit të naftës, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2001, përballë një kërkesë gjithnjë në rënie të ekonomive importuese të naftës, rriti presionin mbi OPEC-un për uljen e prodhimit. Vendimi i OPEC-ut, i marrë në dhjetor, për të pakësuar prodhimin me 1.5 miliardë barrela në ditë për gjashtë muaj, do të fillojë të zbatohet që nga 1 janari 2002. Ky vendim u mor pasi vendet e tjera joanëtare të kartelit (Angola, Meksika, Norvegjia, Omani dhe Rusia) u zotuan të shkurtonin prodhimin me 460 mijë barrela në ditë. Për vitin 2002 ekonomitë importuese të naftës po mbështesin shpresat e tyre në vazhdimësinë e çmimeve të favorshme. Sidoqoftë, çmimet e naftës mbeten të lidhura ngushtë me zhvillimet politike dhe sidomos me ato që përfshijnë Lindjen e Mesme dhe luftën e SHBA kundër terrorizmit.


I.1.6. Kursi i këmbimit euro/usd

Pas një ngjitjeje të vazhduar deri në muajin qershor dollari amerikan filloi rënien ndaj euros. Në javën e parë pas sulmeve terroriste dollari amerikan humbi rreth

⁵ Burimi: <http://neatideas.com/data/data/OILPRICE.htm>.

3-4 për qind të vlerës së vet ndaj euros dhe jenit japonez. Kursi i këmbimit euro/usd arriti pikën më të ulët në muajin shtator dhe pikërisht në datën 19 shtator kur një dollar amerikan këmbehej me 1.08 euro.

Grafik I-4: Ecuria e kursit të këmbimit euro/usd gjatë vitit 2001⁶.



Nën dritën e këtyre zhvillimeve parashikimet e FMN u ndryshuan edhe një herë duke vendosur këto nivele për ekonominë botërore:

Tabelë I-4: Ndryshimi i PBB-së dhe IÇK-së për disa ekonomi të zgjedhura⁷.

	Nd. i PBB (%)			Nd. i IÇK (%)		
	2000	2001	2002*	2000	2001	2002*
SHBA	4.1	1.0	0.7	3.4	2.9	1.6
Japonia	2.2	-0.4	-1.0	-0.8	-0.7	-1.0
Eurozona	3.4	1.5	1.2	2.4	2.7	1.4
Gjermania	3.0	0.5	0.7	2.1	2.4	1.0
Franca	3.5	2.1	1.3	1.8	1.8	1.1
Britania e Madhe	2.9	2.3	1.8	2.1	2.3	2.4

I.2. ZHVILLIMET EKONOMIKE NË RAJON

Rajoni i Ballkanit, gjatë vitit 2001, u karakterizua nga përpjekjet e institucioneve ndërkombëtare, kryesisht të BE, dhe të vetë vendeve të këtij rajoni për të rritur shkallën e bashkëpunimit ekonomik me synim krijimin e një rajoni të qëndrueshëm politikisht, pa konflikte dhe tërheqës nga pikëpamja ekonomike. Megjithatë, në vitin 2001, sidomos në tremujorin e dytë të tij, ishte e pranishme kriza e FYROM, e cila arriti deri në konflikt të armatosur. Megjithëse shkalla e integritit ekonomik të Shqipërisë me vendet të rajonit nuk është shumë e lartë (duke përjashtuar Greqinë), afërsia territoriale bën që të ketë ndikim në ekonominë e vendeve fqinje.

⁶ Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁷ Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: World Economic Outlook, Dhjetor 2001.

Tabelë I-5. Tregues kryesorë makroekonomikë për disa nga ekonomitë e rajonit gjatë vitit 2001. Për PBB dhe inflacionin jepen ndryshimet vjetore.

	PBB (%)	Inflacioni (%)	Llog. e buxhetit (% ndaj PBB)	Llog. korente (% ndaj PBB)	Papunësia (%)
Greqia	4.0	3.5	0.1	-6.2	10.3
FYROM	-4.6	5.3	6.0	6.5	30.5
Bullgaria	4.5	4.8	-0.9	-6.7	17.5
Bosnje-Herc.	5.6	3.0	-12.9	-18.0	
Jugosllavia	5.5	40	-2.4	-10.2	

I.2.1. Greqia

Gjatë vitit 2001 ekonomia e Greqisë ka shfaqur ritme të forta rritjeje të cilat, gjithësesi, janë ndikuar nga ngadalësimi i ekonomisë botërore dhe në veçanti i asaj europiane. Ndërkohë që normat e interesit në vend përafroheshin me normat në BE, dhe ndërkohë që BQE ulte normat e Eurozonës, investimet në Greqi pësuan rritje. Deficiti i llogarisë korente u ngushtua gjatë vitit duke reflektuar pjesërisht uljen në çmimet e naftës. Inflacioni bazë i Greqisë vazhdon të mbetet më i lartë nga inflacioni mesatar i Eurozonës. Një ndër faktorët që ka ndikuar në rritjen e inflacionit bazë është rritja në çmimet e produkteve ushqimore të përpunuara.


Në mënyrë që rritja ekonomike të vazhdojë dhe të përmirësohet gjatë vitit 2002, Greqia shpreson në:

- rimëkëmbjen e sektorit të prodhimit, i cili në Greqi, ashtu si në të gjithë Eurozonën, pati një ngrirje gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001;
- tejkalimin e disa efekteve negative që pati konvertimi në euro fizike mbi investimet;
- rimëkëmbjen e tregjeve të jashtme;
- rimëkëmbjen e sektorit të turizmit.

I.2.2. FYROM

Viti 2001 për Maqedoninë solli jo vetëm probleme të thella politike, po edhe një krizë të dukshme ekonomike. Konflikti i armatosur midis qeverisë vendase dhe popullsisë etnike shqiptare, e cila kërkonte të drejtat e saj, filloi në fund të muajit shkurt dhe vazhdoi gjatë pjesës më të madhe të vitit. Si pasojë e konflikteve të armatosura dhe e çrregullimeve që ndodhën në skenën politike të vendit, ekonomia maqedonase pësoi dëme të mëdha gjatë pjesës më të madhe të vitit 2001. Rënia e prodhimit u vu re në pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë me përjashtim të atij shtetëror, i cili u nxit nga aktivitete me karakter mbrojtës.

Grafik I-5: Humbjet e disa sektorëve kryesorë gjatë konfliktit.



Vlerësohet se PBB-ja e vendit u tkurr me 4.6 për qind gjatë vitit, ndërkohë që çmimet e konsumit u rritën me rreth 5.3 për qind duke reflektuar kryesisht rritjen në çmimet e artikujve ushqimorë gjatë periudhës së krizës. Buxheti i vitit 2001, pasqyron të ardhura më të ulëta dhe shpenzime më të larta se buxheti i vitit 2000. Për pasojë, deficitin buxhetor gjatë këtij viti kapi nivelin 6 për qind të PBB-së. Taksat mbi të ardhurat personale dhe fitimin, kanë pësuar rënie në krahasim me një vit më parë duke vërtetuar kështu ngadalësimin e disa prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë. Një ulje në nivelin e 0.7 për qind të PBB-së është vërejtur në taksat e importit, të cilat Maqedonia u detyrua t'i heqë në zbatim të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të nënshkruara gjatë viteve të fundit. Ulja në fjalë është rrjedhojë, gjithashtu, e tkurrjes së importeve totale të vendit gjatë periudhës së krizës.

Box I-1: Kalimi i krizës.

Në mënyrë që të përballonte deficitin e madh buxhetor, të shkaktuar nga shpenzimet për armatim (5.4 për qind e PBB-së) Qeveria Maqedonase prezantoi atë që u quajt taksa e luftës – një taksë në masën 1 për qind mbi të gjitha transaksionet financiare të ndërmarrjeve vendase. Megjithëse kjo taksë u ideua dhe u implementua gjatë periudhës së konfliktit, Qeveria Maqedonase ka vendosur të mos e heqë atë, të paktën edhe për pjesën e parë të vitit 2002.

Në këtë periudhë vendi pësoi rënie prej rreth 20 për qind të rezervave valutore si pasojë e importeve të shtuara dhe e shkatërrimit të besimit të tregut tek monedha vendase. Për të penguar rrjedhjen e rezervave valutore, banka qendrore rriti interesat e depozitave me dhe pa afat. Mendohet se politikat jo të përshtatshme fiskale dhe ekonomike, gjithashtu, kanë ndikuar në përkeqësimin e kushteve ekonomike.

Rëndësia e FYROM si partner tregtar i Shqipërisë u rrit gjatë periudhës së konfliktit. Nga muajt prill-qershor në Maqedoni janë importuar rreth 620 milionë lekë mallra (kryesisht bujqësore). Ky aktivitet u sheshua në muajt korrik dhe

gusht si pasojë e disa pengesave që vendosi Qeveria Maqedonase mbi 26 grupmallra të prodhuar në Shqipëri, me qëllim mbrojtjen e produkteve vendase.⁸

I.2.3. Kosova

Në mungesë të të dhënave përfundimtare, vlerësohet se ekonomia e Kosovës ka përparuar gjatë vitit 2001. Prodhimi bujqësor mendohet se është rreth 20-30 për qind më i lartë nga ai i vitit të kaluar, ndërkohë që prodhimi i industrisë së lehtë ka nisur të japë shenja rimëkëmbjeje. Importet në Kosovë vazhdojnë të ruajnë nivel tepër të lartë (rreth 80 për qind e PBB-së) ndërkohë që dërgesat zyrtare dhe private (rreth 1 miliard usd) shërbejnë për të mbuluar kostot e rindërtimit si edhe konsumin e lartë.

I.2.4. Jugosllavia

Zhvillimet ekonomike dhe politike në Jugosllavi kanë qenë relativisht të kënaqshme pas rënies së regjimit të Slobodan Millosheviçit. Inflacioni, i cili arriti shifra marramendëse gjatë viteve të krizës, e mbylli vitin 2001 në nivelin 40 për qind. Megjithë rritjen e PBB-së gjatë vitit të fundit, ajo mbetet larg ritmeve të vitit 1989, gjë që dëshmon për kapacitete të pashfrytëzuara si pasojë e mungesës së investimeve. Liberalizimi i çmimeve, i regjimit të tregtisë dhe i kursit të këmbimit, u ndoqën nga ristrukturime të bankave dhe të ndërmarrjeve gjatë vitit 2001.

Box I-2: Ngjarje kryesore të ekonomisë jugosllave.

Ndër ngjarjet kyçe të vitit 2001 mund të përmenden:

- Rritja e tarifave mesatare të energjisë elektrike me 15 për qind në bazë konsumi.
- Nënshkrimi i katër kontratave për privatizimin e grupeve të përbëra nga 3-5 ndërmarrje të mëdha.
- Pas vlerësimit të 71 bankave në territorin e Serbisë⁹, 26 (me 70 për qind të vlerës kontabël të totalit të aseteve të sistemit bankar) banka rezultuan si josolvente dhe u kaluan nën kontrollin e Agjencisë së Rehabilitimit të Bankave (7 banka) ose për likuidim total (19 banka).

I.2.5. Bullgaria

Zhvillimet e vitit 2001, në ekonominë bullgare, në kontekstin e bordit të monedhës dhe të një politike të kujdesshme fiskale, konsiderohen të kënaqshme. Pavarësisht nga ecuria e përgjithshme pozitive, reformat administrative dhe reformat në sektorët e energjisë dhe të transportit, konsiderohen të pamjaftueshme. Rënia në eksporte u konsiderua si pika e dobët e ekonomisë bullgare gjatë vitit 2001. Kjo rënie u shpjegua me krizën në Turqi dhe me ngadalësimin në BE. Sidoqoftë, pritet që deficitin i llogarisë korente gjatë vitit 2002

⁸ Burimi: Ekonomi Intelligence Unit: Tetor 2001.

⁹ Nuk përfshihen bankat në territorin e Kosovës.

të përmirësohet si pasojë e një rritjeje të eksporteve dhe të çmimeve më të ulëta të naftës.

I.2.6. Turqia

I.2.6.1. Situata e përgjithshme.

Turqia e ka parë veten në mes të problemeve të thella ekonomike dhe politike që në fillim të vitit 2001. Pas përplasjes mes presidentit Neçdet Sezer dhe kryeministrit Bulent Eçevit në muajin shkurt, investitorët e huaj, të trembur nga mundësia e një kolapsi politik, nisën të largoheshin nga vendi. Qeveria u detyrua të braktiste regjimin fikse të kursit të këmbimit duke lejuar lirën të zhvlerësohej me rreth 50 për qind. Zhvlerësimi i lirës, përveç rritjes së çmimeve, shkaktoi panik në sistemin financiar të Turqisë. Shumë prej bankave, të cilat kishin sasi të mëdha pasivesh të pambrojtura në dollarë, shkuan drejt falimentimit. Deri në fund të gjashtëmuorit të parë, përpjekjet e qeverisë për të zbatuar programin e reformave të mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nuk dhanë rezultatet e pritura sidomos në drejtim të pakësimit të influencës së shtetit në industri. Ekonomia e Turqisë, e cila ishte prej kohësh në krizë, u gjend përballë një situatë tepër të vështirë pas ngjarjeve të datës 11 shtator për shkak të pozitës gjeografike, mbështetjes tek turizmi dhe borxhit të lartë të jashtëm. Ngadalësimi i ekonomisë ka çuar në rritjen e papunësisë. Mendohet se që nga muaji shkurt kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës rreth 700 mijë persona. Sindikalistët e Turqisë, duke u shprehur të pakënaqur ndaj programit ekonomik të qeverisë, në muajin nëntor vunë theksin mbi masat që duheshin marrë për nxitjen e investimeve, të prodhimit dhe të eksporteve.

Tabelë I-6: Disa të dhëna të ekonomisë turke.

	Viti 2001	Viti 2002*
PPK (nd. %)	-8.5	+3
Inflacioni vjetor (%)	68.5	35
Bilanci buxhetor (% të PPK)	+5.5	+6.5
Llogaria korente (mld usd)	+2	-2

Shënim: *Parashikime.

I.2.6.2. Financimi i krizës.

Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore ndërhyjnë për të zbutur efektet e krizës në Turqi. Ndërhyrja në Turqi, ashtu si në Argjentinë u pa e arsyeshme, pasi vendi testoi përshtatshmërinë e fiksimit të kursit të këmbimit 'deri në shkatërrim'. Nga ana tjetër, pozita e Turqisë si i vetmi vend mysliman në NATO dhe mbështetja që vendi i bëri politikës antiterroriste të Shteteve të Bashkuara pas ngjarjeve të 11 shtatorit, janë domethënëse për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në muajin maj, Fondi Monetar Ndërkombëtar vendosi të shtonte kreditin trevjeçar *stand-by* me 8 miliardë usd, duke e çuar atë në nivelin 19 miliardë usd. Nga kjo sasi Turqia tërhoqi 3.8 miliardë usd në maj, nga 1.5

miliardë në korrik dhe gusht dhe 3 miliardë në muajin nëntor. Fondi Monetar Ndërkombëtar, në fillim të vitit 2002, iu përgjigj pozitivisht kërkesës së Qeverisë Turke për miratimin e një kredie të re për periudhën 2002-2004 në masën 16.2 miliardë usd. Kjo kredi e cila fshin kredinë e mëparshme, do të përdoret nga Qeveria Turke për implementimin e programit ekonomik.

Ky program ka si objektiva kryesorë¹⁰:

- (i) ruajtjen e kursit fleksibël të këmbimit dhe përdorimin e *inflation targeting* për të siguruar zbritjen e inflacionit;
- (ii) vazhdimin e ristrukturimit të bankave;
- (iii) sigurimin e një pozicioni të përshtatshëm të borxhit të qeverisë.

Së dyti, programi do të përfshijë reforma themelore strukturore që kanë për qëllim ngritjen e potencialit për prosperitet ekonomik të Turqisë.

I.2.7. Konsiderata për ndikimin në ekonominë shqiptare

Ekonomia shqiptare për shkak të shkallës së ulët të zhvillimit të saj, mungesës së tregjeve të kapitalit dhe nivelit të ulët të prodhimit dhe të eksporteve, ka shkallë të ulët të integritit me ekonominë botërore dhe atë të rajonit. Në periudhën 1993-2001 mesatarisht importet kanë zënë rreth 29 për qind të PBB-së ndërsa eksportet rreth 7.6 për qind. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia dhe Greqia, shtete në të cilat është përqendruar aktiviteti eksport-importit dhe prej të cilëve janë kryesisht investitorët e huaj. Kjo situatë e bën ekonominë shqiptare disi të ngurtë përballë ekonomisë botërore. Megjithatë, ekonomia shqiptare nuk është e imunizuar nga ndikimi i problemeve në ekonominë botërore.

Ngadalësimi i ekonomisë botërore mendohet se ndikon në disa drejtime:

- **turizmi.** Turizmi mund të jetë ai sektor i ekonomisë shqiptare që do ta vuajë pasigurinë e përgjithshme të krijuar pas sulmit terrorist të 11 shtatorit. Kjo përforcohet më tej duke patur parasysh shkallën e rrezikshmërisë që paraqet dhe vetë rajoni i Ballkanit;
- **programet e ndihmës së huaj.** Përfundimi i luftës në Afganistan, përqendrimi i vëmendjes në luftën kundër terrorizmit, vetvetiu do të krijojnë një zbehje të vëmendjes për vende si Shqipëria që kanë një stabilitet relativ;
- **investimet e huaja dhe privatizimi.** Shkalla e përgjithshme e pasigurisë, e cila vlerësohet më e dëmshme se rritja e shkallës së rrezikut, për shkak të paqëndrueshmërisë që krijon, mund të bëjë që investitorët të mos jenë më aktive në tregjet në zhvillim. Për Shqipërinë kjo do të thotë edhe ngadalësim i procesit të privatizimit të sektorëve strategjikë, ku synohet të tërhiqen investitorë të huaj;
- **eksportet.** Ngadalësimi i ekonomisë botërore do të thotë ulje e kërkesës për eksporte nga vendet në zhvillim. Kjo mund të dëmtojë edhe atë nivel të ulët eksportesh që ka Shqipëria.

¹⁰ Burimi: Turkey Letter of Intent, 28 janar 2002, FMN.

Përsa i përket vendeve të rajonit, ekonomia shqiptare është akoma më pak e integruar se sa me ekonominë italiane dhe atë greke. Vrojtmet e kryera nga Banka e Shqipërisë tregojnë se transaksionet valutore me ekonomitë e rajonit përbëjnë rreth 1/5.

Megjithatë, konflikti i armatosur në FYROM pati ndikim negativ në ekonominë shqiptare, kryesisht në zhvillimet në inflacion. Reduktimi i importit të fruta-perimeve (një artikull që ka ndikim të konsiderueshëm në shportën e inflacionit) prej vetë FYROM, ndërprerja e rrugëve të transportit për mallrat që vinin nga shtete të tjera si Turqia apo Bullgaria dhe zëvendësimi i tyre me mallra të blerë në tregje të Greqisë apo Italisë, ndikoi në rritjen e presioneve inflacioniste në ekonominë shqiptare sidomos në periudhën mars-korrik 2001.

I.3. PREZANTIMI FIZIK I EUROS

Mbarë bota dhe në veçanti Europa kanë kohë që përgatiten për prezantimin fizik të monedhës së përbashkët të 12 shteteve europiane. Viti 2001, duke qenë dhe viti i fundit gjatë të cilit monedhat kombëtare të shteteve të Eurozonës ishin në qarkullim, ishte i mbushur me aktivitete sensibilizuese dhe promovuese. Këto aktivitete kishin për qëllim të familjarizonin publikun european dhe më gjerë, me karakteristikat dhe elementet e sigurisë së monedhës fizike si edhe me masat që ishin marrë për shpërndarjen e parasë. Banka Qendrore Europiane, mori një sërë masash për të sqaruar publikun mbi momentet kur monedhat kombëtare të secilit shtet anëtar të BE-së do të bëheshin të pavlefshme si mjet pagese, si edhe periudhat gjatë të cilave përdoruesit e monedhës mund t'i ndërronin paratë e tyre në euro pranë bankave tregtare apo qendrore të secilit shtet.

Ndonëse Shqipëria nuk bën pjesë në Komunitetin European, ajo ka përdorur dhe vazhdon të përdorë monedhat e tij prej shumë vitesh tashmë. Italia, Greqia, Gjermania nëpërmjet transaksioneve tregtare, hyrjeve kapitale, dërgesave të emigrantëve etj., kanë sjellë dhe vazhdojnë të sjellin në Shqipëri monedhat përkatëse të shportës euro, të cilat që prej janarit 1999 mbajnë një emër të vetëm. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë, duke qenë drejtpërdrejt e interesuar në mbarëvajtjen e procesit të hyrjes së euros fizike në vend, gjatë vitit 2001, organizoi një fushatë informimi për publikun shqiptar. Fushata u përqendrua në: informimin dhe edukimin e qytetarëve mbi veçoritë fizike të monedhave dhe kartëmonedhave Euro; publikimin në mënyrë të vazhdueshme të afateve të përdorimit apo të shkëmbimit të monedhave të shportës gjatë muajve të parë të vitit 2002; përgatitjen dhe shpërndarjen e broshurave, fletëpalosjeve dhe posterave. Qëllimi i fushatës ishte pranimi i monedhës Euro në mënyrë sa më të natyrshme dhe pa shqetësime në mjedisin ekonomik shqiptar për konvertim dhe si mjet pagese duke filluar nga data 1 janar 2002. Domosdoshmëria e një fushate të tillë u rrit pasi u vu re që publiku shqiptar ishte pak i familjarizuar me euron. Ky përfundim u arrit pas një vrojtimi që u realizua nga Banka e Shqipërisë me punonjës të thesarit të bankave të nivelit të dytë. Një

e treta e këtyre punonjësve u shprehën se problemi kryesor që parashikohej nga bankat, ishte mungesa e informacionit të publikut rreth afateve përfundimtare të tërheqjes nga qarkullimi të bankënotave/monedhave metalike, që bëjnë pjesë në euro dhe funksionimit të euros. Ndërsa në vrojtimin e organizuar me bankat, zyrat e këmbimit valutor, me bizneset, me kambistët e tregut jozyrtar valutor dhe me qytetarët, rreth 71.5 për qind e tyre shpreheshin se publiku shqiptar është pak ose aspak i përgatitur për prezantimin fizik të euros. Këto rezultate e bënë të qartë që Banka e Shqipërisë duhej t'i kushtonte vëmendje të konsiderueshme familjarizimit të publikut me monedhën e re.

Puna për fushatën u konceptua në dy faza. Faza e parë, e cila zgjati deri në fund të muajit gusht, u përqendrua në publikimin e artikujve informativë për shtyp si edhe në vendosjen e një korrespondence të vazhdueshme me shoqatën e bankierëve. Kësaj të fundit iu kërkua mendim mbi kushtet që duhej të përmbusheshin për plotësimin e nevojave të klientëve për *cash* më 3 janar 2002. Faza e dytë e fushatës, e cila përfshiu periudhën shtator-dhjetor 2001, ishte më intensive. Ajo u përqendrua në publikime të llojeve të ndryshme në mediat e shkruara dhe televizive, në hedhjen në qarkullim të fletëpalosjeve, të broshurave dhe të posterave të euros dhe në botimin e materialit, që përmbante elementet e sigurisë së monedhave dhe të kartëmonedhave euro. Materialet e shpërndara nga Banka e Shqipërisë e ndihmuan shumë fushatën për informimin e publikut rreth euros¹¹. Në të njëjtën periudhë Banka e Shqipërisë organizoi takime me gazetarë dhe përfaqësues të bankave të nivelit të dytë. Duke gëzuar statusin e autoritetit qendror monetar, Banka e Shqipërisë botoi njoftime shtypi në të cilat synohej të sqarohesh publiku shqiptar mbi periudhën e qarkullimit të dyfishtë dhe afatet e këmbimit të monedhave të shteteve anëtare.

Përsa i përket veprimtarisë operacionale që ndërmori Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2001, ajo përfshiu disa masa. Së pari, inspektimin e gjendjes së bankave të nivelit të dytë në prag të furnizimit me euro fizike. Së dyti, përllogaritjen e sasisë fizike që do t'i nevojitej Bankës së Shqipërisë në mënyrë që të përmbushte çdo kërkesë të këtyre bankave gjatë javëve të para të janarit. Këto masa bënë të mundur që 1 janari i vitit 2002 ta gjente vendin me rezervat e nevojshme për mbështetjen e konvertimit të valutave të vendeve europiane në monedhën e përbashkët, Euro. Fushata për euron u zgjat deri në fund për të reduktuar sa më tepër rrezikun e vështirësive që klienti shqiptar mund të haste për arsye teknike gjatë konvertimit të valutave në euro, si edhe me frikën e spekulimeve me kursin e këmbimit.

¹¹ Kështu janë shprehur punonjës të thesarit nëpër këto banka në pyetësorin e lartpërmendur.

KAPITULLI II – EKONOMIA SHQIPTARE

II.1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME PËR EKONOMINË

Sektori real i ekonomisë edhe gjatë vitit 2001, u karakterizua nga përpjekjet e vazhdueshme të të gjithë aktorëve kryesorë ekonomikë, për të ruajtur ritmet e rritjes në aktivitetet më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare. Megjithëse këto përpjekje, në pjesën më të madhe të vitit, u ndeshën me situata mjaft të vështira, të shkaktuara nga kriza e thelluar energjitike, u arrit që të ruhej një ekuilibër i përshtatshëm në treguesit kryesorë makroekonomikë. **Rritja e prodhimit në fund të vitit u vlerësua në masën 7.3 për qind¹², aq sa ishte programuar, rritje që i dedikohet kryesisht arritjeve në pjesën e parë të vitit.** Kjo, sepse **gjashtëmujori i dytë i vitit, u karakterizua nga një tkurrje e përgjithshme e aktivitetit ekonomik.** Jeta ekonomike e vendit eci në të njëjtat shtigje si edhe në vitin e kaluar, por me disa lëkundje të sektorëve të rëndësishëm të saj. Edhe gjatë vitit 2001, sektori privat i ekonomisë vazhdoi të gjallërohet, kundrejt një sektori shtetëror në tkurrje. Sektorë të tillë si ai i transportit, i shërbimeve dhe i investimeve, kryesisht në infrastrukturë, në tërësi manifestuan shenja të dukshme të riaftësimit dhe të rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe përmirësime të mëtejshme të aftësive administruese. Por, nga ana tjetër, degë të tilla si ndërtimi dhe bujqësia vlerësohet të kenë kontribuar mjaft në PBB gjatë vitit të kaluar por ndoshta jo me të njëjtat ritme si më parë. Gjithashtu, prodhimi industrial i sektorit shtetëror, kryesisht në atë të minierave, vazhdoi të pasqyrojë tendencën rënëse të trashëguar vite më parë, duke rritur hijen e paqartësisë edhe për eksportet e mineraleve shqiptare. Ndërsa, në mënyrë krejt të qartë, prodhimi i energjisë elektrike, regjistroi shifra mjaft më të ulëta se një vit më parë.

Aktiviteti ekonomik, gjatë vitit të kaluar manifestoi ngritje të dukshme për treguesit e kërkesës së brendshme sidomos gjatë tremujorit të dytë të vitit. Kjo periudhë përkoi me një iniciativë të dukshme të qeverisë për kryerje të investimeve, kryesisht në fushën e infrastrukturës, dhe me fushatën elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Bumi i madh i investimeve u pasqyrua në rritje të aktiviteteve të transportit, të ndërtimit dhe të riparimit të rrugëve.

Pas kësaj periudhe, treguesit flasin për një qetësi dhe një normalizim të aktivitetit ekonomik në tërësi. Efektet sezonale, gjithashtu, qenë të pranishme gjatë gjithë vitit duke vepruar herë në nxitje të aktivitetit ekonomik dhe herë në rënie të tij.

¹²Burimi: Ministria e Financave dhe vlerësime të FMN-së.

Tabelë II-1: Tregues ekonomikë të përgjithshëm.


	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Popullsia (000)	3202.0	3248.8	3283.0	3324.3	3354.3	3354.0	3373.0	3401.0	3087.1
Përqindja e rritjes së popullsisë	1.1	1.5	1.1	1.3	0.9	0.6	0.8	0.8	-9.2
Numri i të punësuarve (000)	1046.0	1161.0	1138.0	1116.0	1107.0	1103.0	1081.0	1064.0	1074.0
PBB (çmime të vitit 1990, në milionë lekë)	12309.0	13331.0	15107.0	16478.0	15325.0	16547.0	17748.0	19125.0	20516.0*
Rritja në % e PBB-së (çmime të vitit 1990)	9.6	8.3	13.3	9.1	-7.0	8.0	7.3	7.8	7.3*
PBB (çmime korente, në milionë lekë)	125334.0	184393.0	229793.0	280998.0	341716.0	460631.0	506205.0	539210.0	594346.0*
PBB (çmime korente, në milionë usd)	1221.6	1984.5	2422.1	2689	2294.5	3057.8	3676.4	3752.1	4099.0*
PBB (për frymë në usd)	381.5	610.8	737.8	808.9	684	906.5	1080.9	1094.4	1327.8*
Përqindja e papunësisë	22.3	18.4	13.1	12.4	14.9	17.8	18.0	16.9	14.4
Përqindja e inflacionit (v/v)	30.9	15.8	6.0	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2	3.5
Deficiti i buxhetit (në % të PBB-së)	-13.7	-9.0	-10.2	-12.8	-12.9	-10.4	-11.5	-9.3	-9.2*
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)			25.1	30.7	35.8	32.9	36.4	41.5	41.1*
Llogaria korente (në % të PBB-së)1/	-28.8	-14.3	-9.7	-11.5	-14.4	-8.2	-7.2	-7.0	-7.4*
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)		52.5	30.4	29.2	35.6	26.5	25.8	30.2	28.9*
Kursi mesatar i këmbimit	102.6	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7	143.48

* Të dhënat për vitin 2001 janë parashikime sipas programit.

1/Llogaria korente përjashtuar të ardhurat neto nga faktorët e shërbimeve dhe transfertat shtetërore.

Burimi : INSTAT , Ministria e Financave , Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

Grafik II-1: Kontributi i sektorëve kryesorë të ekonomisë në PBB në vitin 2001 (në %).



Box II-1: Strategjia e reduktimit të varfërisë.

Rrjedhjet e trashëgimisë nga sistemi i mëparshëm, por dhe si nënprodukt i reformave të tranzicionit të ndërmarra gjatë dekadës së kaluar, varfëria në Shqipëri përbën një problem të mprehtë ekonomik dhe social. Studimi mbi Nivelin e Jetesës (INSTAT, 1998) evidenton se **29.6 për qind e shqiptarëve janë të varfër dhe se gjysma e kësaj kategorie jetojnë në varfëri ekstreme**. Për më tepër, dimensionet e varfërisë shtrihen përtej shfaqjes së saj thjesht si varfëri ekonomike. Ajo gjen shprehje në përkeqësimin e treguesve të nivelit arsimor, të shëndetit, të përfitimit të shërbimeve publike (si uji i pijshëm, energji elektrike etj.) në prishjen e ambientit, deri dhe në dëmtimin e strukturave të kapitalit social.

Autoritetet shqiptare hartuan gjatë vitit 2001 Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social. Boshti i saj mbetet krijimi i një ambjenti të përshtatshëm për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe përfshirëse, të harmonizuar me politika ekonomike që synojnë nxitje në krahun e ofertës.

Roli i Bankës së Shqipërisë në kuadër të kësaj strategjie, shkon përtej përgjegjësisë dhe kontributit të saj në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit. Duke vlerësuar shkallën e zhvillimit të tregut financiar në vend, shtrirjen e sistemit bankar dhe produktet e industrisë bankare, lidhjen e sistemit bankar me sektorin privat të ekonomisë, Banka e Shqipërisë është e angazhuar në trajtimin e këtyre problemeve. Objektivi strategjik, në kuadër të kësaj strategjie, është nxitja e krijimit të një sistemi financiar konkurrues dhe të aftë, që t'i përgjigjet nevojave në rritje të ekonomisë në tërësi dhe zhvillimit të sektorit privat në veçanti. Dy ndër projektet më të rëndësishme të Bankës së Shqipërisë janë përmirësimi i sistemit të pagesave nëpërmjet instalimit të sistemit të pagesave bruto në kohë reale (RTGS) dhe krijimi i Zyrës së Informacionit të Kredisë. Por vëmendje do t'i kushtohet edhe forcimit të mbikëqyrjes bankare dhe rregullave të mbikëqyrjes, nxitja e zgjerimit të rrjetit bankar dhe mbulimi me shërbime bankare i gjithë territorit të vendit, nxitja e zhvillimit të skemave të kursim-kreditit etj..

II.1.1. Prodhimi bujqësor

Prodhimi bujqësor, sipas vlerësimeve të deritanishme, përbën rreth 50 për qind të prodhimit të brendshëm bruto. Viti 2001, shfaq shenja të rënies së ritmeve të rritjes së kësaj dege. Kështu, sipas parashikimeve, rritja e prodhimit bujqësor vlerësohet të jetë realizuar rreth një pikë përqindjeje më poshtë se sa parashikimi për të, në fillim të vitit. Kjo, ka ardhur kryesisht si pasojë e reduktimit në rritjen e prodhimit në bujqësi. Nga ana tjetër, vlerësohet se prodhimi agroindustrial të ketë arritur nivele të kënaqshme deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2001. Në kushtet e një analize mbi të dhëna krejtësisht të kufizuara për këtë degë, mund të vlerësohet se deri në fund të tremujorit të tretë disa produkte të agroindustrisë kanë tentuar në nivele më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2000.

Mungesat e theksuara të energjisë elektrike kanë çuar edhe në kufizime të aftësive prodhuese, të pasqyruara në sasira më të ulëta prodhimi. Kjo ka ardhur duke u theksuar në fund të vitit, pra rëniet tashmë të evidentuara në tremujorin e tretë, pa dyshim mund të kenë vijuar, madje me ritme më të shpejta edhe në tremujorin e katërt të vitit që sapo u mbyll.

Tabelë II-2: Parashikimi i prodhimit bujqësor i vlerësuar për vitin 2001 (në milionë lekë).

Emërtimi	Viti 2000	Parashikimi 2001	Në %
1. Bujqësia	192 977	199 127	103.2
2. Agroindustria	17 946	19 200	107.0
3. Peshkimi	1 668	1 750	104.9
Totali	212 591	220 277	103.6

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

II.1.2. Prodhimi industrial

Prodhimi industrial në sektorin shtetëror, vazhdon të manifestojë ulje. Indeksi i prodhimit industrial në volum, pas një rritjeje të lehtë gjatë tremujorit të dytë të vitit, në fund të tij, pësoi përsëri rënie, madje krahasuar me një vit më parë, rënia është mjaft e theksuar, në masën 43.1 për qind. Në përgjithësi, shifrat si për industrinë nxjerrëse edhe për atë përpunuese, flasin për situatën e vështirë të tyre: ato gjenden në një udhëkryq, që sa vjen e bëhet më i vështirë për t'u kaluar.

Tabelë II-3: Treguesi të prodhimit industrial në sektorin shtetëror.

Treguesi (në % kundrejt vitit 1993)	T-1- T-2 T-3 T-4				T-1- T-2 T-3 T-4							
	1999				2000				2001			
Prodhimi industrial në volum	66.1	56.8	62.3	61.3	58.3	60.5	61.6	54.3	33.7	43.9	34.1	30.9
Industria nxjerrëse	35.6	37.1	37.6	32.9	29.2	32.9	33.3	28.6	28.8	29.1	27.3	25.7
Industria përpunuese	55.4	39.6	73.9	54.3	41.4	50.9	64.2	53.2	16.9	33.6	24.6	17.5
Prodhimi i energjisë elektrike	171.4	172	144.8	144	185.8	153.5	98.5	106	117.8	116.5	88.9	100

Burimi: INSTAT, Konjuktura, viti 1999-2001.

Nëse do të analizoheshin ritmet e rritjes sipas tremujorëve, ato flasin vetëm për rënie gjatë gjithë periudhës 1999-2001. Ndonjë rritje e konstatuar në ndonjë sektor të veçantë do të konsiderohet plotësisht sporadike.

Treguesi i prodhimit mall të shitur, nga ana tjetër, flet për rënie të vazhdueshme të tij nga njëri tremujor në tjetrin. Po kështu, treguesit kanë pësuar rënie edhe krahasuar me një vit më parë. Vetëm Albpetrol Sh.A., është kompania që ka manifestuar rritje, në masën 14.8 për qind krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që industria me rënie më të theksuar paraqitet ajo e minierave me afro 71 për qind. Po kështu edhe K.E.Sh., megjithëse në fund të vitit zbatoi sistemin dytarifor të energjisë elektrike për konsumatorët, paraqet një rënie në masën rreth 5 për qind. Nëse do t'i referoheshim shifrës së prodhimit në natyrë (në mijë kilovat/orë), fundi i vitit 2001, tregoi një rënie të saj me rreth 22.2 për qind krahasuar me vitin paraardhës, fakt që dëshmon për kapacitetet mjaft të kufizuara prodhuese të kësaj ndërmarrjeje të energjitikës shqiptare. Për më tepër, kjo ndërmarrje aktualisht, ka monopolin e prodhimit, të shpërndarjes dhe të administrimit të energjisë elektrike në vend.

Dega e minierave, jo vetëm që ka përvijuar një profil rënës mjaft të dukshëm përgjatë gjithë vitit 2001, por shuajtja e saj në tremujorin e katërt flet për një sektor krejtësisht jashtë kontributit në PBB, në këtë periudhë.

Tabela II-4: Prodhimi mall i shitur (në miliardë lekë).

Sektorët	T-1 2001	T-2 2001	T-3 2001	T-4 2001	Ndryshimi (në%) 2001/2000
Totali	3.6	4.8	4.0	5.3	94
Albpetrol Sh. A.	1.0	1.3	1.2	1.03	114.8
Armo Sh. A.	1.04	1.5	1.3	1.4	87.5
Servcom Sh. A.	0.022	0.023	0.022	0.028	71.4
K.E.SH. Sh. A.	1.65	1.6	1.3	2.7*	95.8
Minierat	0.16	0.051	0.024	-	29.2
Industria	0.18	0.23	0.16	0.15	91.8

Burimi : Ministria Ekonomisë dhe Privatizimit, janar 2002.

Shënim: * Prodhimi mall i shitur nga K.E.SH., në tremujorin e katërt të vitit 2001, është llogaritur mbi bazën e sistemit dytarifor të zbatuar në dhjetor të vitit 2001, ndaj edhe ka rezultuar kaq i lartë, rreth dyfishi i një tremujori më parë. Në tremujorin e katërt janë arkëtuar të ardhurat vetëm nga 873 mijë kwh, ndërkohë që pritej arkëtimi prej 1.3 milionë kwh-ve.

Sektori privat i ekonomisë, nisur nga disa tregues indirektë, ka paraqitur vlera të kënaqshme të arritjeve të tij. Ato janë më të spikatura në tremujorin e dytë të vitit, ku edhe investimet ishin më të konsiderueshme. Bie në sy konsumi i brendshëm i çimentos, i cili arriti vlera mjaft të larta. Mesatarisht, në këtë tremujor, u konsumua rreth 1.7 herë më shumë çimento se në tremujorët e tjerë të vitit. Treguesi që ka shfaqur një tendencë në rritje më të qartë se të tjerët, është ai i importit të makinerive dhe pajisjeve. Në fund të vitit ai është rritur me rreth 56 për qind më shumë krahasuar me tremujorin e parë të tij. Ky fakt flet jo vetëm për zgjerim të aktivitetit ekonomik të firmave shqiptare, por edhe për rritje

të pretendimeve të tyre për të konkurruar në treg me teknologji efikase dhe bashkëkohore. Vlerësohet se kjo rritje është e lidhur ngushtë me nivelin e lartë të importeve, të shënuar nga hyrja në masë e gjeneratorëve të prodhimit të energjisë elektrike si edhe të pajisjeve teknologjike të komunikimit në sektorin e shërbimit të telefonisë celulare.

Tabelë II-5: Ecuria e sektorit privat të ekonomisë.

Investimet	Njësia e matjes	T-1-1999	T-2	T-3	T-4	T-1-2000	T-2	T-3	T-4	T-1-2001	T-2	T-3	T-4
Importi i makinerive dhe pajisjeve	Mld. lekë	4.2	6.2	7	7.4	6.6	7.3	7.5	11.5	8.8	11.7	11	13.6
Konsumi i dukshëm i çimentos	Mijë ton	187.1	217.2	288	253	192.3	348.5	395	372	267	506	301	310
Kërkesa e brendshme													
Konsumi i energjisë elektrike	Mijë kwh	358	351	363	455	355.3	360	402	414	502	502	502	433
Konsumi i karburanteve	Mijë ton	35.5	61.6	91.4	59.4	69.3	52.9	93.6	84.1	73.4	78.9	92.1	103.9
Importe pajisjesh elektroshtëpiake	Mijë copë	8.1	9.3	14	29.5	24.1	21.3	5.6	27.8	10.8	16.5	13.4	13.4
Importe autoveturash	Mijë copë	1488	1694	8534	6158	4285	11076	4337	4000	7595	3361	3971	3657
Tregtia e jashtme													
Totali i eksporteve	Mld. lekë	10.3	10.9	8.8	8.9	8.9	9.9	9.2	9.2	11.2	13	8.4	11
Totali i importeve	Mld. lekë	26.2	62.7	35.1	34	31.6	37.4	38.1	41.2	41.2	47.8	45.9	55.7
Eksport/Import	%	39.1	17.5	21.7	25.8	28.2	26.6	24.2	19	27.42	27.2	18.4	19.75

Burimi: INSTAT, Konjuktura, viti 1999-2001.

Ritmet e rritjes nga njëri vit në tjetrin për treguesit indirektë, në tërësi flasin për tendenca rritëse të tyre përgjatë gjithë periudhës 1999-2001.

Megjithatë, rëniet në konsumin e çimentos në tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit 2001, në krahasim me të njëjtat periudha të një viti më parë, flasin për rënie, kryesisht, në **sektorin e ndërtimit**. Në këtë mënyrë, po faktohet gjithnjë e më shumë ndjesia nga disa shenja, tashmë të cituara për këtë aktivitet. Rënia e numrit të lejeve të ndërtimit, situata disi jo e favorshme për investime, si edhe rënia e kreditimit nga sektori bankar për këtë degë, kanë ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të rritjes së saj.

Tremujori i dytë i këtij viti ka manifestuar shenja pozitive edhe për aktivitetin e **tregtisë së jashtme**, kohë në të cilën të dyja krahët e tregtisë u rritën ndjeshëm, duke përmirësuar edhe koeficientin e mbulimit të eksporteve nga importet. Tendencë rritëse të dukshme paraqesin importet duke realizuar në tremujorin e katërt të vitit, shifrën 55.7 miliardë lekë apo 14.8 për qind më shumë se fundi i vitit të kaluar. Vetë vlera e importit të makinerive dhe pajisjeve në nivele gjithnjë e më të larta, duket sikur ka një korrelacion mjaft të lartë me importet në total. Ashtu siç edhe është përmendur më lart, kjo ka ardhur si pasojë e rritjes në masë

të importeve të gjeneratorëve dhe të pajisjeve të shërbimit telefonik. Niveli i eksporteve paraqitet me një rritje më të moderuar. Pas rënies së konsiderueshme në tremujorin e tretë të vitit, ndjehet riaktivizimi i eksporteve, duke realizuar në tremujorin e katërt një shifër prej afro 20 për qind më të lartë se një vit më parë.

Konsumi i karburanteve ka shënuar pikën më të lartë në tremujorin e fundit të vitit, duke qëndruar 23.5 pikë përqindjeje më lart se e njëjta periudhë e një viti më parë. Tendenca e theksuar rritëse del në pah edhe nëse shihet që në këtë tremujor u konsumuan mesatarisht 1.3 herë më shumë karburante se sa në pjesën tjetër të vitit. Shkaku kryesor në këtë rritje është përdorimi i karburanteve për të realizuar zëvendësimin e energjisë elektrike të munguar në këtë periudhë të vitit.

II.1.3. Sektori i transportit

Nëse do t'i referoheshim të dhënave të **degës së transportit**, gjatë vitit 2001, do të veçohej tendenca pozitive e saj në fushën e investimeve. Gjatë gjithë vitit të kaluar, investimet janë realizuar në nivele të larta, madje në tremujorin e dytë ato kanë pësuar tejkalime të dukshme. Tejkalimet në këtë tremujor lidhen, para së gjithash, me përqendrimin e investimeve në këtë periudhë të vitit. Fundviti tregoi se investimet u tejkaluan në masën 17.52 për qind mbi parashikimin për to dhe tejkalimet më të spikatura u manifestuan në infrastrukturën rrugore, me rreth 14 për qind më lart. Sidoqoftë, viti 2001 shënoi pothuaj të njëjtin nivel investimesh si edhe një vit më parë, me një rënie të lehtë në rreth 1 për qind.

Struktura e tyre vazhdoi të ketë një profil të drejtuar nga ndihmat e kreditë, me rreth 58.2 për qind të totalit të investimeve. Pjesa tjetër u financua nga burime buxhetore.

Tabelë II-6: Ecuria e investimeve (në milionë lekë).


Investimet	1997	1998	1999	2000	2001
Totali	3800.1	8269.2	13128.9	15996.7	15864.9
Buxhetore	604.55	1969.5	4446.7	5976.7	6634
Ndihma e kredi	3195.6	6299.7	8682.2	10020	9230.9

Edhe në këtë degë spikat zgjerimi i sektorit privat. Këtë fakt e dëshmon numri i lartë i licencave të dhëna gjatë vitit 2001 për subjektet private shqiptare. Konkretisht, u licencuan 384 të tilla apo 35.2 për qind më shumë se një vit më parë. Kryesisht, kjo rritje është më e madhe për agjencitë e transportit interurban të udhëtarëve si edhe për agjencitë ajrore.

II.1.4. Kursimet dhe investimet

Kursimet e brendshme shënuan një rritje prej 1.1 pikë përqindje. Zhvillimet pozitive në konsolidimin e financave publike ishin kontribues kryesor në rritjen e kursimeve. Reduktimi i deficitit fiskal të financuar me burime të brendshme krijoi premisa për orientimin e kursimeve drejt sektorit privat të ekonomisë.

Grafik II-2: Kursimet dhe investimet në % ndaj PBB-së.



Këto zhvillime, bënë që investimet private të rriten nga 12.1 në 13.2 për qind të PBB-së. Megjithëse kjo rritje është modeste, pesha e tyre në totalin e investimeve, i bënë të ndjeshme ndryshimet në këtë sektor. Kështu, investimet në total arritën në 20.1 për qind të PBB-së, nga 18.6 për qind në vitin 2000.

Nga ana tjetër, investimet publike ishin një kontribues i rëndësishëm në rritjen e investimeve në ekonomi. Ato arritën në 6.9 për qind të PBB-së në fund të vitit 2001, nga 6.5 për qind në vitin 2000,. Gjatë vitit 2001 u arrit të finanohen, tërësisht nga buxheti i shtetit projekte të rëndësishme në ujë dhe në shëndetësi, si dhe u bë e mundur rritja e bashkëfinancimit të projekteve të infrastrukturës rurale.

Rritja më e shpejtë e investimeve në raport me kursimet e brendshme¹³, bënë që ky tregues të arrijë në 7.4 për qind të PBB-së gjatë vitit 2001, kundrejt 7 për qind në vitin 2000. Kursimet e huaja vazhduan të plotësojnë diferencën negative të kursimeve dhe investimeve të brendshme, duke mbështetur investimet publike, kryesisht në projekte të rëndësishme infrastrukturore.

Parashikimet e bëra në Kuadrin Afatmesëm të Shpenzimeve (MTEF), të harmonizuara me politikat publike prioritare që ofron Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Social, dëshmojnë se raporti kursime-investime do të vazhdojë të mbetet negativ. Tërheqja e kursimeve të huaja do të mbetet një faktor thelbësor

¹³ Nw mungesw tw llogarive kombwtare, tw dhwnat e investimeve dhe kursimeve janw vlerwsime tw pwrafwrta, sipas FMN-sw.

në mbështetjen e programit të investimeve. Megjithëse mekanizmi i mbështetjes buxhetore të investimeve është përsosur më tej, në saje të hartimit të MTEF, administrimi i shpenzimeve vazhdon të mbetet deficitar. Në mënyrë të veçantë, rritja e aftësive të ministrive për të zhvilluar dhe për të zbatuar programe investimesh dhe ndjekja e vlerësimi i programeve dhe projekteve të investimeve, mbeten drejtime themelore të përsosjes së mëtejshme.

Sektori privat luan rolin kryesor në ecurinë e raportit kursime-investime. Edhe gjatë vitit 2001, forma kryesore e investimit të individëve ishte vendosja e depozitave në sistemin bankar. Sipas të dhënave paraprake, gjendja e depozitave në fund të vitit arriti në 274.5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 20 për qind kundrejt fundit të vitit 2000. Megjithëse investimi në monedha të huaja (depozitat në valutë) ka përbërë një tipar të të gjithë periudhës së tranzicionit, zëvendësimi monetar i realizuar në fillim të këtij viti në Zonën e Euros, ndikoi në rritjen e ndjeshme të depozitave në monedhat huaja, në tërësi, dhe të monedhave përbërëse të shportës së euros, në veçanti. Kështu, depozitat në valutë gjithsej arritën në mbi 88 miliardë lekë (me një rritje prej 38.7 për qind krahasuar me një vit më parë) duke arritur në 32 për qind të totalit të depozitave, nga 27.8 për qind në fund të vitit 2000.

II.2. ZHVILLIMET NË TREGUN E PUNËS

Tregu i punës gjatë vitit 2001 është karakterizuar nga ndryshime në strukturën e tij, si rezultat i veprimt të vazhdueshëm të disa faktorëve, siç janë privatizimi, konsolidimi i mëtejshëm i tregut privat dhe vazhdimësia e bashkëjetesës së tregut formal me atë joformal, i cili, pavarësisht nga mungesa e një llogaritjeje të saktë të tij, në fakt vazhdon të jetë ende i konsiderueshëm.

II.2.1. Tregu i punës.

Në dhjetë vitet e fundit në Shqipëri kanë ndodhur ndryshime të mëdha demografike siç janë: lëvizja e lirë e popullsisë, e cila ka sjellë ndryshime në raportin midis popullsisë urbane dhe rurale, uljen e numrit mesatar të anëtarëve të familjes etj.. Gjithashtu, emigracioni në shifra të larta ka shkaktuar ndryshime të dukshme në hartën demografike të vendit. Këto ndryshime kanë patur ndikimin e tyre në të gjithë jetën ekonomiko-shoqërore të vendit. Por, në mënyrë të veçantë ato janë ndjerë në treguesit e tregut të punës ku mund të përmendim efektin që kanë pasur në rritjen e shkallës së papunësisë, në forcat e punës, në numrin e personave që përfitojnë pagesë papunësie etj..

Box II-2: Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave, prill 2001.

Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe banesave u krye në muajin prill të vitit 2001.

- Nga të dhënat paraprake popullsia më 1 prill 2001 është 3, 087,159 banorë. Nga këta 1, 539, 980 ishin meshkuj dhe 1,547,179 femra. Popullsia urbane përbënte 42 për qind dhe ajo rurale 58 për qind të totalit të popullsisë.
- Gjatë periudhës 1979-1989 popullsia është rritur me 591,800 persona ose 22,8 për qind. Ndërsa, gjatë periudhës 1989-2001 ka një rritje të popullsisë me 95,258 persona ose me rreth 3 për qind si rezultat i një emigrimi shumë intensiv.

Tabelë II-7: Popullsia e Shqipërisë sipas tre regjistrimeve të fundit.

Vitet		1979	1989	2001
Gjithsej	gjithsej	2,590,600	3,182,417	3,087,159
	meshkuj	1,337,400	1,638,074	1,539,980
	femra	1,253,200	1,544,343	1,547,179
Urbane	gjithsej	866,600	1,137,562	1,299,925
	meshkuj	442,000	577,090	641,992
	femra	424,600	560,472	675,933
Rurale	gjithsej	1,724,000	2,044,855	1,787,234
	meshkuj	896,500	1,060,984	897,988
	femra	827,500	983,871	889,246

- Ka ndryshuar ndjeshëm raporti midis popullsisë urbane dhe asaj rurale: kështu në vitin 1979 popullsia urbane përbënte **33.5 për qind** të totalit të popullsisë, në vitin 1989 ishte **35,5 për qind** dhe në vitin 2001 arriti në **42.1 për qind**.

Këto ndryshime kanë ardhur për shkak të shpërnguljeve të shumta të popullsisë brenda vendit, në mënyrë të veçantë nga zonat e veriut në zonat e jugut dhe nga lindja në perëndim të vendit. Pjesën më të madhe të të shpërngulurve e përbëjnë ata që lëvizin nga fshatrat e qytetet e vogla, drejt qyteteve të mëdha. Lëvizja më e madhe e popullsisë verifikohet të ketë qenë drejt zonës bregdetare.

- Ndryshimet e mëdha demografike dhe të urbanizimit janë pasqyruar në uljen e numrit mesatar të anëtarëve që përbëjnë një familje.
- Emigracioni. Numri i banesave të pabanuara rezultoi 92124 ose 12 për qind e fondit të banesave. Ky tregues vjen si rezultat i emigracionit të lartë që ka përjetuar vendi, në mënyrë të veçantë në 10 vitet e fundit. Ka edhe rrethe me rreth 30 për qind banesa të pabanuara apo edhe me 50 për qind banesa të pabanuara, në zonat rurale.

Tregu i punës gjatë vitit 2001 ka patur përmirësim në disa tregues kryesorë, por sidomos në uljen e shkallës së papunësisë. Kështu, gjatë vitit 2001 ka patur ulje në numrin e përgjithshëm të të papunëve dhe, si rrjedhim, në shkallën e papunësisë, në uljen e personave që përfitojnë pagesë papunësie, si dhe në rritjen e numrit të personave të punësuar, në mënyrë të veçantë në sektorin jo bujqësor.

Megjithatë, karakteristikë e këtyre përmirësimeve, gjatë vitit 2001, është gradualiteti i uljes dhe ngritjes së treguesve nga një tremujor në tremujorin tjetër.

Tabelë II-8: Treguesit e punësimit dhe të papunësisë.

	2000				2001			
	T. I	T. II	T. III	T. IV	T. I	T. II	T. III	T. IV
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1306	1293	1289	1281	1283	1269	1261	1256
A) Të punësuar gjithsej	1065	1065	1066	1064	1078	1077	1074	1074
a) në sektorin shtetëror	201	201	198	194	198	197	194	194
b) në sektorin privat jo bujqësor	103	103	107	109	119	119	119	119
c) në sektorin privat bujqësor	761	761	761	761	761	761	761	761
B) Papunësia (në mijë)								
të papunë gjithsej	241	228	223	217	205	192	187	182
Përfitojnë pagesë papunësie	21	22	21	21	21	18	16	15
Shkalla e papunësisë (në %)	18.4	17.6	17.3	16.9	15.96	15.1	14.8	14.4

Vlerësimet e tregut të punës duhen parë me rezerva, për shkak të deformimeve që sjell në treguesit e këtij tregu, ndikimi i faktorëve të tillë siç janë: tregu i zi i punës, migrimi i vazhdueshëm i popullsisë, ndryshimi i raportit të popullsisë rurale e asaj urbane, i cili sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe banesave, është 58 për qind me 42 për qind. Një kontradiktë e dukshme në statistikat e punës, vazhdon të mbetet fakti që megjithë këto ndryshime thelbësore në strukturën e popullsisë, statistikat vazhdojnë të raportojnë një numër të pandryshueshëm të punësuarish, 761 mijë persona, që nga viti 1995 në sektorin privat bujqësor.

II.2.2. Forca e punës

Forca e punës gjithësej ose oferta në tregun e punës shënoi rënie në fund të vitit 2001, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2000. Në fund të vitit 2000 forca e punës gjithësej ishte 1281 mijë persona, ndërsa në fund të vitit 2001 arriti në 1256 mijë persona, duke shënuar një rënie në vlerë absolute me 25 mijë persona ose 1.99 për qind. Kjo rënie është 1.04 për qind më e vogël në krahasim me fundin e vitit 2000. Në uljen e forcave të punës `ka ndikuar më shumë rënia e numrit të të punësuarve, e cila është "thithur" në pjesën e saj (ka ndikuar dhe shtimi i punës së zezë) më të madhe nga emigracioni, ku më i përhapuri është ai sezonal me vendet fqinje.

Nisur nga parashikimet optimiste për strukturën sipas moshave të popullsisë për vitin 2001, pavarësisht nga vlerësimet pozitive për një forcë pune në rritje, statistikat tregojnë të kundërtën. Jo vetëm ka një ulje të forcës së punës, por, për më tepër kjo ulje përbën tendencën përgjatë gjithë vitit 2001. Një nga faktorët e mundshëm, që mund të ketë ndikuar në këtë gjë, është rritja e emigracionit gjatë vitit 2001, që ka shkaktuar rrjedhje më të mëdha të forcave të punës.

II.2.3. Punësimi

Në fund të vitit 2001, numri i të punësuarve gjithsej ishte 1 milion e 74 mijë persona. Kjo shifër është 10 mijë persona më e lartë se shifra e fundvitit 2000. Rritja ka ardhur kryesisht nga shtimi i numrit të të punësuarve në sektorin privat jobujqësor, ndërsa nuk ka rritje në sektorin shtetëror dhe atë privat bujqësor. Ky fakt, tërthorazi, tregon gjallërimin e mëtejshëm të aktivitetit në sektorin privat dhe shpreh mundësinë që ky faktor të jetë shndërruar në faktorin kryesor, i cili mund të gjenerojë vende të lira pune.

Gjatë vitit 2001, ecuria e punësimit ka qenë pothuajse e pandryshueshme, me ngritje dhe ulje të lehta. Kështu, në tremujorin e parë të vitit 2001 pati një ngritje të të punësuarve prej 14 mijë personash, në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2000. Në tremujorët e tjerë të vitit pati rënie të vogla, duke filluar me një rënie me 1 mijë persona në tremujorin e dytë e duke vazhduar me një rënie prej 4 mijë personash, në dy tremujorët e tjerë të këtij viti. Kjo rënie është rezultat i rënies së të punësuarve kryesisht në sektorin shtetëror (me rreth 3000 vetë) si pasojë e thellimit të reformave në këtë sektor të ekonomisë (privatizime në sektorin publik, likuidime, shkurtime të vendeve të punës).

II.2.4. Papunësia

Numri i të papunëve, në fund të vitit 2001, arriti në 182 mijë persona. Kjo shifër është 35 mijë persona më e ulët se shifra e të papunëve në fund të vitit 2000. Si rezultat, shkalla e papunësisë, në fund të vitit 2001, arriti në 14.4 për qind ose 2.5 për qind më pak të papunë se në fundvitin 2000. Rënia e papunësisë gjatë vitit 2001 ka qenë e vazhdueshme nga një tremujor në tjetrin. Kjo ndodh në një kohë, kur numri i të punësuarve gjatë vitit 2001 ka ardhur duke u ulur. Kundërshtia mund shpjegohet me faktin që ekonomia informale duhet të jetë rritur në krahasim me vitin e kaluar, megjithëse edhe për këtë vit nuk ka të dhëna për këtë sektor.

Paradoksi i vitit 2001 është se, megjithëse, ai u karakterizua në mënyrë të dukshme nga prishja e ndërtimeve pa leje dhe futja në tregun e punës e studentëve që mbarojnë studimet e larta, numri i të papunëve njohu rënie të vazhdueshme. Këto përfundime për tregun e punës, vijnë si pasojë e mosnjohjes së ekonomisë së fshehtë, por edhe e mosnjohjes së shifrave të sakta të emigracionit, i cili mendohet të jetë në nivele të larta. Këtë gjë e konfirmon edhe fakti se sot Shqipëria ka mbi 92 mijë banesa të pabanuara. Nga kjo shifër mund


të arrijmë në konkluzionin se emigracioni, të paktën arrin në rreth 500 mijë persona, po të kemi parasysh se në çdo banesë banon më shumë se një familje dhe se çdo familje përbëhet mesatarisht nga 4 persona¹⁴.

Në vitin 2001 ka patur një rënie të vazhdueshme të numrit të personave që përfitojnë pagesë papunësie. Kështu, nga 21 mijë persona që përfitonin këtë pagesë në fund të vitit 2000, kjo shifër zbriti në 15 mijë persona në fund të 2001. Rënia erdhi kryesisht si pasojë e daljes nga skema e pagesës së personave që u punësuan gjatë vitit 2001. Duke patur parasysh dhe faktin që regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe banesave nuk jep të dhëna për një pjesë të madhe të emigracionit sezonal, shifra e emigracionit pritet të jetë më e lartë.

II.3. ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL

Fundi i vitit 2001 ka shënuar realizimin e objektivave buxhetorë për këtë periudhë. Niveli i deficitit buxhetor ishte 4.3 miliardë lekë nën atë të parashikuar dhe burimet për financimin e tij u shfrytëzuan në përputhje me planin. Gjithashtu, treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve janë realizuar brenda parashikimeve të hartuara në planin e buxhetit, megjithatë, vihet re se ecuria e tyre gjatë vitit nuk ka qenë në të njëjtin ritëm. Kështu, vjelja e të ardhurave ka pasur një ritëm pothuajse të njëjtë nga muaji në muaj, me një rritje më të lartë mujore në fund të vitit, ndërsa shpenzimet janë përqendruar kryesisht vetëm në dy periudha, në qershor dhe në dhjetor. Përqendrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të vitit është një karakteristikë e zhvillimeve fiskale dhe si e tillë është e pritshme. Por, duhet theksuar se tejkalimi i ndjeshëm i shpenzimeve në qershor të vitit 2001 është një zhvillim i ri, i cili u pasqyrua edhe në ecurinë e inflacionit për periudhën në vazhdim. Në krahasim me periudhat vjetore të kaluara, niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve ka ardhur duke u rritur, ndërkohë që vihet re tendenca për të mbajtur ekuilibrin në deficitin buxhetor.

Grafik II-3: Ecuria e treguesve fiskalë (në miliardë lekë)




¹⁴ Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe banesave (shiko box II-2).

II.3.1. Të ardhurat buxhetore

Të dhënat operative për sektorin fiskal tregojnë se të ardhurat për vitin 2001 arritën në 135.5 miliardë lekë duke qenë 12.5 për qind më të larta sesa niveli i të ardhurave të vjela gjatë vitit të kaluar. Realizimi i të ardhurave në vitin 2001 ishte në nivelin 95.6 për qind, ndërkohë që në vitin 2000 ky nivel ishte 2.2 për qind më i lartë. Burimi kryesor i të ardhurave kanë qenë të ardhurat nga taksat duke kontribuar me 67.8 për qind në të ardhurat në total, ndërsa të ardhurat nga kontributet dhe ato jotatimore përbëjnë respektivisht 16.6 dhe 15.6 për qind të totalit.

Grafik II-4: Kontributi i të ardhurave tatimore tek të ardhurat totale sipas zërave.



Vjelja e të ardhurave ka qenë më e suksesshme në tremujorët e parë dhe të dytë, kur niveli i tyre i tejkaloi parashikimet për këtë periudhë. Ndonëse, sikurse edhe pritej, niveli i të ardhurave u rrit në muajin e fundit të vitit, realizimi i tyre për gjashtëmujorin e dytë ka qenë nën nivelin e parashikuar.

Tabelë II-9: Ritmika e të ardhurave gjatë vitit 2001 (në miliardë lekë).


	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV	Realizimi për vitin 2001 (në %)
Të ardhura në total:	29.6	35.8	33.4	36.5	95.6
Tatimore	21.1	20.7	24.0	26.1	96.1
Jotatimore	3.1	9.7	3.7	4.5	91.0
Kontribute	5.4	5.4	5.7	5.9	97.0

II.3.2. Shpenzimet buxhetore


Shpenzimet buxhetore për vitin 2001 arritën shifrën 185.7 miliardë lekë duke qenë 5.4 për qind nën nivelin e parashikuar për to në planin buxhetor. Pjesën më

të madhe të tyre e zënë shpenzimet korente, 76 për qind, ndërkohë që vihet re rritje e peshës së shpenzimeve kapitale në 23 për qind nga 20 për qind që ishte vitin e kaluar.

Grafik II-5: Shpenzimet sipas zërave.



Shpenzimet janë përqendruar kryesisht në dy muaj të vitit, në qershor dhe në dhjetor. Në muajin qershor, niveli i shpenzimeve kapitale ishte 71.4 për qind më i lartë sesa parashikimi për to për periudhën në fjalë. Kulmi tjetër i rritjes së këtyre shpenzimeve ishte në dhjetor, kur ato kontribuan 37 për qind të shpenzimeve totale për muajin. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, shpenzimet në total për muajin ishin 2.9 miliardë lekë ose 11.5 për qind më të larta. Vihet re se ky ndryshim i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve kapitale, ndërsa shpenzimet korente për të dy muajt janë pak a shumë në të njëjtat nivele.



Grafik II-6: Ritmika e shpenzimeve gjatë tre viteve të fundit (në miliardë lekë)

Statistikat fiskale tregojnë se në fund të vitit 2001, plani për shpenzimet korente dhe kapitale ishte realizuar përkatësisht në nivelin 99 dhe 96 për qind. Ndonëse, në terma absolutë, shpenzimet janë kryer brenda parashikimeve për vitin, përqendrimi i tyre vetëm në dy periudha të shkurtra të tij, ka ndikuar në rritjen e

presioneve inflacioniste në vend për një periudhë në vazhdim prej të paktën tre muajsh.

II.3.3. Deficiti buxhetor

Deficiti buxhetor në fund të vitit arriti në 50.2 miliardë lekë duke qenë 3.4 për qind më i lartë sesa ai në fund të vitit paraardhës. Krahasuar me parashkimin, ky nivel ishte 7.9 për qind më i ulët. Duke ndjekur ritmikën e shpenzimeve gjatë vitit, ky tregues u thellua në muajin qershor dhe sikurse pritej edhe në muajin dhjetor. Mbulimi i tij është bërë 56 për qind me mjete të brendshme ndërsa pjesa tjetër me financim të huaj. Të ardhurat nga privatizimi kanë financuar 25 për qind të deficitit dhe ato janë përdorur kryesisht në gjysmën e parë të vitit. Në këtë periudhë, deficiti është mbuluar me këto të ardhura dhe me financimin e huaj dhe ndonëse, siç u përmend, kërkesa për financim ishte e lartë në muajin qershor, sistemi bankar nuk ndjeu presione për të financuar qeverinë në këtë periudhë. Nevoja e qeverisë për financim nga bankat u ndje në gjysmën tjetër të vitit dhe në dhjetor ato ishin burimi kryesor i financimit të brendshëm, i cili për gjithë vitin rezultoi 1.6 për qind më i lartë sesa parashikimi në planin e buxhetit.

Tabelë II-10: Treguesit fiskalë në % ndaj PBB-së.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Të ardhurat	24.1	23.4	18.3	16.5	16.9	21.1	22.4	22.8
nga taksat dhe tatimet	16	13.2	10.7	9.8	12.3	12.7	15.6	17.2
Shpenzimet	33.1	33.6	31.3	29.5	27.3	32.7	31.4	31.2
shpenzime kapitale	3.4	8.3	6.3	4.4	5.3	5.8	6.5	7.2
Deficiti buxhetor	-9	-10.2	-13	-13	-10.4	-11.6	-9.1	-8.5
Financim i brendshëm	8.6	6.5	10.2	11.2	6.6	5.5	4.9	4.8
Financim i jashtëm	0.4	3.7	2.8	1.9	3.8	6.1	4.2	3.7

II.4. ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

II.4.1. Karakteristika të inflacionit, gjatë vitit 2001

Konceptimi i politikës monetare edhe për vitin 2001, u përqendrua në arritjen e objektivit për normën e inflacionit në fund të vitit, në kufijtë 2 deri 4 për qind. Kjo nënkuptoi jo vetëm pritshmëri për norma të ulëta pozitive të inflacionit gjatë vitit, por në të njëjtën kohë edhe të përshtatshme për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit.

Zhvillimet në çmimet e konsumit, treguan se objektivi i përcaktuar për infacionin u respektua, duke mos kaluar kufijtë e programuar për të në fund të vitit.

Konkretisht, norma vjetore e inflacionit rezultoi 3.5 për qind, inflacioni mesatar arriti në 3.1, ndërsa inflacioni bazë arriti në 1.08 për qind.

Veçori e dallueshme e inflacionit ishte se gjatë vitit të kaluar u përvijua tendenca në rritje. Faktorët nga krahu i ofertës, gjykohet të kenë patur ndikimin më të fuqishëm në këtë tendencë, ndërkohë që edhe ata nga krahut të kërkesës kanë qenë shpeshherë të pranishëm. Dendësia dhe përsëritja e veprimit të tyre, krijoi “mbivendosje”, rezultatja e së cilës, u reflektua në rritje të presioneve inflacioniste, sidomos në gjysmën dytë të vitit.

Mund të themi se presioni i disa ngjarjeve mjaft të rëndësishme që ndodhën gjatë vitit të kaluar, brenda dhe jashtë vendit, bëri që sfondi në të cilin do të vizatohej tendenca e inflacionit, në pjesën më të madhe të vitit, të ishte në ngjyrën “gri”. Për më tepër, këto ngjarje u karakterizuan nga natyra *shock*, dhe në pjesën më të madhe të tyre patën një kohëzgjatje veprimi të konsiderueshme. Ndër to mund të rradihen:


- ngadalësimi i ekonomisë botërore prej tremujorit të dytë të vitit;
- konflikti i armatosur në FYROM i nisur në muajt e pranverës;
- fushata elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të muajit qershor;
- deklarimi për rritjen e pagave dhe të pensioneve në muajin korrik;
- sulmi terrorist ndaj SHBA-së, në 11 shtator;
- situata e rëndë energjitike e vendit gjatë gjithë vitit e shndërruar në një krizë të thellë, sidomos, gjatë dy muajve të fundit të tij;
- vendosja e sistemit dytarifor të energjisë elektrike, e zbatuar në muajin dhjetor;
- situata e paqëndrueshme politike dhe qeverisëse në vend, e tronditur në muajin nëntor;
- dimri i pazakontë për shkak të temperaturave të ulëta të motit.

Prania e këtyre ngjarjeve dhe e efekteve të gjeneruara prej tyre, nxori në pah, një tjetër veçori të ecurisë së inflacionit të shprehur në **zbehjen dhe sfazimin në kohë të ndikimeve sezonale**. Ato nuk u shfaqën me rregullsinë dhe intensitetin e manifestuar në historinë dhjetëvjeçare të serisë së inflacionit.

Për pasojë, tendenca e inflacionit, pësoi tronditje dhe luhatje. Më të spikaturat u evidentuan në pjesën e dytë të vitit, ndoshta edhe për shkak të intensitetit të ngjarjeve dhe rëndësisë së tyre. Kështu, **muaji korrik shënoi pikën më “të nxehtë”**, në rrjedhën e inflacionit, duke u faktuar **niveli maksimal** i normës vjetore të tij, 5.6 për qind apo 1.6 pikë përqindjeje më lart se kufiri i sipërm i objektivit. Po kështu, **tendencë rritëse** të dukshme të tij ndeshim në muajt **nëntor e dhjetor**, kur normat vjetore arritën përkatësisht, 2.8 dhe 3.5 për qind. **Norma më e ulët** vjetore e inflacionit u faktua në muajin **tetor**, 1.8 për qind apo – 0.45 për qind në nivel mujor. Ky fakt vlen të citohet, sepse shifra e këtij muaji u

shfaq si e pazakontë në historinë e tetorëve të kaluar, mjaft e ulët dhe për më tepër në vlera negative.

Grafik II-7: Ecuria e inflacionit për periudhën 1998-2001 (në %).




II.4.2. Kategori të ndryshme të inflacionit

Megjithëse inflacioni kaloi edhe periudha të vështira gjatë vitit të kaluar, norma e përcaktuar si objektiv për të, u respektua. Respektimi i këtij objektiv ka ardhur jo vetëm si rezultat i ndjekjes së vazhdueshme të ecurisë së çmimeve të konsumit në tërësi, por edhe i përdorimit dhe shfrytëzimit të informacionit, që sjellin edhe kategoritë e tjera të inflacionit të përdorura nga banka qendrore. Tërësia e këtij informacioni dhe analiza e tij është vënë në shërbim të autoritetit monetar dhe e ka ndihmuar atë në një proces vendimmarrjeje të matur.

Njëra nga kategoritë e inflacionit që **Banka e Shqipërisë**, përdor në analizën e saj është ajo e **inflacionit bazë**, i cili është i korreluar në shkallë mjaft të lartë me rritjen e parasë. Në këtë kategori, evidentohet inflacioni i grupeve apo i nëngrupeve të mallrave që paraqesin qëndrueshmëri më të lartë të çmimeve, pra luhatshmëri më të ulët. Në këtë mënyrë, ai pasqyron më pastër inflacionin “e shkaktuar” nga banka qendrore.

Inflacioni bazë, për vitin e kaluar ishte në nivele të ulëta. Megjithatë tendenca e tij ishte në rritje, duke shënuar pikën e vet më të lartë në muajin dhjetor, kjo edhe për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Kështu, niveli i tij negativ dhe mjaft i ulët pozitiv (më i vogël se një për qind) përgjatë gjithë periudhës deri në nëntor 2001, në muajin dhjetor kaloi vlerën një, duke arritur në 1.33 për qind.

Grafik II-8: Ecuria e normës vjetore të inflacionit.



Inflacioni mesatar, është një kategori më e përgjithshme e matjeve të kryera deri më tani. Vlerat e tij, mbështeten mbi të dhënat historike të viteve të kaluara. Ky skenar mbështetet në supozimet e:

- përjashtimit të periudhave në të cilat inflacioni ka pësuar goditje nga ngjarje të natyrës *shock*;
- dhënies së peshave më të larta, periudhave (viteve) të fundit.

Tendencën në rritje të inflacionit, e dëshmoi edhe kjo kategori. Në nivel vjetor ai arriti në 3.1 për qind, ndërkohë që një vit më parë ai qëndronte në nivelin 0 për qind. Faktorët, tashmë të përmendur, duke u konsideruar në pjesën më të madhe si faktorë *shock*, kanë tronditur tendencat mesatare të serisë së inflacionit gjatë vitit 2001.


Ecuria e inflacionit mujor gjatë vitit 2001, tregoi se shmangiet më të dukshme ndaj ecurisë historike mesatare u shfaqën në muajt janar, shkurt dhe tetor në kahun zbritës dhe në muajt nëntor dhe dhjetor, erdhi duke u theksuar kahu rritës kundrejt tendencës historike.

Tabelë II-11: Inflacioni faktik dhe inflacioni mesatar (norma mujore në %).

Muajt	Inflacioni mujor 2001	Inflacioni mesatar	Diferenca (inf.mujor-inf. mesatar %)
Janar	-1.29	0.65	-1.94
Shkurt	-1.35	-0.39	-0.96
Mars	0.29	0.1	0.19
Prill	0.84	0.97	-0.13
Maj	0.20	0.22	-0.02
Qershor	-0.66	-0.88	0.22
Korrik	-1.20	-1.33	0.13
Gusht	-1.00	-0.04	-0.96
Shtator	1.10	0.75	0.35
Tetor	-0.45	0.91	-1.36
Nëntor	1.88	0.95	0.93
Dhjetor	5.30	2.5	2.8

Inflacioni me shportën e re, përfaqëson një tjetër kategori që përdoret në analizat e Bankës së Shqipërisë. Kjo për faktin se ai është përfaqësues më mirë me inflacionin real. Kjo kategori është përdorur menjëherë pas marrjes së rezultateve të para nga vërtetimi i buxhetit të familjeve nga INSTAT, në vitin 2000. Në këtë vërtetim rezultoi se pesha që zë grupi malli “ushqim-pije-duhan” në konsumin e familjeve shqiptare është reduktuar me rreth 20 pikë përqindjeje në krahasim me vitin 1993. Një llogaritje e përafërt e inflacionit, që e konsideron këtë peshë prej rreth 50 për qind të konsumit në buxhetin e familjeve, përafëron më së miri inflacionin me shportën e re. Duket qartë, që kjo kategori inflacioni, ndikon më së shumti inflacionin aktual, duke qëndruar më pranë vlerës së tij numerike dhe, për pasojë, edhe prirjes së tij. Nuk mund të dallohet një tendencë e qartë e ndryshimit midis këtyre dy kategorive. E rëndësishme është të theksohet se rënia e peshës së grupit “ushqim-pije-duhan” në konsumin familjar, duhet të ndikojë në vlera më të qëndrueshme të inflacionit. Kjo, për faktin se ai karakterizohet nga ndryshueshmëria më e lartë e çmimeve, pra “vuan” më shumë se çdo grup tjetër fenomenin e sezonalitetit.

Grafik II-9: Kategori të ndryshme të normës mujore të inflacionit për periudhën janar 1998-dhjetor 2001.



Tabelë II-12: Diferenca ndërmjet inflacionit faktik dhe inflacionit me shportën e re (norma mujore në %).

Muajt	Diferenca (Inf. Total -Inf. me shportën e re)			
	Viti 1998	Viti 1999	Viti 2000	Viti 2001
Janar	0.62	0.26	0.17	-0.39
Shkurt	-0.30	-0.16	0.37	-0.30
Mars	-0.21	-0.03	-0.29	0.27
Prill	0.34	0.06	0.60	0.49
Maj	-0.05	-0.17	0.28	0.08
Qershor	-0.64	-0.90	-0.76	-0.23
Korrik	-0.77	-0.25	-0.83	-0.48
Gusht	-0.02	-0.23	0.07	-0.31
Shtator	0.21	0.04	0.35	0.23
Tetor	0.02	0.10	0.49	-0.10
Nëntor	0.00	0.11	0.21	0.73
Dhjetor	0.50	0.77	1.40	1.93

Duke qenë se prezantimi i shportës së re do të nënkuptojë rinovimin e saj në tre drejtime kryesore: në artikuj, në pesha të konsumit sipas artikujve dhe në peshat që zënë rrethet në llogaritjen e IÇK-së, rishikimi i indeksit të çmimeve të konsumit për periudhat e kaluara, me këtë shportë, paraqet një përparësi dhe kusht të rëndësishëm, për të vijuar analizat për vendimmarrjen në bankën qendrore.

Rezultatet e dalta edhe nga kategoritë më sipër, në mënyrë të dallueshme dëshmojnë për tiparin kryesor të inflacionit gjatë vitit 2001, konvergimi drejt niveleve më të larta për të gjitha kategoritë, kundrejt një viti më parë.

Box II-3: Llojet e inflacionit që mund të përdoren në të ardhmen nga Banka e Shqipërisë si nivele objektive të politikës monetare.

Objektivi i politikës monetare për normën e inflacionit, është një pikë e diskutueshme, sidomos, në kushtet e ekonomisë shqiptare, e cila është në rrugën e rregullimeve strukturore. Tashmë dihet që, politika monetare Bankës së Shqipërisë, ndjek si tregues për objektivin e saj normën vjetore të inflacionit në fund të vitit.

Megjithatë, spektri i versioneve të tjera për zgjedhjen e një regjimi për objektivin për inflacionin është i larmishëm dhe pa dyshim, zgjedhja midis tyre me qëllim adoptimin e një forme tjetër në të ardhmen, nuk është e lehtë. Kjo për faktin se procesi i përzgjedhjes së versioneve lidhet ngushtësisht me një varg kushtesh që, mbi të gjitha, i referohen stadi aktual të zhvillimit ekonomik të vendit. Ndër llojet e inflacioneve që përdoren më shpesh si objektiva për politikën monetare të bankave qendrore në botë do të përmendnim:

- a) objektivi për të arritur një nivel **inflacioni aktual** në normë vjetore, **në fund të vitit**, në formën e një **intervali vlerash**;
- b) objektivi për të arritur një nivel **inflacioni aktual** në normë vjetore, **në fund të vitit**, **në një vlerë të vetme** apo **regjimi i *inflation targeting*** ;
- c) objektivi për të patur një nivel vjetor **të inflacionit bazë**, **në formë intervali apo të një vlere të vetme**;
- d) objektivi për inflacionin mund të fokusohet në **një vlerë apo interval vlerash mesatare vjetore**.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë përdor variantin e parë, i cili ka tre karakteristika thelbësore:

- së pari, është një objektivi në interval;
- së dyti, është një vlerë aktuale;
- së treti, është një vlerë e fundit të vitit.

Bazuar në këto veti, do të gjykonim që një objektivi në interval është i përshtatshëm për situatën aktuale të zhvillimit ekonomik të vendit. Mendojmë se vendosja e objektivit në një vlerë të vetme është ende shpejt, parametra të tjerë mjaft të rëndësishëm ekonomikë duhet të plotësohen për të arritur në pika mjaft "strikte". Nga ana tjetër, ai është më fleksibel përballë reformave strukturore në vend. Një anë tjetër, vetia e vlerës aktuale të inflacionit mbart në vetvete më shumë transparencë, kërkesë e domosdoshme për ushtrimin e një politike monetare të qartë. Për më tepër, ekzistenca e një transparence reale, është një kusht i domosdoshëm për zbatimin e një regjimi të ardhshëm të *inflation targeting* në politikën monetare të bankës sonë qendrore.

Vetia e tretë, inflacioni i faktuar në fund të vitit, është një informacion përfundimtar, që kufizohet vetëm për një moment kohe. Duket sikur edhe përpjekjet e politikës monetare kufizohen vetëm brenda një muaji apo vetëm në një shifër statistikore. Në fakt, fundviti kurorëzon punën mjaft të kujdesshme të kryer gjatë gjithë vitit nga autoriteti i vetëm monetar për realizimin e inflacionit brenda objektivit.

Prandaj, duke mos e kufizuar punën vetëm në një moment kohor dhe vetëm në një interval, Banka e Shqipërisë, në procesin e vendimmarrjes mbështetet edhe tek informacioni që sjellin kategoritë e tjera të inflacionit.


II.4.3. Zhvillimet sipas grupeve kryesore

Zhvillimet në çmimet e konsumit edhe për vitin 2001, konfirmuan **ndikimin e madh** që mbart në vetvete grupi **“ushqim-pije-duhan”**, në nivelin e përgjithshëm të inflacionit. Për më tepër, në dy vitet e fundit ky ndikim është mjaft i ndjeshëm, duke e shënuar, në mënyrë të rregullt, pikën më kritike në muajt dhjetorë. Në këtë grup, **nëngrupi “fruta-perime”** ka dhënë ndikimin më të ndjeshëm për vitin 2001. Evidentohet se rritje të pazakontë pati grupi “energji-qira-ujë-lëndë djegëse”, për shkak të ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike. Megjithëse me një peshë të vogël në shportën e llogaritjes së inflacionit, ky grup manifestoi një rritje të konsiderueshme nga njëri vit në tjetrin, me rreth 5.5 pikë përqindjeje më lart se viti 2000.


Tabelë II-13: Norma mujore e inflacionit në përqindje sipas grupeve kryesore të shportës.

	1998	1999	2000	2001
Inflacioni sipas grupeve kryesore të shportës	2.05	2.25	4.59	5.30
Ushqim, pije, duhan	2.54	2.99	6.58	6.38
- <i>Fruta-perime</i>	9.13	9.89	24.83	19.84
Energji, qira, ujë, lëndë djegëse	2.19	2.46	0.76	6.25
Artikuj shtëpiakë	-0.10	-1.79	0.33	-0.20
Veshje dhe këpucë	0.55	-0.21	0.00	-0.03
Kujdes mjekësor	0.18	-0.12	1.42	1.13
Transport dhe komunikacion	0.01	0.11	-0.18	-0.45
Argëtim, arsim dhe kulturë	-0.13	-1.76	0.25	0.3
Kujdes vetjak	0.4	0.63	-0.04	0.32

GrafikII-10: Kontributi i grupmallrave të IÇK tek inflacioni.



Grafik II-11: Kontributi i nëngrupeve të “ushqim, pije, duhan” në inflacion.




II.4.4. Faktorët që ndikuan në ecurinë e inflacionit.

Presionin më të lartë në inflacionin e vitit 2001, e shkaktuan, kryesisht, faktorët *shock*. Periudha që u vu më shumë nën veprimin e këtyre faktorëve ka qenë pjesa e dytë e vitit.

1. Një nga faktorët që ngarkoi më shumë këtë periudhë është ai i mungesës së **energjisë elektrike**, i cili u kthye në mënyrë graduale në “një protagonist” të vlerave të inflacionit. Për më tepër, në dy muajt e fundit të vitit, ai **prodhoi një krizë të vërtetë**, që tronditi edhe më shumë inflacionin. Masa për vendosjen e një **sistemi dytarifor për energjinë elektrike**, dha një rritje të menjëhershme në shifrën e inflacionit, e reflektuar në muajin dhjetor. Përveç të tjerash, një faktor i tillë ndikoi edhe në reduktimin e kapaciteteve prodhuese, sidomos në dy muajt e fundit të vitit 2001.
2. Faktori **sezonal në kahun rritës për inflacionin, për të dytin vit rradhazi, u manifestua me forcë** në fund të vitit. Megjithëse, norma vjetore e inflacionit u kontrollua duke u mbajtur brenda programit për të, gjithnjë e më shumë po vërtetohet se sezonaliteti në këta muaj është mjaft i pranishëm. Ky fenomen nxitet gjithnjë e më shumë nga **gjallërimi i elementeve spekulative**, që spikat kryesisht në situata të vështira apo në periudha festash, kur edhe kërkesa për mallra konsumi është më e shprehur. Gjithashtu, këto elemente u bënë gjithnjë e më shumë të pranishme në kushtet e **tronditjes së situatës politike dhe qeverisëse** në vend në fund të vitit. Megjithatë, vlerësohet që situata të tilla, ndikojnë më shumë në pritjet për inflacionin për periudhat e ardhshme.

3. **Situata herë tepër e acaruar dhe herë e paqëndrueshme, në FYROM,** shkaktoi rënie apo kufizime të mëdha të aktivitetit tregtar me apo nëpërmjet këtij vendi. Importet e mallrave nga ky vend pësuan ulje, duke gjeneruar mungesa në tregun e brendshëm, sidomos për produkte ushqimore. Për pasojë pati çmime relativisht të larta, për sezonin, konkretisht në periudhën e verës. Gjithashtu, ky konflikt shkaktoi ndërprerje të rrugëve të transportit, duke kërkuar zëvendësimin e tyre, pra edhe kosto më të larta.
4. **Përqendrimi i shpenzimeve buxhetore,** në mënyrë mjaft të shprehur, madje më shumë se çdo vit tjetër, gjatë periudhës së fushatës elektorale, u pasqyrua në mënyrë evidente në inflacionin e muajve korrik dhe dhjetor.
5. Në kushtet e një ekonomie me një profil të theksuar importues, është ekonomikisht e pranueshme që inflacioni i vendit të mos jetë “indiferent” ndaj rrezikut të ekspozimit përballë **“inflacionit të importuar”**. Është verifikuar tashmë që ekziston një korrelacion pozitiv ndërmjet inflacionit në vendin tonë dhe inflacionit të vendeve kryesore partnere, sidomos për grupin e mallrave ushqimore.
6. Veçori e fundvitit të kaluar ishte **moti me temperatura të ulëta,** të pandeshura prej shumë kohësh në Shqipëri, faktor, që goditi ofertën në tregun e mallrave të konsumit të përditshëm duke shkaktuar edhe rritje të kostove të prodhimit dhe të transportit të tyre. Në rrethet që vuajtën më shumë këto pasoja u manifestuan rritje të çmimeve të mallrave në treg.

Grafik II-12: Krahasimi i çmimeve të ushqimeve të tregut shqiptar dhe të atij grek.



Nga ana tjetër, faktorët me natyrë ekonomike, që ndikuan në sjelljen e inflacionit gjatë vitit të kaluar ishin:

- 7. Rritja e lartë e ofertës monetare dhe përshpejtimi i kreditimit.** Tashmë, është evidentuar prej mëse dy vitesh, që tendencat e inflacionit kanë ndjekur me një vonesë negative prej afro 1-3 muaj, tendencat e agregatit monetar M3. Megjithatë, pjesa që duket se po i jep më tepër ngjyra inflacionit është M1. Del në pah se, tronditjet më të forta të inflacionit në muajt dhjetor 2000 dhe korrik 2001, janë mjaft të lidhura me rritje të shpejta të M1. Baza kryesore e kësaj rritjeje vlerësohet të ketë ardhur nga rritja e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare.
- 8. Sjellja e kursit të këmbimit.** Faktori kurs këmbimi, duke gëzuar edhe potencën e njërit prej përcaktuesve kryesorë në ecurinë e inflacionit, demonstroi periudha nënçmimi të monedhës vendase kundrejt asaj amerikane, kryesisht në muajin qershor. Ky ndikim, në përgjithësi, është pasqyruar me një muaj vonesë, ashtu siç edhe pritej, në inflacion. Mbiçmimi i lekut, arriti kulmin e tij në periudhën nëntor-dhjetor, kjo edhe për shkak të përgatitjes së agjentëve ekonomikë dhe privatë për **prezantimin e euros fizike**.
- 9. Inercia e inflacionit.** Ndonëse ky faktor ende nuk është pasqyruar në mënyrë të kristalizuar në studime të mirëfillta, gjykohet se roli i tij gjithnjë e më shumë po bëhet i pranishëm në vlerat e inflacionit aktual. Kështu, edhe pse popullsia e ka ndjerë tashmë që rritjet e çmimeve, sidomos në fund të vitit dhe në periudha të vështira ekonomike kanë natyrë të pastër spekulative, përsëri në mënyrë “të pandërgjegjshme”, nga “një frikë” e trashëguar stimulon rritje të pritshme çmimesh. Edhe këtë fundviti, ky efekt u ndje në mënyrë të theksuar.
- 10. Rritja e kostove të produkteve,** gjeneron në mënyrë të pashmangshme rritje çmimesh. Faktori “kryefjalë”, “krizë energjitike”, shkaktoi “shpenzime shtesë”, për një pjesë të konsiderueshme të bizneseve të vogla dhe të mesme dhe kryesisht në sektorin e shërbimeve me blerjen e gjeneratorëve. Këto shpenzime, u reflektuan në rritje të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të ofruara prej tyre. Nga ana tjetër, pjesë e këtij procesi është edhe deklarimi për rritje pagash në muajin korrik në masën 8 për qind si edhe rritja e pensioneve. Megjithëse rritja e pagave do t’i përkiste vetëm sektorit shtetëror, ajo pritet të ketë dhënë ndikimin e vet edhe në sektorin privat, por meqenëse statistikatat e këtij sektori dhe në veçanti të atij të pagave dhe sigurimeve shoqërore janë mjaft “të varfra”, është e vështirë të matet ndikimi i tij në inflacion.

Si konkluzion mund të themi se viti 2001, konfirmoi paralajmërimin e bërë nga banka qendrore për hyrjen e ekonomisë së vendit në një fazë zhvillimesh me inflacion pozitiv, pas periudhës relativisht të gjatë deflacioniste. Për më tepër, pritshmëritë tentojnë drejt një zgjatjeje të një shtate të tillë, kryesisht, për shkak të gjendjes së rëndë energjitike të ekonomisë shqiptare.

II.4.5. Konsiderata të përgjithshme mbi politikën monetare të vitit 2001 dhe objektivin e saj final

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2001, kishte të njëjtin objektiv, atë të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Në përmbushjen e këtij objektiv ajo i kushton një vëmendje prioritare treguesve monetarë. Njohja e një roli parësor për agregatët monetarë në hartimin dhe vlerësimin e politikës monetare mbështetet si në teorinë ekonomike dhe në përvojën e ekonomisë shqiptare me inflacionin. Më konkretisht, rritja e masës monetare përtej tendencës historike që, në mungesë të fenomeneve *shock*, i korrespondon dhe nevojave të ekonomisë për mjete monetare, është provuar se është një premisë për shfaqjen e inflacionit. Në programimin e ritmit të rritjes së ofertës monetare, Banka e Shqipërisë niset nga parashikimi i kërkesës së ekonomisë për mjete monetare.

Pavarësisht presionit të ushtruar nga faktorët *shock* në ekonomi, Banka e Shqipërisë, mbajti nën kontroll të vazhdueshëm inflacionin. Në kushtet e një periudhe parapërgatitore, për zbatimin në terma afatmesëm të një regjimi *inflation targeting* të politikës monetare, përpjekjet dhe hulumtimet e politikës monetare u përqendruan në gjetjen e shtigjeve të drejta dhe sa më të qarta të përcimit të vendimeve të saj, pra të mekanizmit të transmisionit, për të parandaluar rritje apo destabilizim të mëtejshëm të inflacionit.

Rritja e presioneve inflacioniste, sidomos në pjesën e dytë të vitit, e bëri mjaft të kujdesshme Bankën e Shqipërisë në ndjekjen e ecurisë së çmimeve të konsumit, krahas treguesve të tjerë. Kjo u bë me synimin që vendimet e marra prej saj të siguronin zbutjen e presioneve inflacioniste në të ardhmen. Kështu, për një periudhë relativisht të gjatë kohe (1998-gjysma e parë e vitit 2001) u zbatua një politikë monetare zbutëse, madje agresive, nëpërmjet reduktimeve të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit. Në gjysmën e dytë të vitit 2001, Banka e Shqipërisë adoptoi një politikë monetare neutrale kryesisht nëpërmjet këtyre veprimeve:

- ndërrimin e formës së ankandit të repove nga ankand me shumë çmime në ankand me çmim fiks, duke e përcaktuar çmimin në nivelin 6.5 për qind (maj 2001);
- rritjen e normës bazë të interesit nga 6.5 për qind në 7 për qind në muajin gusht 2001; dhe
- mosndryshimin e normës bazë të interesit në periudhën vijuese.

Të gjitha këto qëndrime përçuan në treg sinjalin, që niveli i arritur i interesave ishte optimal dhe nuk duhej të ushtrohej më presion për reduktimin e mëtejshëm të tyre.

II.5. ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM


Zhvillimet e bilancit të pagesave për vitin 2001 evidentojnë një rritje të madhe të transaksioneve korente, e cila është shkaktuar kryesisht nga rritja e vlerës së transaksioneve të tregtisë së jashtme dhe atyre të shërbimeve. Në nivel viti, totali i transaksioneve korente vlerësohet rreth 3.6 miliardë dollarë ose 16.4 për qind më i lartë se në vitin paraardhës. Përveç tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente. Në fund të vitit llogaria korente u mbyll me një deficit prej 54 për qind më të lartë se ai i vitit 2000, dhe zë rreth 6 për qind të PBB-së. Bilanci korent, përjashtuar transfertat, vlerësohet 11.7 për qind më i lartë se një vit më parë. Hyrje të larta në kapitale kanë financuar deficitin korent me 93.5 për qind.

Në përgjithësi, mund të thuhet se treguesit kryesorë të bilancit të pagesave në fund të vitit kanë tejkaluar zhvillimet e parashikuara në programin monetar. Kështu, llogaria korente u mbyll me një deficit 18 për qind më të ulët se parashikimi; bilanci i llogarisë kapitale realizoi rreth 70 për qind të vlerave të parashikuara në program.

II.5.1. Bilanci tregtar

Me importet prej 1331.6 milionë dollarë dhe eksportet 305 milionë, deficitin e tregtisë së jashtme në mallra, gjatë vitit 2001, arriti në 1027 milionë dollarë amerikanë. Kundrejt vitit 2000, deficitin tregtar u rrit me 25 për qind, e ardhur kryesisht nga rritja prej 23.7 për qind e importeve dhe rritja e eksporteve prej 19.4 për qind.

Grafik II-13: Treguesit e tregtisë së jashtme në % ndaj PBB-së.



Rritja në **eksporte** erdhi si rezultat i rritjes së volumit të mallrave të përpunuar të cilët vazhdojnë të mbajnë ekskluzivitetin e eksporteve tona me rreth 73 për qind të volumit të përgjithshëm të eksporteve. Gjithashtu në rritje, edhe pse i vogël në volum, shfaqet eksporti nga prodhimi i brendshëm (me 8 për qind).

Edhe këtë vit, artikuj tekstil dhe veshje të kokës dhe këmbës ishin kategoritë kryesore të mallrave të përpunuar në Shqipëri.

Në krahun e **importeve**, peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë grupmallrat makineri dhe pajisje (18 për qind të totalit), produkte minerale (14 për qind të totalit) dhe tekstilet dhe artikujt tekstil (14 për qind të totalit). Importi tregtar shënoi rritje përgjatë gjithë kategorive kryesore të mallrave, megjithatë ndikimin më të madh në rritje të volumit të përgjithshëm kundrejt një viti më parë e dha rritja e importeve në makineri e pajisje (importe në antenna për valë telefonike, në përgjigje të zgjerimit të shërbimeve telefonike dhe gjeneratorë elektrik) rritja e importeve në produkte minerale (rritje të importeve në energji elektrike dhe rritje të importeve në lëndë djegëse).

Tabelë II-14: Struktura e import-eksporteve sipas grupmallrave.

(milione usd), viti 2001	Importi	Eksporti
Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	28.6	2.3
Produktet vegjetale	100.3	11.4
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	19.8	0.0
Ushqime të përgatitura, pije alkolike e uthull, duhan	107.1	14.1
Produktet minerale	184.6	5.9
Produktet e industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	71.5	3.0
Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	37.3	1.0
Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	27.6	10.9
Druri, tapa art. e tyre;prodhime kashte, kallama	12.1	8.7
Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art.të tyre	20.1	1.7
Tekstilet dhe artikujt tekstil	136.8	113.8
Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat, lule artificiale	47.3	87.1
Art. prej guri, allçie, çimentoje;qeramike;qelq	49.2	1.8
Perlat; gurë e metalet e çmuar;bizhuteri; monella	0.4	4.5
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	117.7	24.4
Makineri e pajisje mekanike,elektrike, pjesët e tyre	244.1	7.1
Mjete transporti,avionë,anije,pajisje shoqëruese transp.	70.0	0.9
Instrumente e aparate optike;orë;instrum. muzikore	19.3	0.2
Armët e municione;pjesët e plotësuesit e tyre	0.6	0.4
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	30.4	5.1
Veprat e artit,copat e mbledhura nga antikat	0.0	0.1
TOTALI	1324.8	304.6

Burimi: Banka e Shqipërisë, Mars 2002.

Tregtia e jashme mbetet e orientuar drejt shkëmbimeve me vendet e Bashkimit Europian, me partnerë kryesorë brenda këtij grupi, Italinë dhe Greqinë. Ndërkohë që, tregtia në rajon mbetet në nivele shumë të ulëta. Kështu, importet nga vendet e Bashkimit Europian (Itali, Greqi dhe Gjermani, si partnerët kryesorë) zunë 78 për qind të totalit, ndërsa importet nga vendet e rajonit vetëm 6.3 për qind të importeve. Edhe gjeografia e eksporteve tregon se ato janë të përqendruara në 92 për qind drejt vendeve të BE-së dhe vetëm 4.6 për qind drejt vendeve të rajonit.

Box II-4: Projektstrategjia e nxitjes së eksporteve¹⁵.

Në zbatim të programit të qeverisë për përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen ekonomike, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë ka koordinuar punën për hartimin e Projektstrategjisë Kombëtare të Nxitjes së Eksporteve. Objektivi themelor i projektdokumentit mbetet nxitja e eksporteve shqiptare në tregjet e huaja nëpërmjet rritjes së konkurrencialitetit të ekonomisë.

Ndër objektivat teknikë të saj mund të përmendim: rritjen e konkurrencialitetit të industrisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare dhe në tregun e brendshëm; sigurimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; rritjen e produkteve me vlerë të shtuar përmes prodhimit me porosi dhe diversifikimit të eksporteve; krijimin e burimeve të reja të të ardhurave përmes diversifikimit të produkteve dhe tregjeve; integrimin në ekonominë botërore nëpërmjet tregjeve rajonale të BE dhe OBT dhe; thellimin e partneritetit publik-privat si garanci për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Rrjeti i propozuar për zbatimin e strategjisë në fjalë, përbëhet nga Qendra e Nxitjes së Eksporteve (QNE), ministritë e linjës, institucionet publike dhe private dhe komuniteti i biznesit. Ndërkohë që QNE do të merret me koordinimin e punës së të gjithë aktorëve të rrjetit, të tjerët do të përqendrohen përkatësisht në: krijimin e kushteve bazë legjislative dhe administrative të orientuara nga biznesi; shërbimet e orientuara nga biznesi dhe në prodhimin dhe logjistikat e orientuara nga tregu. Investimet e huaja direkte mendohet se përbëjnë një nga burimet kryesore për zhvillimin e potencialeve ekzistuese të eksportit. Ato, gjithashtu, mundësojnë hyrjen në tregjet e huaja dhe krijimin e avantazheve konkurruese dinamike. Theksi, për funksionimin e suksesshëm të strategjisë së propozuar, vihet mbi bashkëpunimin efektiv midis të gjithë aktorëve dhe koordinimin efikas të kontributit të donatorëve.

Projekti ka kaluar në diskutim me të gjitha grupet e interesave dhe me donatorët dhe pritet të miratohet brenda vitit 2002.

II.5.2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente

Statistikat e bilancit të pagesave për vitin 2001, tregojnë se tregtia e jashtme në shërbime (kryesisht shërbimet e turizmit) evidentohet si një aktivitet me rëndësi në rritje për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, aktiviteti i turizmit ka gjeneruar të ardhura mbi 46 për qind më të larta se të ardhurat nga eksporti i mallrave, ndërkohë që shqiptarët kanë shpenzuar në

¹⁵ "Projektstrategjia e nxitjes së eksporteve", Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Dhjetor 2001.


udhëtimet e tyre jashtë shtetit, rreth 257.5 milionë dollarë amerikanë ose rreth 50 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Rrjedhimisht, në fund të vitit, bilanci pozitiv i këtyre shërbimeve vlerësohej në 188.8 milionë dollarë amerikanë. Me një aktivitet të tillë, turizmi ka dominuar të gjitha zhvillimet në tregtinë e shërbimeve, e cila u mbyll me një suficit prej 88.6 milionë dollarësh.

Ashtu siç pritej, rritja e vëllimit të importit ka shkatuar rritjen e importit të shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit. Këto kategori shërbimesh kanë dominuar mbi transaksionet e tjera të shërbimeve në kategoritë përkatëse të shërbimeve të transportit dhe atyre të sigurimit. Këto deficite vlerësohen respektivisht me rreth 19 dhe 20 për qind më të larta se viti 2000.

Kategoria “shërbimet e tjera”, ka regjistruar një suficit prej 34 milionë dollarësh ose 2.9 herë më të lartë se në vitin 2001. Kjo rritje është mundësuar kryesisht prej rritjes së të ardhurave në shërbimet e komunikacionit dhe rritjes së të ardhurave nga shërbimet qeveritare. Megjithatë, roli i tyre në zhvillimet e tregtisë së shërbimeve mbetet modest dhe pa ndonjë ndikim të dukshëm.

Bilanci pozitiv i transaksioneve të “të ardhurave” në fund të vitit vlerësohet rreth 149 milionë dollarë amerikanë ose 39.5 për qind më i lartë se një vit më parë. E gjithë kjo rritje i dedikohet të ardhurave më të larta nga puna e punëtorëve sezonal e atyre kufitarë dhe interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente.

Grafik II-14: Llogaria korente, në % ndaj PBB-së.



Dërgesat e emigrantëve për vitin 2001 vlerësohen rreth 615 milionë dollarë ose 16 për qind më të larta se në vitin 2000. Kjo rritje e fluksit të transfertave hyrëse, ka qenë mëse e mjaftueshme për të mbuluar rënien në zërat e transfertave shtetërore, të cilat këtë vit vlerësohen vetëm 40 për qind e atyre të një viti më parë. Ndryshe nga viti i kaluar, kur transfertat shtetërore dominoheshin nga transfertat në mjete valutore, këtë vit transfertat shtetërore përfaqësohen nga ato në asistencë teknike dhe ato në formë ndihmash në mallra. Në fund të vitit, bilanci pozitiv i transfertave korente u vlerësua rreth 615 milionë dollarë ose

rreth 8 për qind më i lartë se në vitin 2000. Në shtesë të rritjes së dërgesave nga emigrantët dhe të transfertave hyrëse shtetërore, rritja e suficitit në këtë kategori, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse.

Bilancet e larta pozitive të arritura në kategoritë e transfertave, të të ardhurave e në tregtinë e shërbimeve, nuk ishin të mjaftueshme për të përballuar rritjen e shpejtë të deficitit tregtar në mallra, e për rrjedhim, **llogaria korente e thelloi deficitin me 66.7 milionë dollarë**. Deficiti i llogarisë korente, në fund të vitit, vlerësohet 218.5 milionë dollarë amerikanë ose 6 për qind e PBB-së.

II.5.3. Llogaria kapitale dhe financiare

Mbulimi (financimi) i deficitit korent është mundësuar nga **flukset neto hyrëse të kapitaleve**, të cilat në fund të vitit, regjistruan rreth 236.6 milionë dollarë amerikanë. Transfertat kapitale janë rritur me rreth 38.6 për qind kundrejt vitit të kaluar dhe vlerësohen rreth 108 milionë dollarë.

Llogaria financiare është mbyllur me një bilanc pozitiv prej rreth 128.2 milionë dollarësh. Importi i kapitaleve, i realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe disbursimit të kredive nga jashtë, dhe investimet e mjeteve valutore në bankat e huaja, kanë çuar në rritjen e detyrimeve financiare me rreth 347 milionë dollarë.

Investimet e huaja direkte, që për këtë vit vlerësohen në 220 milionë dollarë amerikanë, janë fenomeni dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare. Këto flukse kapitale në vitin 2001 vlerësohen rreth 54 për qind më të larta se një vit më parë. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive nga jashtë. Këto disbursime, të cilat vlerësohen rreth 98.8 milionë dollarë amerikanë (duke kapur nivelet e një viti me parë) kanë shkuar pothuajse tërësisht në favor të sektorit “qeveria e përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore.

Pretendimet në fund të vitit janë rritur vetëm me 219 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje vlerësohet 3 herë më e lartë se ajo e vitit të kaluar dhe përfaqëson kryesisht rritjen e zotërimeve në mjete valutore të publikut. Kështu, në fund të vitit këto vlerësohen me një rritje prej 122.7 milionë dollarësh, rreth 3 herë më e lartë se rritja e vitit të kaluar. Kjo rritje ka ardhur kryesisht në tremujorin e katërt (muajin dhjetor) si pasojë e procesit të zëvendësimit monetar në Zonën e Euros, e cila solli:

- prurjen e valutave në sistemin tonë bankar në formën e njësave monetare përbërëse të euros për t’u konvertuar;

- ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në treg nëpërmjet sistemit bankar për të ruajtur nënçmimin e menjëhershëm të lekut;
- rritjen e të ardhurave nga emigrantët në formë valutash përbërëse të euros.

Depozitat e sistemit bankar, janë rritur me 55.6 milionë dollarë pas rënies me rreth 1.5 milionë dollarë gjatë vitit të kaluar.

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe përdorimi i kredive dhe huave nga FMN), transfertave korente në *cash*, dhe tërheqja e valutës në treg nga Banka e Shqipërisë, u pasqyruan në rritjen e **rezervave valutore të autoritetit monetar** me 145 milionë dollarë (rreth 13 milionë dollarë më shumë se në vitin 2000) për vitin 2001. Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore. Niveli i rezervave valutore në fund të vitit ishte i mjaftueshëm për të përballuar 6.8 muaj importe (import mallrash).

Tabelë II-15: Zërat kryesorë të bilancit të pagesave, milionë dollarë.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Llogaria korrente	31.2	36.7	-62.4	-253.7	-45.2	-132.9	-151.8	-218.5
Llogaria kapitale	21.6	389.5	4.9	2.1	31.2	67.5	78	108.4
Llogaria financiare	46	-25	54.5	140.7	45.6	36.8	221.4	128.2
Gabime dhe Harresa	-6.9	-95	-35.6	95.3	0.6	-4.4	78.4	127.0

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2002.

II.5.4. Rezerva valutore

Rezerva valutore që administrohet nga Banka e Shqipërisë ka njohur rritje të ndjeshme gjatë vitit të kaluar. Rritja është ndikuar kryesisht nga hyrjet në valutë si rezultat i programeve të financimit që Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka me organizmat ndërkombëtare (si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Bashkimi Europian), nga hyrjet e realizuara në procesin e privatizimit ku veçojmë transhin e dytë të privatizimit të AMC dhe blerjen e operatorit të dytë të telefonisë së lëvizshme nga grupi Panafon-Vodafone si edhe nga blerjet e Bankës së Shqipërisë në ndërhyrjen e kryer në tregun e brendshëm valutë, në fund të vitit.

Grafik II-15: Ecuria e rezervës valutore.



Hyrjet në rezervën valutore gjatë vitit të kaluar, kapin shumën 355.3 milionë dollarë amerikanë. Ndër hyrjet më kryesore veçojmë :

- hyrje nga privatizimi, në masën 80.8 milionë dollarë amerikanë;
- hyrje nga disbursime të huave të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në masën 60.8 milionë dollarë amerikanë;
- blerje nga bankat e nivelit të dytë në masën 41.4 milionë dollarë amerikanë;
- hyrje nga shtimi i rezervës së detyrueshme të bankave të nivelit të dytë, të vendosur pranë Bankës së Shqipërisë, në masën 19.6 milionë dollarë amerikanë.

Daljet në rezervën valutore gjatë vitit të kaluar, kapin shumën 226.1 milionë dollarë amerikanë. Ndër më kryesoret, veçojmë :

- dalje si rezultat i pagimit të borxhit të jashtëm të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës së Shqipërisë, në masën 27.4 milionë dollarë amerikanë;
- transferime të kryera nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në drejtim të bankave të nivelit të dytë, në masën 166.3 milionë dollarë amerikanë.

Efekti i kombinuar i të gjithë faktorëve ndikues ka rritur vlerën e rezervës valutore me 129.2 milionë dollarë amerikanë ose 21.3 për qind. Gjatë vitit 2000, këto shifra ishin përkatësisht 124.2 milionë dollarë amerikanë dhe 26.2 për qind. Në fund të vitit të kaluar, sipas raporteve të valutave përbërëse të rezervës në atë periudhë, vlera e rezervës valutore ishte 737.0 milionë dollarë amerikanë.

Box II-5: Konferenca “Shqipëria midis reformave të brendshme dhe integritit European”.

Dhjetë vjet pasi Shqipëria hyri në rrugën drejt transformimit të ekonomisë së saj dhe u bashkua me institucionet e Bretton Woods, qeveria e saj dhe banka qendrore sponsorizoi një konferencë për të treguar progresin e vendit dhe për të ravijëzuar sfidat që dilnin përpara. Zyrtarë të qeverisë, përfaqësues të FMN-së, të Bankës Botërore, të Koorporatës Financiare Ndërkombëtare, Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe akademikë, u mbledhën në dhjetor për të vlerësuar sukseset e arritura dhe për të diskutuar se çfarë hapash duheshin ndërmarrë për të mbajtur stabilitetin makroekonomik dhe rritjen ekonomike, si dhe për ta pozicionuar Shqipërinë drejt një integrimi eventual drejt ekonomisë europiane.

Kur Shqipëria i hyri rrugës së tranzicionit drejt ekonomisë së tregut në vitin 1991, ekonomia karakterizohej nga mungesa dhe mangësi të gjithanshme dhe një gjendje kapitali realisht tejet të amortizuar. Vendimi i saj për t'u bashkuar me FMN- në dhe Bankën Botërore, në tetor të vitit 1991, shënoi një hap historik duke sinjalizuar bashkimin e Shqipërisë me komunitetin ekonomik botëror. Kjo i dha vendit, gjithashtu, mundësinë për të përpunuar dhe për të zbatuar strategjitë e zhvillimit ekonomik për tranzicionin e saj drejt ekonomisë së tregut.

Si hap i parë, nënshkrimi i Marrëveshjes njëvjeçare Stand - By me FMN –në, në vitin 1992, e ndihmoi Shqipërinë për të lehtësuar vështirësitë që lidheshin me tranzicionin e menjëhershëm të ekonomisë. Një Marrëveshje trevjeçare Enhanced Structural Adjustment Facility (ESAF) me FMN –në vitin 1993, siguroi mbështetje financiare për një sërë hapash kyç - kryesisht krijimin e një kuadri ligjor bazë për një ekonomi tregu, përpjekjet për të privatizuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe liberalizimin e plotë të çmimeve.

Pas përmbyesjes së skemave piramidale më 1997, që vunë në rrezik gjendjen financiare të vendit, rimëkëmbja e Shqipërisë u ndihmua me një asistencë emergjence postkonfliktore nga FMN - ja. Një Marrëveshje e dytë ESAF në vitin 1998, e cila u përfundua me sukses në mes të vitit 2001, u fokusua në arritjen e stabilitetit makroekonomik, në forcimin e qëndrueshmërisë fiskale, për të ecur më tej me privatizimin e ndërmarrjeve strategjike, të vogla dhe të mesme. Ndihma financiare e FMN-së, për përpjekjet e Shqipërisë në rrugën e reformave, shërbeu gjithashtu si katalizator për ndihmën financiare të Bankës Botërore dhe të donatorëve të tjerë.

Çfarë mbetet për t'u bërë në axhendën e reformave ndërkohë që Shqipëria e ka kthyer vështrimin e saj drejt një integrimi më të madh në Europë? Fusha të ndryshme me rëndësi të veçantë duhet të ndërmerren hapa për të ruajtur progresin e arritur renditen:

Ambienti makroekonomik. Ruajtja rezultateve kërkon reforma strukturore, veçanërisht në sektorin financiar, dhe në liberalizimin e tregut; kërkon një reformë themelore në fushën e taksave si dhe shqyrtimin me imtësi të programeve ekzistuese të shpenzimeve.

Politika monetare. Në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë mendon të adoptojë regjimin “*inflation targeting*”. Kushtet për një ndryshim të tillë duken se janë përherë e më të favorshme, tha ai, nën dritën e progresit që po shënon vendi në drejtim të stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimit fiskal.

Sektori financiar. Mbetet për t’u trajtuar një veti themelore e sistemit financiar shqiptar, roli dominues i Bankës së Kursimeve, banka e fundit me kapital shtetëror. Në krye të reformave është privatizimi i Bankës së Kursimeve dhe kompanisë shtetërore të sigurimeve si dhe fuqizimi i mëtejshëm i agjencive të mbikëqyrjes në sektorin financiar.

Reformat institucionale. Ekziston një consensus mbi nevojën e ndërmarrjes së reformave të mëtejshme institucionale nëse do të ruhej gjendja e mirë makroekonomike e kohëve të fundit. Aspektet kryesore të kësaj reforme institucionale të vazhdueshme duhet të jenë lufta kundër korrupsionit, mjedisi i përmirësuar për zhvillimin e biznesit, një sistem gjyqësor më efikas, si dhe krijimi i kushteve që lejojnë konkurrencën e ndershme. Korrupsioni dhe qeverisja e dobët u përcaktuan si pengesat kryesore të zhvillimit. Sektori privat kërkon një kuadër ligjor më të besueshëm, të pavarur dhe të efektshëm. Ofrimi i shërbimeve publike vazhdonte të mbetej joefikas.

Integrimi europian. Duke ndjekur, për vite me rradhë, politika të mira makroekonomike, Shqipëria nuk është më duke e parë integrimin europian si një objektiv të paarrtshëm.

Konferenca arriti në përfundimin se Shqipëria kishte bërë vërtet një progres të madh drejt vendosjes së ekonomisë së tregut, por më shumë i mbetej për të bërë që të ruante ecurinë e mirë makroekonomike të kohëve të fundit dhe të reduktonte, në veçanti papunësinë e lartë dhe varfërinë. Duke pasur parasysh këtë, konferenca nënvizoi rëndësinë jetësore të politikave plotësuese për të ruajtur stabilitetin makroekonomik, me fokusin e duhur drejt reformave strukturore, veçanërisht në sektorin e energjitikës, në sistemin gjyqësor dhe në administratën publike. Duke i dhënë Shqipërisë një vlerësim të mirë për këto vitet e fundit, pjesëmarrësit në konferencë shprehën besimin se Shqipëria do të bënte përparim të mëtejshëm, të dukshëm drejt integrimit europian, nëse reformat do të vazhdonin me hapin e duhur.

KAPITULLI III – ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET

III.1. PROGRAMI MONETAR PËR VITIN 2001

III.1.1. Programi monetar

Programi monetar i Bankës së Shqipërisë përmbledh kahun e zhvillimeve të pritshme monetare gjatë vitit dhe politikën monetare të Bankës së Shqipërisë për realizimin e objektivit kryesor të saj, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Programi monetar i vitit 2001 u hartua duke u bazuar në parashikimin e një rritjeje reale të ekonomisë në kufijtë 7.3 për qind gjatë vitit 2001. Ashtu si dhe një vit më parë, objektivi i Bankës së Shqipërisë për nivelin e inflacionit qëndronte në nivelin 2 – 4 për qind edhe gjatë vitit 2001. Duke marrë në konsideratë këtë objektiv, Banka e Shqipërisë në programin e saj monetar, synonte kontrollin e rritjes së ofertës monetare në masën 11.3 për qind gjatë vitit. Një rritje e tillë gjykohej se do të plotësonte nevojat e ekonomisë për mjete monetare, pa shkaktuar rritje të bilanceve monetare në ekonomi përtej kërkesës reale të saj.

Vlerësimet fillestare të kërkesës së ekonomisë për mjete monetare, gjatë vitit 2001, ishin për një zhvillim të saj në të njëjtin drejtim që kishte manifestuar gjatë vitit 2000. Kjo nënkuptonte një ulje graduale të shpejtësisë së qarkullimit të parasë, megjithëse jo në të njëjtën masë me vitin 2000. Parashikimi mbështetej edhe nga ulja e parashikuar e financimit të deficitit buxhetor nga sistemi bankar, nga 20 miliardë lekë në vitin 2000 në 17.8 miliardë lekë në vitin 2001. Kreditimi i ekonomisë parashikohej të ishte në nivelin 8.1 miliardë lekë kundrejt 7.5 miliardëve të parashikuar në vitin 2000. Pozicioni valutor i sistemit bankar parashikohej të përmirësohej më tej, falë rritjes së mjeteve valutore neto të bankave tregtare si pasojë e rritjes së depozitave në valutë në sistem. Gjithashtu, edhe rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë parashikohej të kishte rritje si pasojë e të ardhurave të privatizimit dhe të ardhurave të tjera valutore, duke mbuluar mesatarisht gjatë vitit 4.5 muaj importi mallrash dhe shërbimesh.

Tremujori i parë i vitit 2001, i konfirmoi parashikimet e zhvillimeve në sektorin real të ekonomisë. Niveli i inflacionit, pas kërcimit që pati në muajin dhjetor, u vu nën kontroll. Megjithëse rritja e kredisë për ekonominë dhe financimi i deficitit buxhetor ishte më i ulët se parashikimi, ritmi i rritjes së ofertës monetare ishte përgjithësisht sipas parashikimit. Rritja e ofertës monetare u mbështet nga rritja e mjeteve valutore neto të sistemit, dhe veçanërisht e bankave tregtare si pasojë e rritjes së shpejtë të depozitave në valutë.

Tremujori i dytë dhe ai i tretë shënuan një rritje më të shpejtë të ofertës monetare se parashikimi i programit. Kjo rritje u nxit nga rritja e shpenzimeve të qeverisë në periudhën maj – korrik, që i korrespondon dhe zhvillimit të fushatës elektorale të zgjedhjeve të përgjithshme. Financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar njohu rritje në këtë periudhë. Megjithatë, vlera e ulët e tij në tremujorin e parë, bëri që ai të ishte ende nën nivelin e parashikuar. Rritja e aktivitetit të qeverisë ndikoi edhe në gjallërimin e sektorit privat. Statistikat monetare flasin për rritje të kreditimit të ekonomisë në këtë periudhë. Pas muajit dhjetor, muaji korrik ishte muaji me rritjen më të madhe të tepricës së kredisë për ekonominë gjatë vitit 2001. Gjithashtu, rritja e depozitave në valutë vazhdoi të ishte më e madhe se parashikimet, duke qenë dëshmi e besimit në rritje të popullsisë ndaj sistemit bankar. Rritja e besimit ndaj sistemit sjell depozitim dhe një pjesë në rritje të të ardhurave valutore të emigrantëve në të. E gjithë kjo solli rritjen e ofertës monetare përtej parashikimeve në muajt korrik – shtator. Rritja vjetore e ofertës monetare në muajin shtator rezultoi të ishte 16.1 për qind, duke qenë 1.7 pikë përqindjeje mbi vlerën e parashikuar nga Banka e Shqipërisë.

Gjatë muajve qershor-korrik vlera e inflacionit vjetor e kaloi objektivin e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë rritja e inflacionit përkoj me forcimin e ritmit të rritjes së ofertës monetare, niveli i lartë i çmimeve nuk u provua të ishte i qëndrueshëm, duke konfirmuar pikëpamjen e Bankës së Shqipërisë se vlera e lartë e inflacionit ishte e shkaktuar më tepër si pasojë e faktorëve që vepronin në kahun e ofertës. Për më tepër, rritja në muajin gusht e normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë ndihmoi në uljen e inflacionit në muajt vijues, megjithatë rritja e ofertës monetare vazhdoi të mbetej e lartë.

Rritja e ofertës monetare gjatë vitit 2001, përtej parashikimeve, nuk ka ndikuar në tejkalimin e objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin. Megjithatë, rritja e shpejtë e ofertës monetare ka ndikuar në ruajtjen e një niveli mesatar inflacioni më të lartë se gjatë vitit 2000. Rritja e mjeteve monetare në këtë periudhë ka patur më tepër formën e rritjes së depozitave, veçanërisht të depozitave në valutë, të cilat si përbërësi më pak likuid i ofertës monetare kanë një ndikim më të vogël në inflacion. Ndërkohë, paraja jashtë bankave kishte një ulje të peshës së saj ndaj ofertës monetare me 0.9 pikë përqindjeje, duke kaluar nga 30.2 për qind e M3 në dhjetor të vitit 2000, në 29.3 për qind në shtator të vitit 2001. Kjo ka ndihmuar në kontrollin e likuiditetit në sistem, duke mos ndikuar në rritjen e presioneve inflacioniste në ekonomi.

Duke u nisur nga ky fakt, i cili dëshmonte për rritjen e kërkesës reale të ekonomisë, Banka e Shqipërisë bëri një rishikim të programit të saj monetar për tremujorin e fundit të vitit. Në programin e rishikuar, objektivi i rritjes vjetore të ofertës monetare u rrit në 15.4 për qind nga 11.3 për qind, që ishte parashikimi fillestar. Ndryshimi në rritje i objektivit të rritjes vjetore të M3, u mbështet edhe në rritjen e pritjes së deficitit buxhetor nga sistemi bankar në tremujorin e fundit. Deri në muajin shtator qeveria ishte mbështetur më shumë në të ardhurat e privatizimit dhe në financimin e huaj për mbulimin e deficitit të saj, ndërsa

tremujori i fundit shënoi një rritje të huamarrjes nga sistemi bankar. Gjithashtu, në përputhje me tendencat e vrojtura dhe me pasojat e pritshme të prezantimit të euros fizike në tregjet valutore, u rrit si projeksioni i rritjes së depozitave në valutë ashtu dhe pesha e tyre ndaj M3. Parashikimi i rritjes së kredisë për ekonominë u ul në 6.8 miliardë lekë, duke u mbështetur në ecurinë e saj deri në atë periudhë.

Rritja e ofertës monetare gjatë vitit 2001 rezultoi 19.9 për qind, duke i kaluar edhe parashikimet e fundit të Bankës së Shqipërisë. Veçanërisht, spikatin zhvillimet e muajit dhjetor, të cilat ishin mjaft larg ecurisë së pritur të tyre dhe sjelljes historike. Të dhënat e muajit dhjetor tregojnë se konvertimi i monedhave të shportës së euros ka dhënë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e M3. Megjithëse efektet, që mund të shkaktonte prezantimi i euros fizike në Shqipëri ishin marrë në konsideratë, përmasat reale të tyre i tejkaluan parashikimet. Depozitat në valutë u rritën me 7.2 miliardë lekë ose 8.9 për qind vetëm në muajin dhjetor, krahasuar me uljen me 1 miliard lekë, që ishte parashikuar në programin monetar për këto depozita. Kjo bëri që depozitat në valutë të rriten me 38.7 për qind gjatë vitit 2001, kundrejt 26.1 për qind që ishte parashikuar në program.

Gjithashtu, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregjet valutore ndikoi në hedhjen e një sasive të madhe paraje në qarkullim në këtë muaj. Paraja jashtë bankave u rrit me 12 miliardë lekë vetëm në muajin dhjetor, kundrejt një rritjeje vjetore prej 19.8 miliardë lekësh.

Aktiviteti i kreditimit të ekonomisë i kaloi parashikimet. Kredia për sektorin privat të ekonomisë u rrit me 10.7 miliardë lekë kundrejt 6.8 miliardë lekëve të parashikuar. Vetëm në muajin dhjetor kredia për ekonominë u rrit me 3.7 miliardë lekë, duke ndikuar në tejkalimin e ndjeshëm të parashikimit.

Mjetet valutore neto të sistemit u rritën me 21.4 për qind, duke rezultuar 3.3 miliardë lekë mbi parashikimin e programit. Rritja e tyre ishte më e madhe si për mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë, edhe të bankave tregtare.

Hedhja e një sasive të madhe likuiditeti në qarkullim në muajin dhjetor ndikoi në rritjen e shpejtë të bazës monetare, megjithëse rezervat e tepërta të sistemit janë mbajtur në nivele të ulëta. Baza monetare u rrit me 18.1 për qind, duke rezultuar më e lartë se parashikimi i programit monetar, i cili ishte për një rritje prej vetëm 11.4 për qind. Megjithatë, duke qenë se transaksionet valutore të Bankës së Shqipërisë kanë rritur si nivelin e mjeteve valutore neto të saj ashtu dhe nivelin e bazës monetare, ndikimi specifik i tyre në rritjen e mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë ishte i vogël.

III.1.2. Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë

Gjatë vitit 2001, Banka e Shqipërisë ka përmbushur angazhimin e saj në kuadrin e strategjisë afatmesme të zhvillimit dhe të marrëveshjeve me institucionet ndërkombëtare, për respektimin e nivelit të tre treguesve të rëndësishëm financiarë:

- ruajtjes së kufirit të poshtëm për nivelin e rezervave ndërkombëtare neto (RNN) të Bankës së Shqipërisë;
- ruajtjes së kufirit të sipërm për rritjen e mjeteve të brendshme neto (MBN) të Bankës së Shqipërisë; dhe
- ruajtjes së kufirit të sipërm për kredinë e brendshme neto ndaj qeverisë.

Në përgjithësi, treguesit të cilët përbëjnë edhe objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë në kuadrin e marrëveshjes PRGF¹⁶, rezultojnë të përmbushur në vazhdimësi gjatë vitit, duke kontribuar kështu në stabilitetin makroekonomik dhe financiar të vendit dhe duke forcuar bazat e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Niveli dhe realizimi i tyre sipas tremujorëve jepen në tabelën e mëposhtme. Përrjashtim nga realizimi i objektivit përbën niveli i mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë për muajin qershor dhe muajin dhjetor.

Tabelë III-1: Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor
Rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë				
Objektivi	456.9	485.4	480.7	484.6
Vlera reale	475.2	498.2	499.1	532.3
Diferenca	18.3	12.8	18.3	47.7
Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë				
Objektivi	63.7	59.7	62.7	71.5
Vlera reale	57.5	64.0	61.6	73.1
Diferenca	-6.2	4.3	-1.1	1.6
Kredia e brendshme neto për qeverinë				
Objektivi	226.6	229.9	222.1	231.1
Vlera reale	219.1	212.3	214.3	229.5
Diferenca	-7.5	-17.6	-7.8	-1.6

¹⁶ *Poverty Reduction and Growth Facility* është një strategji afatmesme për Reduktimin e Varfërisë dhe Nxitjen e Rritjes Ekonomike. Megjithëse marrëveshja përfundoi në muajin mars, Banka e Shqipërisë ndoqi në vazhdimësi respektimin e këtyre objektivave gjatë vitit 2001, në bazë të kuadrit të përgjithshëm të strategjisë së zhvillimit të vendit. Marrëveshja pasuese, termat e së cilës janë përcaktuar në vija të përgjithshme, pritet të nënshkruhet së shpejti.

III.1.2.1. Rezerva Ndërkombëtare Neto e Bankës së Shqipërisë

Banka e Shqipërisë, për të garantuar ruajtjen e një pozicioni të arsyeshëm valutë, përcakton një objektiv për rezervën ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë në formën e kufirit të poshtëm. Niveli i saj përkon me zhvillimet e pritshme në bilancin e pagesave gjatë vitit dhe shërben si një garanci për plotësimin e nevojave valutore të vendit. Me qëllim që të kemi një bazë të qëndrueshme për të vlerësuar punën e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, rezerva ndërkombëtare neto matet me një kurs fiks, aktualisht të fiksuar në vlerat e qershorit 2000.

Niveli i rezervave valutore neto, gjatë vitit 2001, ka qenë mbi kufirin e vendosur për to. Rritja mbi baza vjetore e këtyre rezervave është e ndjeshme, rreth 145 milionë usd. Në dhjetor, niveli i rezervës arriti në 532.4 milionë usd, ndërsa rezervat valutore bruto ishin 737 milionë usd duke mbuluar 4.7 muaj importe.

Rritja e rezervës valutore ka ardhur kryesisht si pasojë e të ardhurave të privatizimit, afërsisht në masën 80 milionë usd, dhe e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në blerjen e valutës gjatë muajit dhjetor. Banka e Shqipërisë zbaton një regjim luhatës të lirë të kursit të këmbimit dhe është e pranishme në tregun valutë për të zbutur efektet e veprimeve spekulative apo ndryshimeve të konsiderueshme, në funksion të përmbushjes së objektivave të saj. Kështu, mbiçmimi i lekut në muajin dhjetor e bëri të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në këtë muaj. Kjo ndërhyrje solli rritjen e shpejtë të rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë në muajin dhjetor. Megjithëse partneri i Bankës së Shqipërisë në këto transaksione kanë qenë bankat tregtare, rezervat valutore të tyre nuk janë ndikuar. Bankat tregtare kanë vepruar si ndërmjetës duke tërhequr valutën nga tregu valutë.

III.1.2.2. Mjetet e Brendshme Neto të Bankës së Shqipërisë

Niveli i mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë është një matës i likuiditetit të gjeneruar në sistem nga Banka e Shqipërisë. Duke qenë se hedhja e një likuiditeti të madh në treg është premisë për rritjen e inflacionit, Banka e Shqipërisë vendos një objektiv në formën e kufirit të sipërm për rritjen e këtyre mjeteve. Ekzistenca e këtij kufizimi lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, përderisa qëllimi kryesor i tij është kontrolli i krijimit të likuiditeteve të tepërta në sistemin bankar.

Niveli i mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë, ka qenë brenda objektivit, me përjashtim të dy momenteve, në muajt qershor dhe dhjetor. Shkelja e nivelit të mjeteve të brendshme neto të Bankës së Shqipërisë, në muajin qershor, erdhi si pasojë e rritjes së parasë në qarkullim në këtë muaj dhe e zhvendosjes së fondeve të tepërta të bankave tregtare nga repo në depozita njëditore. Vetë rritja e parasë në qarkullim u diktua nga rritja e shpenzimeve të qeverisë në këtë periudhë. Niveli i rezervave të tepërta të bankave tregtare erdhi

në ulje pas muajit qershor. Përmirësimi i punës së bankave në parashikimin dhe administrimin e likuiditetit, e minimizoi këtë problem. Edhe në fund të vitit 2001, mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë ishin 73.1 miliardë lekë, 1.6 miliardë lekë më shumë se objektivi. Rritja e parasë jashtë bankave në këtë muaj, e cila këtë vit mori përmasa më të mëdha si pasojë e zhvendosjes së një pjese të kursimeve të qytetarëve nga monedhat e shportës së euros në lekë, ndikoi në rritjen me 10.7 miliardë lekë të mjeteve të brendshme neto duke shkaktuar këtë tejkalim. Gjithashtu, efekti i euros dhe rritja e kërkesës së qeverisë për financim në muajin dhjetor, ndikuan në rritjen e rezervave të tepërta të sistemit bankar në këtë muaj. Bankat, të ndodhura para pasigurisë së procesit të konvertimit të monedhave të shportës së euros në valuta të tjera, mbajtën një sasi të madhe rezervash të lira duke mos preferuar investimin e tyre në repo me Bankën e Shqipërisë.

Rezervat e tepërta të sistemit bankar, gjatë pjesës së parë të vitit, kanë qenë në nivele të larta dhe janë ulur mjaft gjatë pjesës së dytë të tij. Në mbështetje të politikës së saj për të mbajtur një sasi optimale¹⁷ të likuiditetit në sistem, Banka e Shqipërisë ka tërhequr një pjesë të këtij likuiditeti me anë të dy operacioneve të shitjes së bonove të thesarit me të drejta të plota. Edhe ndryshimi i formës së ankandit të marrëveshjeve të riblerjes, në ankand me shumë të pakufizuar, ka ndikuar në uljen e nivelit të rezervave të tepërta të sistemit.

Financimi i deficitit buxhetor, nga ana e Bankës së Shqipërisë, ka qenë më i ulët se parashikimi. Megjithatë, edhe gjatë vitit 2001, shpërndarja e këtij financimi në mënyrë të njëtrajtshme në harkun kohor të një viti mbeti përsëri problem dhe rritja e tij në muajin dhjetor është një faktor tjetër, që ndikoi në shkeljen e objektivit për fundin e vitit.

III.1.2.3. Kredia Neto e Sistemit Bankar për Qeverinë

Kredia neto e sistemit bankar për qeverinë shpreh pretendimet e sistemit bankar ndaj qeverisë. Objektivi për to, në formën e kufirit të sipërm, vendoset në përputhje me projektbuxhetin e qeverisë për vitin në fjalë. Megjithë shpërndarjen jo të njëtrajtshme të shpenzimeve të qeverisë dhe të financimit të brendshëm të deficitit buxhetor gjatë vitit, objektivi është realizuar.

Në fund të vitit 2000, gjendja e pretendimeve neto të sistemit bankar ndaj qeverisë rezultoi poshtë kufirit të sipërm të vendosur për të, për rreth 1.6 miliardë lekë.

Financimi i deficitit buxhetor nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit në tregun primar ishte 14.3 miliardë lekë. Pjesa tjetër e tij u mbulua nga të ardhurat e privatizimit dhe nga financimi i huaj i deficitit.

¹⁷ Banka e Shqipërisë bashkë me Ministrinë e Financave kanë ngritur Nënkomitetin e Administrimit të Huave të Brendshme, një funksion i të cilit është parashikimi i nivelit të rezervave të tepërta të sistemit dhe planifikimi i masave për optimizimin e tij.

III.1.3. Programi Monetar i Bankës së Shqipërisë për vitin 2002

Programi monetar për vitin 2002 mbështetet në parashikimin e vazhimit të një ritmi të kënaqshëm të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit të ardhshëm. Rritja reale ekonomike parashikohet të jetë në nivelin 7.0 për qind gjatë vitit 2002.

Tabelë III-2: Treguesit kryesorë makroekonomikë.

	1998	1999	2000	2001 ¹⁸	2002
Treguesit e ekonomisë reale (në pikë përqindjeje)					
Rritja PBB	8	7.3	7.8	7.3	7.0
IÇK vjetor (mesatar)	20.9	0.4	0	3.1	3.0
Treguesit fiskalë (në përqindje ndaj PBB)					
Deficiti fiskal	10.4	11.4	9.1	9.0	8.5
Borxhi i brendshëm publik	32.4	35.1	41.9	41.1	39.8
Sektori i jashtëm (në milionë usd)					
Deficiti tregtar	-621	-663	-814	-947	-1039
Rezerva valutore bruto	384	485	608	737	799
Treguesit monetarë (në pikë përqindjeje)					
Rritja M3	20.7	22.3	12	19.9	13.7
Normat e interesit të bonove të thesarit	20.7	22.3	7.8	7.8	...

Deficiti i llogarisë korente, gjatë vitit 2002, pritet të arrijë në 8.2 për qind të PBB-së, duke u thelluar disi kundrejt vitit aktual, kur ai vlerësohet të jetë 7.4 për qind. Megjithatë, dërgesat e emigrantëve, të cilat për vitin 2002 janë parashikuar në nivelin 504 milionë usd, afërsisht sa 10.7 për qind e PBB-së, dhe të ardhurat e privatizimit pritet të jenë burimi kryesor në mbulimin e deficitit tregtar të vendit, duke mos përbërë rrezik për pozicionin e jashtëm valutor të Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbajë në fokusin e saj nivelin e çmimeve në ekonomi. Ajo do të ndjekë respektimin e kufijve të rritjes së objektivave sasiorë monetarë, të përcaktuar në marrëveshje me institucionet financiare ndërkombëtare, në prani të një regjimi të kursit të lirë këmbimi. Objektivi i Bankës së Shqipërisë për inflacionin, edhe gjatë vitit 2002, do të jetë kufizimi i rritjes vjetore të çmimeve të konsumit në ekonomi, në intervalin 2 – 4 për qind. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të orientojë politikën e saj monetare drejt përmbytjes së këtij objekti.

Financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar parashikohet të jetë më i ulët se gjatë vitit 2001, si në vlerë absolute dhe në përqindje ndaj PBB-së. Kjo reflekton përmirësimin e përgjithshëm të treguesve fiskalë gjatë vitit 2002, sipas buxhetit të miratuar në Kuvend, megjithë pasigurinë e financimit të deficitit nga të ardhurat e

¹⁸ Të dhënat janë projeksione për fundin e vitit.

privatizimit. Deficiti buxhetor, është parashikuar të arrijë në 8.5 për qind të PBB-së, nga 9.0 për qind që ishte në vitin 2001. Ai do të mbulohet në masën 4.2 për qind të PBB-së nga financimi i huaj dhe afërsisht në të njëjtën masë nga burimet e brendshme të financimit dhe të ardhurat e privatizimit. Deficiti buxhetor i mbuluar nga huamarrja e brendshme, gjatë vitit 2002, është parashikuar të jetë 16.1 miliardë lekë. Duke patur parasysh zgjerimin e tregut të bonove të thesarit dhe pjesëmarrjen në rritje të individëve në të, financimi i sistemit bankar është parashikuar në masën 14.7 miliardë lekë ose afërsisht 90 për qind e financimit të ri. Kredia e sistemit bankar për qeverinë, gjatë vitit të ardhshëm, pritet të jetë 14.7 miliardë lekë.

Sipas programit monetar të miratuar, Banka e Shqipërisë nuk do të financojë deficitin buxhetor gjatë vitit 2002, duke u lënë hapësirë bankave tregtare në investimin e fondeve të tyre në kredi për qeverinë.


Kredia për ekonominë është parashikuar të rritet me 8.8 miliardë lekë gjatë vitit të ardhshëm. Tendenca e kreditimit të ekonomisë në valutë do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2002. Në përputhje me strukturën që ka shfaqur dhënia e kredisë së re gjatë vitit 2001, është parashikuar që nga rritja totale 8.8 miliardë lekë e teprcës së kredive, vetëm 2.2 miliardë lekë, ose 25 për qind, të jetë rritja e teprcës së kredive në lekë. E gjithë kjo shtesë e kredisë për ekonominë do të shkojë për sektorin privat të saj, ndërsa kredia për ndërmarrjet e sektorit shtetëror nuk parashikohet të ketë rritje gjatë vitit të ardhshëm.

III.2. ZHVILLIMET NË OFERTËN E PARASË

Gjatë vitit 2001 ritmet e rritjes së ofertës monetare dhe të përbërësve të saj, parasë jashtë bankave, depozitave në lekë dhe depozitave në valutë, ishin më të larta krahasuar me vitin 2000 duke tejkaluar dhe parashikimet e Bankës së Shqipërisë. Rritja vjetore e ofertës monetare arriti në vlerën 19.9 për qind, kundrejt 12.0 për qind të shënuar në vitin 2000.

Rritja e ofertës monetare u shoqërua me uljen e vazhdueshme të shpejtësisë së qarkullimit të parasë gjatë vitit 2001. Ulja më e madhe në shpejtësinë e parasë u vërejt në dy muajt e fundit të vitit.

Grafik III-1: Shpejtësia e qarkullimit të parasë gjatë tre viteve të fundit.




Zhvillimet monetare gjatë vitit 2001 nuk ndoqën të njëjtën rrjedhë me atë të vitit 2000. Megjithëse tendenca e rritjes së peshës së depozitave në valutë brenda ofertës monetare dhe rritja e mbështetjes së ekonomisë me kredi vazhduan edhe gjatë vitit 2001, intensiteti i tyre u përforcua krahasuar me vitin 2000. Viti 2001 solli një zhvendosje të ofertës monetare drejt aktiveve më pak likuide, depozitave pa afat në lekë dhe depozitave në valutë, duke sjellë zvogëlimin e peshës së agregatit M1, nga 38 për qind në fund të vitit 2000, në 36 për qind në fund të 2001. Kjo tendencë nuk u ndryshua as nga rritja e shpejtë e parasë jashtë bankave, në muajin dhjetor.

III.2.1. Oferta monetare dhe inflacioni

Ritja e ofertës monetare është objektivi i ndërmjetëm i Bankës së Shqipërisë, i përcaktuar në bazë të parashikimit të rritjes ekonomike dhe të objektivit për inflacionin. Në vija të përgjithshme, këta dy tregues kufizojnë kërkesën e ekonomisë për mjete monetare. Rritja më e lartë e mjeteve monetare se kërkesa e ekonomisë për to, shoqërohet me nivele inflacioni më të larta se objektivi.


Rritja e ofertës monetare, gjatë vitit 2001, e ka tejkaluar parashikimin e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, objektivi i inflacionit është respektuar edhe gjatë vitit 2002.

Grafik III-2: Normat vjetore të rritjes së ofertës monetare dhe të inflacionit (në përqindje).



Grafiku i mëposhtëm ilustron lidhjen midis normës mujore të rritjes së ofertës monetare dhe vlerës së inflacionit mujor. Grafiku tregon se rritja mujore e ofertës monetare dhe vlera e inflacionit mujor, gjatë nëntë muajve të parë të vitit, kanë ecur në drejtime të kundërta, ndërsa më pas kanë një korrelacion të fortë.

Grafik III-3: Inflacioni mujor dhe norma mujore e rritjes së M3 (në përqindje).




Banka e Shqipërisë e ka theksuar në vazhdimësi se presionet inflacioniste në këtë periudhë kanë vepruar kryesisht në anën e ofertës. Edhe studimet empirike nuk kanë gjetur lidhje të fortë midis rritjes së ofertës monetare dhe inflacionit në këtë periudhë. Fundi i vitit, dhe veçanërisht muaji dhjetor, paraqet një ecuri tjetër. Inflacioni i lartë mujor përkon me rritje të ndjeshme të ofertës monetare, rritje e cila ka ushqyer pa dyshim inflacionin në këtë muaj. Rritja e madhe e masës monetare në dhjetor, përveç të tjerash, është ndikuar dhe nga efekti i euros, i shoqëruar me rritjen e depozitave në valutë dhe me ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në blerjen e valutës. Megjithatë, rritja e likuiditetit ka ndikuar në përforcimin e efekteve spekulative në rritjen e çmimeve në dhjetor.

III.2.2.Paraja jashtë bankave

Norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave, në fund të vitit 2001 arriti në 20 për qind. Paraja jashtë bankave është rritur afërsisht në masë të njëjtë me atë të vitit 2000, por rritja e saj është përqendruar në muajt qershor-korrik dhe në muajin dhjetor.

Rritja e parasë jashtë bankave, në periudhën qershor-korrik, erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve të qeverisë në këtë periudhë. Në muajt në vazhdim, ritmi i rritjes vjetore të parasë jashtë bankave u normalizua duke iu afruar vlerave të pesë muajve të parë. Pësia e saj në ofertën monetare deri në nëntor ishte, gjithashtu, në ulje. Rritja, përtej parashikimit, e këtij treguesi në fund të vitit, përveç ndikimit sezonal, u ndikua edhe nga ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregjet valutore. Në dhjetor, ky tregues u rrit me 12 miliardë lekë ose sa 61 për qind e rritjes së tij për tërë vitin. Kërcime të tilla në nivelin e këtij treguesi, pa dyshim që u shoqëruan me presione inflacioniste.

Grafiku III-4: Ecuria e normave vjetore të përbërësve monetarë.




III.2.3. Depozitat në lekë

Gjatë vitit 2001, depozitat në lekë kanë qenë përbërësi me ritmin më të ulët të rritjes ndër përbërësit e ofertës monetare. Në terma vjetorë ato u rritën me 12.7 për qind dhe pesha e këtyre depozitave në M3 zbriti nga 50.4 për qind në 47.3 për qind. Burimi kryesor i kësaj rritjeje është rritja e depozitave me afat, ndërkohë që depozitat pa afat në lekë kanë ndikuar negativisht.

Pranimet e reja të depozitave në lekë, gjatë këtij viti, janë shoqëruar me një tendencë të lehtë rënëse në normat mesatare të ponderuara të interesit për to. Megjithëse Banka e Shqipërisë rriti normën e interesit të repove, reagimi i sistemit bankar ndaj kësaj lëvizjeje nuk ishte në nivelet që priteshin. Bankat private reagueshan në të njëjtin kah, por magnituda e reagimit të tyre ishte më e vogël. Ndërkohë, Banka e Kursimeve, e cila ka edhe peshën më të madhe të depozitave në lekë, nuk i ndryshoi normat e interesit për këto depozita duke u përballur me probleme të vazhdueshme në gjetjen e alternativave për investimin e fondeve.

Grafik III-5: Normat e interesit të pranimeve të depozitave në lekë (në pikë përqindjeje).



Ulja e normave të interesit për depozitat në lekë, së bashku me rritjen e normës mesatare të inflacionit, ka sjellë reduktimin e kthimit real të tyre, duke ndikuar në uljen e preferencës së publikut për të mbajtur kursimet e tyre në formën e depozitave. Nga ana tjetër, stabilizimi i normave të interesit pas muajit gusht, ka bërë që ritmi i rritjes së depozitave në lekë, në këtë periudhë, të jetë më i lartë krahasuar me pjesën e parë të vitit.

Rritja e depozitave në lekë ka qenë tërësisht pasojë e rritjes së depozitave të kursimit të qytetarëve, në një kohë që depozitat pa afat kanë qenë në rënie gjatë vitit 2001. Ulja e këtyre depozitave ka ardhur si pasojë e rënies së depozitave pa afat të sektorit privat. Rritja e njëkohshme e depozitave pa afat në valutë të këtij sektori, tregon për një preferencë të këtij të fundit në mbajtjen e mjeteve të xhiros në valutë.

III.2.4. Depozitat në valutë

Norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë ishte 38.7 për qind duke shënuar normën më të lartë të rritjes gjatë tre vjetëve të fundit. Ato përbëjnë edhe zërin me ritmin më të lartë të rritjes nga përbërësit e agregatit M3.


Prezantimi i monedhës së përbashkët europiane dhe hyrja fizike e saj në tregun shqiptar, në fillim të vitit 2002, nxiti futjen e monedhave të shportës së euros në sistemin bankar në formë depozitash, për konvertimin e tyre pa komision. Ky fenomen u intensifikua në muajin dhjetor, gjatë të cilit, depozitat në valutë u rritën me 7.2 miliardë lekë ose me 8.9 për qind. Po të kemi parasysh mbiçmimin e monedhës vendase gjatë këtij muaji, rritja mujore e depozitave në valutë do të ishte 10.7 për qind. Këto zhvillime bënë që pesha e depozitave në valutë ndaj M3 të rritet në 22.4 nga 19.4 për qind që ishte në fund të vitit të kaluar.

Në ndryshim nga depozitat në lekë, rritja e depozitave në valutë ka ardhur si rezultat i rritjes së të dyja llojeve të depozitave, me afat dhe pa afat. Zhvillimet ndërkombëtare dhe ulja e interesit për këto depozita në tregun bankar nuk kanë ndikuar zgjedhjen e publikut për vendosjen e depozitave në valutë.


Box III-1: Vrojtim mbi aktivitetin depozitues.

Sipas vrotimit më të fundit të Bankës së Shqipërisë mbi depozitat dhe aktivitetin kreditues, bankat e konsiderojnë vitin 2001 si një vit të kënaqshëm përse i përket aktivitetit depozitues. Në përgjithësi, të gjitha bankat kanë arritur nivele të larta të realizimit të objektivave për pranimin e depozitave. Rritja e numrit të bankave të nivelit të dytë e ka bërë më të vështirë realizimin e këtyre objektivave dhe kjo duket qartë në faktin se nivelet më të larta të realizimit të tyre (mbi 100 për qind) vihen re në zonat ku mungon konkurrenca bankare. Ndër faktorët kryesorë konkurrencialë për tërheqjen e depozitave bankat renditin besueshmërinë ndaj bankës dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Specialistët e bankave shprehen optimistë për të ardhmen e depozitave. Ata presin një rritje të nivelit të depozitave në lekë, më të madhe sesa niveli i depozitave në valutë.



Grafik III-6: Pritjet për ecurinë e depozitave.



Grafik III-7 Pritjet për ecurinë e interesit të depozitave.


Kjo rritje e depozitave nuk pritet të shoqërohet me ndryshime të interesave si në lekë, ashtu dhe në valutë, sepse i mendojnë nivelet e arritura, si nivele interesash ekuilibër dhe nivelet e inflacionit si të pranueshme. Një ndryshim i mundshëm në normat e interesit për depozitat do të ishte pasojë e politikës së Bankës së Shqipërisë që do të realizohej nëpërmjet ankandit të repove ose të tërheqjes së depozitave nga bankat e tyre.

III.3. KËRKESA PËR PARA

III.3.1. Zhvillimet në mjetet valutore neto

Mjetet valutore neto të sistemit bankar janë rritur me 27.9 miliardë lekë gjatë vitit 2001, duke përbërë 37 për qind të totalit të kërkesës për para nga 35 për qind që zinte në fund të vitit 2000. Rritja e mjeteve valutore neto të sistemit ishte 21 për qind duke qenë më e madhe se norma e rritjes së ofertës monetare 19.9 për qind, si një tregues i mëtejshëm i dollarizimit të ekonomisë shqiptare. Kjo pasqyrohet edhe në rritjen e peshës së depozitave në valutë brenda ofertës monetare dhe në vazhdimin e tendencës së dhënies së pjesës më të madhe të kredisë në valutë.

Grafiku III-8. Ritmi vjetor i rritjes së mjeteve valutore neto (në përqindje).




Rritja e mjeteve valutore neto ka qenë e pranishme si për bankat tregtare dhe për autoritetin monetar. Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë u rritën me 14.1 miliardë lekë ose 20 për qind nërsa mjetet valutore neto të bankave tregtare me 13.8 miliardë lekë, ose me 23 për qind.

Rritja në mjetet valutore neto të Bankes së Shqipërisë, ka qenë më e shpejtë në pjesën e parë të vitit, si pasojë e përfitimit të të ardhurave nga privatizimi si dhe të huave që ka marrë qeveria ndaj institucioneve ndërkombëtare. Muaji dhjetor, si pasojë e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, solli një rritje të konsiderueshme të rezervës valutore. Megjithë mbiçmimin e kursit të lekut në këtë muaj, mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë u rritën me 3.8 miliardë lekë ose 4.6 për qind vetëm në këtë muaj.

Rritja e mjeteve valutore të bankave të nivelit të dytë, edhe gjatë vitit 2001, ka ndjekur ritmin e rritjes së depozitave në valutë. Megjithë faktin se sistemi bankar shqiptar jep kryesisht kredi në valutë, bankat nuk arrijnë të gjejnë alternativa të plota për investimin e fondeve të tyre valutore. Për këtë arsye ato ridepozitojnë një pjesë të madhe të depozitave të kursimit të qytetarëve jashtë vendit. Kjo nga njëra anë sjell rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit, nga ana tjetër ndikon në ruajtjen e normave më të ulëta të interesit për depozitat në valutë se në tregun valutor ndërkombëtar.

Rritja më e madhe e depozitave në valutë gjatë gjashtëmujorit të dytë, ka bërë që edhe mjetet valutore neto të bankave tregtare të rriten më shpejt në këtë gjashtëmujor.

Grafik III-9: Rritja e mjeteve valutore neto të sistemit bankar gjatë vitit 2001.



Rritja e mjeteve valutore neto është shoqëruar dhe me mbiçmim me 4.3 për qind të monedhës vendase ndaj dollarit amerikan përgjatë vitit 2001. Si rezultat, rritja reale e mjeteve valutore neto ka qenë më e lartë se sa tregon rritja e tyre e matur në lekë.

Tabela III-3: Ndryshimi në përqindje i mjeteve valutore neto ndaj vitit 2000

	Në dollarë amerikanë	Në lekë
AUTORITETI MONETAR	25	20
Bankat paradepozituese	47	21
Sistemi bankar	35	21


III.3.2.Kredia brendshme

Kredia e brendshme përfaqëson pjesën e financimit të brendshëm të deficitit buxhetor nga sistemi bankar¹⁹, si dhe mbështetjen e ekonomisë me kredi nga bankat e nivelit të dytë.

Kredia e brendshme, në fund të vitit 2001, arriti 276 miliardë lekë, duke u rritur 10.2 për qind, krahasuar me një vit më parë. Në këtë rritje, 58 për qind e përbën kredia për qeverinë. Ndryshe nga vitet e kaluara, gjatë vitit 2001, si rezultat i një politike të ekuilibruar fiskale të pasuar me ulje të kërkesës për financimin e deficitit buxhetor, u krijuan më shumë hapësira për rritjen e kreditimit të ekonomisë. Kështu, struktura e kredisë së brendshme, gjatë vitit 2001, ka pësuar ndryshime. Është rritur pesha specifike e kredisë për ekonominë në kredinë e brendshme dhe ka rënie të pjesës që kredia për qeverinë zë në kredinë e brendshme, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 2001.

¹⁹ Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë

Grafik III-10: Struktura e kredisë së brendshme.



III.3.2.1 Kredia për qeverinë

Niveli i ulët i deficitit buxhetor gjatë këtij viti u shoqërua me uljen e financimit të tij nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat e nivelit të dytë, duke i dhënë më shumë mundësi kreditimit të sektorit privat nëpërmjet sistemit bankar.

Por, në kërkesën për para, përsëri, një vend të konsiderueshëm vazhdojnë të kenë zhvillimet në zërin "*pretendimet ndaj qeverisë*". Duke i ndarë pretendimet ndaj qeverisë në kredi të dhënë nga Banka e Shqipërisë dhe në kredi të dhënë nga pjesa tjetër e sistemit bankar, si zhvillime kryesore gjatë vitit 2001 do të veçonim:

1. financimi i pjesës së deficitit buxhetor nga Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2001, krahasuar me një vit më parë, është ulur me 4.9 miliardë lekë. Kjo rënie ka ndodhur pasi Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2001, i pakësoi pretendimet e saj ndaj qeverisë duke thithur likuiditetet e tepërta nga sistemi bankar në formën e marrëveshjeve të riblerjes dhe me anë të shitjes së bonove të thesarit nga portofoli i saj. Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2001, ka qenë e tërhequr në financimin e deficitit buxhetor të qeverisë. Ky fakt duket qartë dhe në realizimin e këtij treguesi sipas programit monetar për vitin 2001 në masën 34 për qind;
2. borxhi publik është blerë më shumë nga bankat e nivelit të dytë. Pretendimet neto ndaj qeverisë të bankave tregtare, në fund të vitit 2001, arritën 169 miliardë lekë, duke u rritur me 19.9 miliardë lekë krahasuar me një vit më parë. Rritja më e madhe e financimit të deficitit buxhetor nga bankat tregtare ka ndodhur në gjashtëmuorin e dytë të vitit.

III.3.2.2 Kredia për ekonominë

Për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë shqiptare një kontribut të rëndësishëm do të luante një sistem bankar efektiv dhe i aftë për rritjen dhe për shpërndarjen e fondeve në sektorin privat mbi bazën e forcave të tregut. Bankat, aktualisht, janë të afta të rrisin fondet në masën e kërkuar, të shpërndajnë fonde për biznese të suksesshme dhe premtuese duke nxitur klientët e tyre për të futur planifikimin dhe disiplinën financiare dhe duke zvogëluar rrezikun e tyre, në përgjithësi. Tashmë, nuk mund të ekzistojë mendimi se sistemi bankar nuk po i kryen këto funksione dhe nuk mund të pretendohet më, që huamarrësit e vegjël dhe bizneset e reja nuk lejohen të marrin fonde nga sistemi bankar. Kreditimi, gjatë vitit 2001, është i kanalizuar tërësisht nga bankat private.

Duhet theksuar se sistemi bankar, gjatë vitit 2001, pati përmirësime të dukshme përsa i përket plotësisht të nevojave dhe të mundësive të kredimarrësve. Por, ka vend për të shtuar se, edhe pse ambienti institucional i kredidhënies dhe i kredimarrjes ka shënuar rezultate dhe nuk është i njëjlojtë si sot e tetë vjet më parë, përsëri bankat janë më të prirura të përdorin mekanizmin e bonove të thesarit, një investim komod për to, si dhe investimin tjetër, vendosjen e depozitave në bankat e huaja.

Zgjerimi i kredisë së brendshme (si pjesë e kërkesës për para) ndikon në rritjen e ofertës së parasë ose të agregatit monetar M3. Për vitin 2001, në ndryshim nga vitet e tjera, në kërkesën për para pjesa që zë krediti për ekonominë ka ardhur duke u rritur, kurse kredia për qeverinë ka patur tendencë në rënie. Ky tregues përbën një kthesë të aktivitetit të bankave në drejtim të investimit të burimeve të tyre për kreditimin e ekonomisë. Në fund të vitit 2001, kredia për ekonominë përbën 9.3 për qind të kërkesës për para.

Tabelë III-4: Shpërndarja e fondeve të sistemit bankar (në përqindje ndaj M3).

	Viti 1998	Viti 1999	Viti 2000	Mars 2001	Qershor 2001	Shtator 2001	Dhjetor 2001
Kredi brendshme	90.8	80.3	76.3	74.1	71.4	70.5	70.1
Kredi për qeverinë	82.9	73.5	68.4	66.3	63.2	61.9	60.8
Kredi për ekonominë	7.9	6.8	7.9	7.8	8.2	8.6	9.3

Gjatë vitit 2001 për çdo 10 lekë depozita është akorduar 1.33 lekë kredi. Kuptohet që ky raport është ende larg me raportet në sistemet bankare të vendeve të zhvilluara.²⁰

²⁰ Për vitin 2000, në disa vende të rajonit, raporti kredi/depozita ishte: Rumania -87.2 për qind, Bullgaria - 87.1 për qind, Sllovenia - 71.7 për qind, Kroacia - 52 për qind.


Kreditimi i ekonomisë u shoqërua me këto karakteristika dominuese:

- kredia afatshkurtër përbën pjesën më të madhe të tepricës së kredisë, 53 për qind;
- ritmi i rritjes së tepricës së kredisë në valutë (52.6 për qind) është shumë më i lartë se ai i tepricës së kredisë në lekë (24.3 për qind);
- mbizotëron kreditimi i sektorit privat, 95 për qind.

Teprica e kredisë, në fund të dhjetorit të vitit 2001, arriti në 36.6 miliardë lekë, duke u rritur 10.7 miliardë lekë kundrejt vitit 2000. Ky ndryshim ishte efekt i rritjes së kredisë së re, niveli i të cilës arriti 40.6 miliardë lekë dhe i shlyerjeve në masën 29.9 miliardë lekë.

Duhet veçuar se procesi i kreditimit ka një ritmikë mujore jo të njëtrajtshme. Kështu, kredia në dy muajt e parë të vitit ka qenë në rënie. Pas kësaj periudhe, kreditimi ka ardhur në rritje, duke arritur nivelin më të lartë të kreditimit mujor, në muajin dhjetor, me 3,7 miliardë lekë (kur kreditimi, po në këtë muaj, në vitet 1998 dhe 1999 ka qenë 0.4 miliardë lekë dhe në vitin 2000 teprica e kredisë është ulur me 0.2 miliardë lekë). Akoma nuk mund të vlerësojmë se është krijuar një tendencë historike e ritmikës mujore apo tremujore, e cila shoqëron aktivitetin kreditues të sistemit bankar. Kjo mund të shpjegohet me ekzistencën e një tregu të ngushtë huamarrës, i cili përforcon ndikimin e rasteve të veçanta, të dhënies së kredisë në shuma të mëdha, në ecurinë e treguesve të këtij tregu.

Grafik III-11: Ritmi i rritjes vjetore të tepricës së kredisë dhe teprica e kredisë ndaj PBB -së.



Gjatë vitit 2001 do të veçonim:

1. Banka e Kursimeve, në muajin shtator 2001 kaloi pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive rreth 85 për qind të tepricës të kredisë. Kjo u shoqërua me reduktim të tepricës së kredisë me 6.1 miliardë lekë²¹.
2. Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka e Parë e Investimeve lëvruan kreditë e para (përkatësisht në muajin gusht dhe nëntor).
3. Kredia e re e akorduar arriti për herë të parë, gjatë tre viteve të fundit, nivelin dyshifror brenda një tremujori. Muaji dhjetor shënoi shifrën më të lartë të lëvrimin të kredive të reja, 8.2 miliardë lekë.
4. Kredia e re e akorduar vetëm nga Banka Alfa është 14.8 miliardë lekë ose përbën 36 për qind të kredisë së re të akorduar gjatë vitit 2001.
5. Tregu shqiptar i kredidhënies vazhdon të mbetet i fragmentarizuar dhe, konkurrenca në të, e kufizuar. Ky treg reflekton dobësitë strukturore të vetë ekonomisë shqiptare. Mjafton të theksojmë faktin se 60 për qind e kredisë së akorduar gjatë vitit 2001 i takon vetëm dy bankave (Banka Alfa dhe Banka Tirana) duke treguar kështu një polarizim në tregun e huadhënies.


Tabelë III-5: Ecuria e treguesve të kreditit (në %).

Treguesit	Viti 1999	Viti 2000	Viti 2001	Teprica e kredisë gjatë vitit 2001			
				Trem. I	Trem. II	Trem. III	Trem. IV
Kredi afatshkurtër	44.5	40	53	39	42	46	53
Kredi afatmesme	27.5	31	25	32	31	29	25
Kredi afatgjatë	28	29	22	29	27	25	22
Sektori shtetëror	9	6	5	10	9	5	5
Sektori privat	91	94	95	90	91	95	95
Lekë	54	40	35	42	41	36	35
Valutë	46	60	65	58	59	64	65
Teprica e kredisë (në mld lekë)	19.9	25.9	36.6	26.5	28.6	31.2	36.6


Sistemi bankar ka akorduar më shumë kredi në terma afatshkurtër. Kjo kredi preferohet për shkak të rrezikut të ulët që mbart në vetvete, si edhe për mundësinë që krijon ajo për një ndjekje më të mirë të saj. Kreditimi i ekonomisë në terma afatshkurtër është një nga faktorët kryesorë që mban të ulët realizimin e stokut të kredisë, pasi kompensohet nga shlyerjet. **Kredia në valutë** në tepricën e kredisë përbën 65 për qind, duke shënuar një rritje me 5 pike përqindjeje, në krahasim me fundin e vitit 2000.

²¹ Teprica e kredisë e përfshin tepricën e kredisë të kaluar pranë ATK-së nga BK, BKT, BTA. Në total, teprica e kredive të kaluara në ATK arrin vlerën 8.7 miliardë lekë. Kështu duke zhveshur tepricën e kredisë si sistem bankar në fund të vitit 2001 nga kreditë e kaluara në ATK, kjo tepricë është 27.9 miliardë lekë.


Grafik III-12: Teprica e kredisë sipas afateve (në miliardë lekë).




Grafik III-13: Teprica e kredisë sipas sektorëve (në miliardë lekë).



Grafik III-14: Teprica e kredisë sipas monedhës (në miliardë lekë).



Grafik III-15: Ecuria mujore e rritjes së tepricës së kredisë (në milionë lekë).




Kredia e re ka regjistruar një rritje në masën 67.7 për qind krahasuar me vitin e kaluar ose në vlerë absolute ajo arriti 40.6 miliardë lekë.

Ritmi i akordimit të kredive të reja, gjatë gjithë vitit 2001, ka qenë në rritje. Karakteristikat që kanë shoqëruar lëvrimin e tyre mund të renditen si më poshtë:

- është lëvruar 98.8 për qind në sektorin privat dhe 1.2 për qind në sektorin publik, gjë që tregon për tkurrje të vazhdueshme të kreditimit të sektorit publik në favor të mbështetjes me kredi ndaj sektorit privat;
- 75 për qind e saj është në valutë;
- 68 për qind është kredi afatshkurtër, 26 për qind kredi afatmesme, 6 për qind kredi afatgjatë;
- vlerat më të mëdha i kanë regjistruar muajt shtator dhe dhjetor, përkatësisht me 4.8 dhe 8.2 miliardë lekë, ndërkohë që mesatarisht në çdo muaj është akorduar kredi në masën 3.4 miliardë lekë.

Grafik III-16: Kredi e re e akorduar (mbi baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore) në miliardë lekë.



Tabelë III-6. Ecuria e kredisë së re në vite (në %)

Treguesit	Viti 1999	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2001 sipas tremujorëve			
				T1	T2	T3	T4
Kredi afatshkurtër	66.3	53.3	68.0	62	65	66	73
Kredi afatmesme	31.2	41.3	25.6	25	30	29	21
Kredi afatgjatë	2.5	5.4	6.4	13	5	5	6
Spektori shtetëror	0	0.8	1.2	5	2	0	0.3
Spektori privat	100	99.2	98.8	95	98	100	99.7
Lekë	24	18.0	25	23	28	17	30
Valutë	76	82.0	75	77	72	83	70
Kredi e re (në mld lekë)	8.0	24.2	40.6	4.7	8.2	11.4	16.3

Struktura kohore e kredisë së re "fsheh" edhe një veçori tjetër të saj – ajo është e orientuar ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme, ndërsa projektet dhe planbizneset afatgjata gjejnë ende pak mbështetje në kredinë bankare. Kjo pasqyron edhe strukturën e ekonomisë shqiptare dhe të investimeve që ende nuk janë afatgjata dhe të orientuara nga prodhimi.

Në preferencën për marrjen e kredisë në valutë, ndikon përparësia që ofrojnë normat e ulëta të interesit. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka patur rritja e depozitave në valutë në pasivin e bankave (sidomos të atyre bankave që kreditojnë në valutë) si dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit të lekut. Gjithashtu, ky fenomen nxitet dhe nga fakti që një pjesë e madhe e transaksioneve në ekonominë shqiptare (si dhe e të ardhurave të bizneseve që marrin kredi) është në valutë.

Gjatë vitit 2001, tregtia është dega që zë pjesën më të madhe të mbështetjes nga sistemi bankar me mjete financiare. Por, vazhdojnë të mbështeten me kredi edhe degë të tjera të ekonomisë, si ndërtimi, industria përpunuese, transporti etj.. Një rritje të lehtë ka pësuar kreditimi për klientët në blerjen e apartamenteve nëpërmjet kreditimit për pasuri të patundshme. Kërkesat për kredi në degën e ndërtimit kanë rënë. Një gjë e tillë konfirmon që rritjet në këtë degë do të kenë ngadalësim. Gjithashtu, evidentohet një rënie e kreditimit në degën "*prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike dhe ujit*". Mendohet që një arsye të jetë situata e vështirë energjitike që kaloi vendi gjatë vitit 2001, e cila bëri që kërkesat për kredimarrje të bien.

Tabelë III-7: Teprica e kredisë sipas degëve (në % ndaj tepricës së kredisë).

Nr Degët e ekonomisë	Viti'00	Mars '01	Qer' 01	Shtat'01	Dhjet'01
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1	1	1	1.1	1
2 Peshkimi	1	1	1	1	0.1
3 Industria nxjerrëse	1	1	1	1.9	1.6
4 Industria përpunuese	17	17	20	19.6	19.5
5 Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit	9	9	5	4.3	3
6 Ndërtimi	25	25	27	21.5	12.5
7 Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë	27	25	24	29.4	41.3
8 Hotele dhe restorante	4	7	5	4.9	4.3
9 Transporti dhe Telekomunikacioni	3	1	3	2.3	4.6
10 Aktivitete financiare		1	0	0.1	0.1
11 Pasuritë e patundshme	5	6	7	9.4	6.3
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	3	3	1	1.3	1.2
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	3	3	3	1.8	3.3
14 Të tjera	0	0	2	1.5	1.2
TOTALI	100	100.	100	100	100

III.3.2.2.1. Normat e interesit

Në tregun e huadhënies bankare nuk vërehet ndonjë tendencë e pastër e ecurisë së normave. Sjellja e tyre nuk mund të japë sinjale të drejta për orientim. Akoma nuk mund të themi se kemi një normë interesi tregu për kredinë në lekë. Kjo pasi, nga njëra anë pjesëmarrja e bankave në këtë treg është e kufizuar dhe, nga ana tjetër, Banka e Kursimeve, që zotëron pjesën më të madhe të depozitave në lekë, i investon fondet e siguruar në lekë në bono thesari, repo dhe depozita njëditore pranë Bankës së Shqipërisë.


Normat e interesit për kreditë e akorduara në lekë janë të ndryshme në banka të ndryshme (nga 11-22 për qind, janë interesat më të fundit të zbatuar në muajin dhjetor 2001). Duke qenë se kredi në lekë akordojnë një numër shumë i vogël bankash, ato bëhen dhe përcaktuese në interesin e ponderuar për kredinë e akorduar në lekë.

Interesi i ponderuar si sistem bankar për kreditë e akorduara në lekë, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar, u shoqërua me një tendencë të theksuar drejt rënies, me 10.37 pikë përqindjeje. Reduktimi i normës së interesit të kredive vjen si pasojë e angazhimit të më shumë bankave tregtare në procesin e kreditimit në lekë.

Tabelë III-8. Normat e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në lekë.

	Dhje'99	Dhje'00	Mar '01	Qer'01	Shtat'01	Dhjetor'01
Kreditë deri 6 muaj	21.7	21.19	20.92	24.00	14.64	15.28
Kreditë 6m-1vit	25.8	23.70	16.10	13.98	13.87	11.9
Kreditë 1-3 vjet	26.8	23.74	22.19	14.58	18.17	18.45
Kreditë mbi 3 vjet	22.2	27.00	15.58	15.22	17.00	-
Kreditë gjithsej	25.46	23.56	17.62	14.36	14.67	13.19


Grafik III-17: Ecuria e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në lekë sipas maturimit (në për qind).



Tabelë III-9: Normat e interesit.

Muajt	Int mes.i pond. për kreditë e akorduara në %	Int mes.i pond. për depozitat e pranuar n %	Diferenca Pikë %
Janar	16.72	7.17	9.55
Shkurt	20.05	7.13	12.92
Mars	17.62	7.15	10.47
Prill	15.91	7.11	8.8
Maj	18.18	7.07	11.11
Qershor	14.36	7.06	7.3
Korrik	16.89	7.06	9.83
Gusht	14.72	7.12	7.6
Shtator	14.67	7.10	7.57
Tetor	17.55	7.11	10.44
Nentor	13.61	7.13	6.48
Dhjetor	13.19	7.16	6.03

Grafik III-18: Diferenca e normës së interesit të ponderuar për kreditë e akorduara dhe depozitat e pranuar (në për qindje)



Ecuria e normave të interesit të ponderuar, si për depozitat e pranuar dhe për kreditë e lëvruara, ka qenë e prirur drejt ngushtimit të diferencës midis tyre.

Normat e interesit në valutë si për depozitat dhe për kreditë (në dollarin amerikan dhe në euro) kanë pësuar rënie gjatë vitit 2001. Kjo pasi ato vendosen duke u mbështetur në ecurinë e zhvillimeve në tregun ndërkombëtar. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2001 kjo rënie ka qenë më e ndjeshme.

Tabelë III-10: Normat e interesit për kreditë e akorduara në valutë²².

Periudha	në usd	në euro
Janar	10.07	11.71
Mars	9.52	8.20
Qershor	10.28	7.55
Shtator	7.46	6.64
Tetor	8.85	8.58
Nëntor	8.71	7.98
Dhjetor	8.36	7.26

Në fund të vitit 2001, diferenca e interesit të ponderuar për kreditë e lëvruara dhe për depozitat e pranuar në usd dhe në euro, rezultoi përkatësisht 6.97 dhe 4.9 pikë përqindjeje.

Në ngushtimin e diferencës së interesit të ponderuar, në tërësi, ndërmjet kredive të akorduara dhe depozitave të pranuar, faktor kryesor ka qenë tendenca në rënie e interesave për kreditë, si në lekë dhe në valutë.

III.3.2.2.2. Kreditimi i ekonomisë krahasuar me programin monetar për vitin 2001.

Rritja mesatare mujore e tepricës së kredisë gjatë vitit 2001, sipas llogaritjeve, rezulton 892 milionë lekë, duke qenë më e lartë se rritja mesatare mujore e parashikuar në programin monetar të rishikuar në muajin nëntor 2001 (567 milionë lekë). Në përgjithësi, ritmi i kreditimit mujor, siç u trajtua dhe më sipër, ka qenë i ndryshëm. Në gjashtëmujorin e dytë pati një hop të madh në drejtim të investimit të fondeve nga ana e bankave në tregun e huadhënies bankare dhe shifra e parashikuar në programin monetar u realizua që në muajin nëntor 2001. **Për herë të parë, gjatë tre viteve të fundit, parashikimi në programin monetar për kreditimin e ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar, jo vetëm që realizohet, por ai u tejkalua në masën 57.4 për qind.**

²² Për llogaritje të tilla, për herë të parë, filluan të kryhen në muajin nëntor '01 nga sektori i informacionit.


Box III-2: Fenomeni i përqendrimit në tregun e huadhënies bankare.

Tregu i huadhënies në sistemin tonë bankar mund të konsiderohet si një treg i përqendruar, pasi numri i pjesëmarrësve aktivë në këtë treg është i vogël. Një situatë e tillë ul efikasitetin e çmimit të kredisë duke ofruar shërbime me kosto më të lartë se sa do të ofroheshin në kushtet e konkurrencës së lirë.

Gjatë vitit 2001, do të veçonim:

- Pësia e Bankës së Kursimeve nga 32 për qind që zinte në tepricën e kredisë si sistem (dhjetori 2000), arriti 3 për qind (dhjetor 2001). Kjo rënie e konsiderueshme erdhi si pasojë e kalimit të një pjese të kredisë të saj pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive.
- Vlera e indeksit H për kredinë, ka qenë 0.3 në fund të vitit 2000 dhe në fund të vitit 2001 është 0.2, shifër që tregon përsëri për një zbutje të lehtë të këtij fenomeni.
- Indeksi H për kredinë në lekë, në fund të vitit 2001, paraqitet shumë afër vlerës optimale (1/13). Kjo situatë, më tepër lidhet me kalimin e një pjese të kredisë në lekë të Bankës së Kursimeve pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive, si dhe me numrin në rritje të bankave që kreditojnë në lekë.
- Në fund të vitit 2001, numri i bankave që marrin pjesë aktive në tregun e kredisë është rritur ndjeshëm (nga katër në gjashtë). Peshën më të lartë në tepricën e kredisë si sistem bankar e zë Banka Alfa dhe me radhë bankat e tjera duke zëvendësuar kështu pozicionin e kredisë të Bankës së Kursimeve. Kjo tregon për një zbutje të fenomenit të përqendrimit.

Grafik III-19: Ecuria e indeksit të Herfindahlit për treguesit e kredisë.



Lëvrimi i kredive të reja, në dy vitet e fundit ka arritur në nivele dyshifrore. Të gjitha bankat, në përgjithësi, japin kredi, por niveli i akordimit të tyre në banka të ndryshme paraqitet në madhësi të ndryshme².

Duke iu referuar dy periudhave të marra në shqyrtim, vitit 2000 dhe vitit 2001, konkludojmë se përsa i përket kredive të reja të akorduara nga sistemi, fenomeni dominues është i pranishëm, por me tendencë të lehtë në rënie.

Tabelë III-11: Përmbledhëse për indeksin N të katër bankave kryesore.

Periudha	Totali i kredive	Kredi a.shkurtër	Kredi a.mesme	Kredi a.gjatë	Kredi në sek. publik	Kredi në sek.privat	Kredi në lek	Kredi në valutë
Dhjetor'00	83	81	90	51	94	83	90	81
Mars'01	83	80	92	82	100	82	91	67
Qershor'01	77	72	90	72	60	78	84	56
Shtator '01	80	77	88	72	61	80	87	78
Dhjetor '01	83	83	87	72	64	84	92	81

Megjithatë, për vitin 2001 vërejmë se në tregun e huadhënies Banka Alfa ka një rritje të konsiderueshme të investimit të fondeve të saj në tregun e huadhënies dhe, nga ana

Box III-3. Vrojtim për aktivitetin kreditues të bankave të nivelit të dytë, gjatë vitit 2001.

Gjatë vrojtimeve të zhvilluara pranë bankave të nivelit të dytë u vu re se, biznesi i mesëm është më i preferuar në kreditim nga ana e bankave. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit, vihet re një zhvendosje e vëmendjes së bankave në procesin e kredidhënies në drejtim të biznesit të madh. Preferenca e theksuar e specialistëve për biznesin e madh motivohet me besueshmërinë e lartë dhe me rrezikun e ulët që ai po u ofron gjithmonë e më tepër bankave.

Niveli mesatar i realizimit të kredisë është rritur ndjeshëm. Gjatë kësaj periudhe, nënvizohet se numri i bankave që e kanë realizuar dhe e kanë tejkaluar planin është rritur në mënyrë të konsiderueshme ndaj periudhës së mëparshme. Kjo ka ardhur si rezultat i përvojës gjithmonë në rritje të bankave, të lidhjeve të forta që ato krijojnë me klientët e tyre dhe të shërbimeve të personalizuar që ato ofrojnë.

Por, nga ana tjetër, duhet theksuar se specialistët e kreditit besojnë se kriza energjitike ka vështirësuar veprimtarinë normale të bizneseve duke dhënë ndikimin e saj dhe në ecurinë e veprimtarisë kredituese të bankave.

Pjesa më e madhe e specialistëve vlerësojnë që ndikimin negativ, situata e rënduar energjitike, do ta ketë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2002.

Për vitin 2001, mund të themi se rreziku i kredisë mbetet në kufijtë mesatarë, me një tendencë të lehtë në rritje. Kjo tendencë disi e qëndrueshme e rrezikut, argumentohet me kushtet e mjedisit ekonomik dhe politik që kanë mbetur pothuajse të njëjta.

Tregu joformal i kredisë konsiderohet të ketë rënë përgjatë gjithë vitit 2001. Ndër arsyet kryesore u përmendën:

- rritja e numrit të institucioneve kredituese,
- siguria që ato ofrojnë në krahasim me tregun joformal,
- normat e kredisë që kanë ardhur në rënie në tregun joformal.

Nga opinionet e specialistëve del qartë që aktivitetet bujqësore dhe të transportit vazhdojnë të mbeten larg preferencave të bankave për kreditim.

Në lidhje me nivelin e kreditimit në të ardhmen, parashikimet janë positive. Kjo duket qartë nga përgjigjet optimiste dhe të konsoliduara të specialistëve, të cilët nënvizuan planet ambicioze për rritjen e aktivitetit kreditues të bankave.

Box III-4: Një vështrim mbi aktivitetin kreditues të subjekteve jobanka, gjatë vitit 2001.

Zhvillimi i një sektori privat dinamik dhe të fuqishëm, veçanërisht i atij që lidhet me aktivitetin e biznesit të vogël dhe të mesëm, të krijuar pas ndryshimeve të rëndësishme politike apo si rezultat i privatizimit, është konsideruar si një prioritet që prej fillimit të reformave në Shqipëri. Pothuaj të gjitha bizneset, që operojnë në vendin tonë, mund të përcaktohen si biznese të vogla dhe të mesme. Kjo do të thotë se politika e qeverisë lidhur me zhvillimin e sektorit privat, me përkufizim, mund të konsiderohet politikë e zhvillimit të biznesit të vogël dhe të mesëm. Një politikë e tillë synon të krijojë një klimë më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat, të shoqëruar dhe me një program masash konkrete të karakterit legjislativ, institucional dhe financiar. Aktualisht, në Shqipëri veprojnë një numër jo i vogël organizmash dhe fondacionesh të huaja, të përbashkëta dhe shqiptare, që ushtrojnë aktivitetin kreditues në mbështetje të biznesit shqiptar.

Disa prej tyre janë:

Fondi Shqiptar-Amerikan i Ndërmarrjeve. U krijua nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e zhvillimit demokratik të vendeve të Europës Lindore, në vitin 1989. Ky fondacion ka të drejtën të bëjë investime dhe të japë kredi, të ofrojë asistencë teknike për të nxitur nismën e lirë private, sipërmarrjen dhe privatizimin në Shqipëri. Më shumë është përqendruar në mbështetjen e hapjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si edhe të atyre të përbashkëta.

Fondacioni "BESA". Është institucion për kreditimin e biznesit të vogël. Ngritja e këtij fondacioni u bë me qëllim që të nxisë bizneset shumë të vogla dhe të vogla, duke përfshirë individë të vetëpunësuar që operojnë në aktivitetet ekonomike të shkallës së ulët në Shqipëri, të krijojë vende pune dhe të nxisë vetëpunësimin. Financohen nga ky fondacion të gjitha llojet e bizneseve shumë të vogla, që realizojnë të ardhura si: tregtare, prodhuese, përpunuese, artizanale etj..

Nëpërmjet shërbimit të tij fondacioni "Besa" u ofron klientëve:

- mbështetje financiare në zhvillimin e biznesit të tyre;
- rritje të të ardhurave të tyre, duke rritur në këtë mënyrë të ardhurat e buxhetit të shtetit;
- krijimin e vendeve të reja të punës;
- kualifikimin në ndërtimin e një biznesplani të thjeshtë, të llogaritjeve për rrjedhjen e parasë etj..

Përfituesit e kredisë janë:

- personat që sapo kanë nisur një aktivitet të vogël;
- personat që duan të zhvillojnë më tepër biznesin;
- personat që nuk mund të përfitojnë kredi nga bankat.

Fondi i Financimit Rural. Programi i kredisë rurale zbatohet në kuadër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe ka si objekt kryesor të ndikojë në zbutjen e varfërisë, i cili është problemi më kritik për Shqipërinë. Kjo vjen si rezultat i marrëveshjes së lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore.

Gjithashtu ai ndihmon në:

- zhvillimin e zonave rurale nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës, dhe fuqizimit të aktiviteteve ekonomike;
- zhvillimin e sektorit privat;
- nxitjen e krijimit të shoqatave të fshatit;
- krijimin e një sistemi financiar të decentralizuar në nivel fshati.

Programi i kredisë rurale ka ofruar deri tani një sistem të ri kreditimi, të bazuar në bashkëpunimin midis këshillit të kredisë së fshatit dhe oficerit të kredisë. Ai bashkëpunon vetëm në fshatra të organizuar në shoqatë.

“Irish Credit Union”. Aktiviteti i këtij fondacioni është asistencë teknike për krijimin e shoqërive kursim-kredi. Ky fondacion bashkëpunon me fondacionin Land’O Likes, IFDC -në, të financuar nga USAID, të cilët krijojnë grupe të interesuarish të një profesioni ose të një zone të vogël, kryesisht në sektorin e fshatit. Si rezultat i punës së këtij fondacioni janë krijuar 32 shoqëri kursim-krediti, me regjistrim të rregullt në gjykatë. Fondacioni ka hartuar dhe një rregullore për funksionimin e shoqërive kursim-kredi.

Organizata “Opportunity International”. Ka krijuar një partner shqiptar të regjistruar si “Partneri Shqiptar në Mikrokredi”, i cili operon në bazë të ligjit për shoqëritë kursim-kredi. Aktiviteti i tij konsiston në dhënien e kredive të vogla (10 mijë-25 mijë lekë) duke zhvilluar dhe trajnime në të njëjtën kohë me klientët e tyre.

Në vrojtimet e kryera gjatë vitit 2001, arsyet që ndeshen më shpesh për financimin e biznesit të vogël nga subjektet jobanka janë:

- strategjia që ndjek agjencia;
- aftësitë e kufizuara monetare të shoqërisë për të kredituar llojet e tjera të bizneseve;
- siguria që ofron ky biznes, edhe në kushtet e kredidhënies pa kolateral, sikurse mund të punojnë këto agjenci;
- ky lloj biznesi paraqet kërkesën më të lartë për kredi.

Specialistët e kreditit pranë këtyre agjencive, në lidhje me rrezikun aktual të kredisë, mendojnë se është në po të njëjtat nivele, me një tendencë të lehtë në rënie. Kjo ka ardhur si rezultat:

- i qëndrueshmërisë së përgjithshme të krijuar;
- i krijimit të edukatës së kredimarrjes;
- i ndërgjegjësimit të klientëve.

Në lidhje me tregun jozyrtar, specialistët janë të mendimit se madhësia e këtij tregu ka ardhur në rënie, sepse po ofrohen gjithmonë e më shumë mundësi kreditimi nga tregu zyrtar.

E ardhmja e kreditimit, sipas specialistëve të agjencive, do t'i takojë së pari sektorit të tregtisë dhe, më pas, atij të bujqësisë. Gjithashtu, nga opinionet e specialistëve duket qartë që sektori i industrisë dhe ai i transportit janë larg preferencave kredituese të agjencive.

Nëse krahasohen preferencat e bankave me preferencat e agjencive, shohim se ato kanë një pikë të përbashkët: kreditimi i sektorit të tregtisë si preferencë parësore.

Pjesa më e madhe e specialistëve parashikojnë një nivel më të lartë se sa ai aktual për kreditimin e ekonomisë në të ardhmen, gjë që dëshmon për planet ambicioze të këtyre organizatave për të zgjeruar më shumë aktivitetin e tyre.

III.4. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Viti 2001 mund të konsiderohet një vit i suksesshëm përse i përket zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë tërësisht me instrumentet indirekte. Jo vetëm kaq, por bashkë me implemetimin e instrumenteve të reja vërehet dhe një dinamizëm dhe zhvillim më i madh në tregun ndërbankar.

III.4.1. Ankandet dhe norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve njëjavore.


Marrëveshjet e riblerjeve përbëjnë instrumentin bazë të transmetimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë. Zhvillimet në tregun e repove²³ kanë pasqyruar dhe sinjalizuar drejtpërsëdrejti qëndrimet e Bankës së Shqipërisë ndaj zhvillimeve monetare në vend. Zbatimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është realizuar kryesisht nëpërmjet ankandeve të marrëveshjeve të riblerjes. Një vështrim mbi politikën monetare të Bankës së Shqipërisë na mundëson paraqitjen e zhvillimeve në tregun e repove.

²³ Repo është shkurtimi i termit marrëveshje riblerjeje.

Në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2001 dallojmë tre momente:

❖ Deri në muajin maj të vitit 2001, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një

Grafik III-20: Vëllimi dhe norma e interesit në ankanDET e repove (në milionë lekë).



politikë monetare liberale, zbatimi i të cilës bëhej nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjeve me normë interesi dhe vëllim të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe repot kishin për qëllim thithjen e likuiditeteve të tepërta dhe kufizoheshin në vëllim sipas vendimeve të marra nga Banka e Shqipërisë. Pas muajit maj, me ndryshimin e një sërë faktorëve ekonomikë e politikë si, shpenzime të larta të qeverisë për efekt të fushatës elektorale, tendencë në rritje e parasë jashtë bankave, rënie e *yield*-it të bonove të thesarit, u krijuan premisa për një politikë monetare më të kujdesshme ndaj normave të interesit.

❖ Për të eliminuar ndonjë tendencë për uljen e normave të interesit të depozitave (pasi *yield*-i i bonove të thesarit muaj pas muaji po shfaqte rënie), Banka e Shqipërisë vendosi të tërheqë nga tregu, me anë të marrëveshjeve të riblerjeve rezervat e lira. Për këtë, u kalua nga marrëveshjet e riblerjeve me çmim dhe vëllim të përcaktuar në marrëveshjet e riblerjeve me çmim të përcaktuar dhe më vëllim të pakufizuar.

❖ Momenti i tretë i përket muajit gusht e në vazhdim. Nisur nga gjendja e likuiditetit në sistemin bankar dhe nga zhvillimet më të fundit në indeksin e çmimeve të konsumit, Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve me 0.5 pikë përqindjeje. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte frenimi i presioneve inflacioniste duke i vënë theks thithjes së rezervave të tepërta të sistemit bankar dhe uljes së nivelit të parasë jashtë bankave. Pas këtij momenti, Banka e Shqipërisë vazhdoi të ndjekë të njëjtin kurs të politikës së saj deri në fund të vitit. Menjëherë pas rritjes së normës së interesit të repove nga 6.5 në 7 për qind, *yield*-i i bonove të thesarit në tregun primar reagoi me të njëjtin kah dhe madhësi. Për normën e interesit të depozitave në lekë mund të themi që pothuajse ka qenë e pandryshueshme deri në fund të vitit. Për gjithë vitin 2001, normat e interesit të depozitave në lekë janë luhatur nga 6.85 në 6.91 për qind për depozitat tremujore, nga 7.23 në 7.61 për qind për depozitat gjashtëmujore dhe nga 7.68 në 8 për

qind për ato dymbëdhjetëmujore. Norma e interesit të kredisë për ekonominë në lekë nuk është ndikuar ndjeshëm nga ndryshimet në normën e repove. Norma e interesit të kredisë ka patur luhatje të dukshme pavarësisht nga zhvillimet në tregun e repove.

Në ankandet e zhvilluara për marrëveshjet e riblerjeve kanë marrë pjesë pothuajse të gjitha bankat e nivelit të dytë. Vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve të marrëveshjeve të riblerjes ka qenë 409 miliardë lekë. Mesatarisht në çdo ankand janë angazhuar rreth 7.6 miliardë lekë me një numër mesatar pjesëmarrësish prej pesë bankash. Shuma më e madhe e investuar në ankandet e repove ka qenë 14.3 miliardë lekë, ndërkohë që është shënuar dhe një rast kur ankandi nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së pjesëmarrësve. Vlen të përmendim se ashtu si dhe në segmentet e tjera të tregut të parasë (tregu primar, depozitat, tregu ndërbankar) pjesëmarrësi kryesor ka qenë Banka e Kursimeve duke zotëruar 91 për qind të pjesës së tregut të repove.


III.4.2. Marrëveshjet e riblerjeve një dhe tremujore

Në muajin nëntor të vitit 2001 u miratua përdorimi i ankandeve me afat maturimi një dhe tremujor, duke shtuar alternativat e trajtimit të likuiditetit të tepërt në treg. Kështu, në muajin dhjetor u mbajt ankandi për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi njëmujor. Qëllimi i këtij transaksioni ishte tërheqja e përkohshme e likuiditetit të tepërt dhe rregullimi i nivelit të tij për sistemin. Vëllimi i këtij transaksioni ishte në masën dy miliardë lekë dhe norma e interesit e ofruar nga pjesëmarrësit e ankandit luhatej nga 7.35 në 7.5 për qind.

III.4.3. Rezerva e detyrueshme

Rezerva e detyrueshme edhe gjatë vitit 2001 vazhdoi të përdorej në rolin e një instrumenti kyç në kuadrin operacional për zbatimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Si një instrument indirekt i politikës monetare, rezerva e detyrueshme është përdorur për të kontrolluar ofertën e parasë si dhe për të ndikuar në thithjen e pjesshme të likuiditetit të tepërt të sistemit bankar. Norma e interesit për rezervën e detyrueshme vazhdon të jetë 10 për qind e totalit të depozitave të bankave në lekë dhe në valutë. Rezerva e mbajtur në lekë dhe në valutë, gjatë vitit 2001, shfaqti tendencë në rritje. Kështu, rezerva e detyruar në lekë u rrit nga 16 miliardë lekë, që ishte në fillim të vitit në 18 miliardë lekë në fund të tij.

Grafik III-21: Rezerva e detyrueshme në lekë (në miliardë lekë).



Banka e Shqipërisë njih faktin që mbajtja e rezervës së detyrueshme përbën kosto për bankat. Për të zbutur sadopak këtë kosto, si dhe për t'u krijuar bankave mundësinë e zvogëlimit të diferencës midis normës së interesit të kredisë dhe depozitave, e për rrjedhojë për të rritur efektivitetin e mekanizmit të transmisionit, vendosi, që për vitin 2001, të rrisë **normën e interesit për remunerimin e rezervës së detyrueshme në lekë dhe në valutë** si më poshtë:

- për rezervën e detyrueshme në lekë:

nga 1/3 në 1/2 të *yield*-it mesatar të bonove të thesarit me maturim tremujor;


- për rezervën e detyrueshme në valutë :

nga 1/3 në 1/2 të interesit libor, euribor për depozitat me afat njëmuor në usd, euro.

Ky ndryshim në rritjen e interesit të remunerimit të rezervës së detyrueshme mund të konsiderohet si një lloj nxitjeje për sistemin bankar, për të reflektuar në uljen e diferencës së interesave kredi-depozitë. Për vitin 2001, remunerimi i rezervës së detyrueshme në lekë dhe në valutë arriti vlerën 802 milionë lekë.

Rezerva e detyrueshme në lekë vazhdon të mobilizohet deri në 5 për qind të nivelit të saj, duke shërbyer si një amortizator për administrimin ditor të likuiditetit të bankave. Krijimi i një lehtësie të tillë kredituese nga Banka e Shqipërisë, për bankat e nivelit të dytë nuk e ul nevojën për përmirësimin e sistemit të pagesave, i cili është akoma larg kërkesave të ekonomisë së tregut. Gjatë vitit 2001 përdorimi deri në 5 për qind i rezervës së detyrueshme në lekë është shfrytëzuar ndjeshëm pothuajse nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, të cilat kanë ndjekur dhe kanë respektuar me rigorozitet detyrimet në lidhje me këtë instrument. Të pakta janë rastet kur Banka e Shqipërisë ka zbatuar gjopa për mosplotësim të rezervës së detyrueshme në lekë dhe në valutë.

Grafik III-22: Rezerva e detyrueshme në valutë gjatë vitit 2001 (në milionë).



Tabelë III-12: Interesat e remunerimit sipas muajve.

Interesat e remunerimit në %			
Muajt	Lekë	Dollarë	Euro
Dhjetor'00	3.91	3.00	2.42
Janar'01	3.86	2.79	2.40
Shkurt'01	3.76	2.53	2.40
Mars'01	3.78	2.53	2.45
Prill'01	3.72	2.30	2.30
Maj'01	3.73	1.98	2.27
Qershor'01	3.75	1.88	2.27
Korrik'01	3.75	1.81	2.25
Gusht'00	3.88	1.69	2.12
Shtator'01	4.00	1.26	1.89
Tetor'01	3.98	1.05	1.78
Nëntor'01	4.00	0.97	1.72
Dhjetor'01	4.00	0.97	1.72

III.4.4. Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota

Gjatë vitit 2001 Banka e Shqipërisë shiti bono thesari nga portofoli i saj në masën 8 miliardë lekë. Qëllimi i dy transaksioneve të zhvilluara ka qenë tërheqja e likuiditetit të tepërt nga sistemi. Për realizimin e tyre është vepruar me procedurë ankandi, ku blerëse ka qenë Banka e Kursimeve.

III.4.5. Kredia njëditore

Vëllimi total kumulativ i kredisë njëditore, për vitin 2001, arriti shifrën 9.8 miliardë lekë. Kredia njëditore është përdorur nga ana e bankave për rregullimin e gjendjeve ditore të likuiditetit të tyre. Për vitin 2001, kredia mesatare mujore ka

qenë 0.82 miliardë lekë. Ritmi i përdorimit të këtij instrumenti, gjatë gjashtëmujorit të dytë, ka qenë më i ulët krahasuar me gjashtëmujorin e parë (mesatarisht në muaj 0.8 miliardë kundrejt 1.7 miliardëve për gjashtëmujorin e parë).

Duke qenë se norma e interesit të kredisë njëditore është drejtpërsëdrejti e lidhur me normën e interesit të repove, me ndryshimin e kësaj të fundit në muajin gusht prej 0.5 për qind, norma e interesit të kredisë ndryshoi nga 9 në 9.5 për qind.

III.4.6. Depozita njëditore

Ndërsa kredia njëditore përfaqësonte një mjet për plotësimin e nevojave të bankave për likuiditete, depozita njëditore funksionon në kah të kundërt, në atë të investimit apo të tërheqjes së likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar. Gjatë vitit 2001, niveli kumulativ i depozitës njëditore për gjithë sistemin arriti shifrën 252 miliardë lekë. Mesatarisht çdo muaj është investuar në depozitë njëditore rreth 21 miliardë lekë.

Me ndryshimin e normës së interesit të repove, norma e interesit të depozitës njëditore u rrit nga 4 në 4.5 për qind.

III.4.7. Kredia lombard

Në ditën e fundit të vitit 2001 nga dy banka të sistemit u mor kredia lombard në masën 273 milionë lekë dhe për një afat maturimi tetëditor. Për vitin 2001, ky ishte rasti i parë i përdorimit të kësaj kredie që konsiderohet si kredia më e shtrenjtë, e vënë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë. Megjithatë, kredia lombard në këtë rast nuk ishte si pasojë e mungesave të likuiditetit në sistem (siç është rasti tipik i përdorimit të saj) por shkak për të u bënë vonesat në koordinim, në bankat që kryejnë shërbimin e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve për buxhetin e shtetit.


III.5. TREGU I PARASË DHE ADMINISTRIMI I LIKUIDITETIT

III.5.1. Situata e likuiditetit gjatë vitit 2001

Viti 2001 vazhdoi të ruajë të njëjtat karakteristika me një vit më parë përse i përket nivelit të likuiditeteve në sistemin bankar. Siç është vënë re vitet e fundit, sistemi bankar shqiptar, në mungesë të investimeve të konsiderueshme në kredi për ekonominë ka patur si tipar të dallueshëm tepricat në likuiditete apo në rezerva të lira. E veçanta e vitit 2001 qëndron në faktin se Banka e Shqipërisë e rriti gamën e instrumenteve në dispozicion të bankave të nivelit të dytë, duke u krijuar më shumë mundësi atyre për investimin e likuiditeteve të lira. Gjithashtu, njohja, prezantimi dhe zbatimi i instrumenteve të rregullimeve strukturore të likuiditetit ka bërë që niveli i likuiditeteve apo i rezervave të tepërta të sistemit, të

ketë lëvizur në funksion të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Rezervat e tepërta të bankave të nivelit të dytë për vitin 2001, kanë qenë të materializuara në marrëveshje riblerjeje, depozitë njëditore dhe llogari rrjedhëse.


Grafik III-23: Niveli i rezervave të tepërta për vitin 2001.



Duke krahasuar fundvitin 2000 me atë 2001, vërehet që niveli i rezervave të tepërta ka rënë përkatësisht nga 9.7 miliardë në rreth 3 miliardë lekë. Dhe kjo nuk është e rastit, por ashtu siç paraqitet dhe grafikisht, tendenca në rënie e rezervave të tepërta është rezultante e politikave të Bankës së Shqipërisë në lidhje me rezervat e tepërta dhe me normat e interesit. Rënia në llogarinë rrjedhëse dhe rritja e investimeve në depozita njëditore dhe në marrëveshje riblerjeje. Vlerësohet si një tregues i mirë i vendosjes me eficiencë të fondeve që përmirëson rentabilitetin e bankave.

Gjithashtu, përmendim se është konsoliduar disi administrimi aktiv i fondeve të lira në sistemin bankar. Bashkë me depozitat njëditore në rastet e likuiditeteve të tepërta është përdorur dhe kredia njëditore në rastet e mungesave të tyre. Nuk mund të lemë pa përmendur këtu rolin e tregut ndërbankar, i cili ka marrë formë të plotë aktive pothuajse vetëm gjatë vitit 2001. Bankat e nivelit të dytë, në tërësi, janë treguar të kujdesshme në administrimin e likuiditeteve. Fondet e sistemit bankar, të mbledhura kryesisht me depozita dhe shërbime të tjera bankare (rasti i Bankës së Kursimeve që shërben si agjente e qeverisë) janë trupëzuar në investime në bono thesari, në kredi për ekonominë (megjithëse në sasi më të vogël se kredia për qeverinë) në marrëveshje riblerjeje, në depozita njëditore dhe në treg ndërbankar.


Grafik III-24: Normat e interesit në tregun e parasë.




III.5.2. Tregu ndërbankar

Tregu ndërbankar, që përfaqëson tregun e huadhënies ndërmjet bankave të nivelit të dytë, si karakteristikë kryesore për vitin 2001 ka patur zhvillimin e tij. Vëllimi i përgjithshëm kumulativ i transaksioneve arriti në rreth 29.4 miliardë lekë ose rreth 6.3 herë më shumë se në vitin 2000. Ky fenomen shihet sitregues i një administrimi aktiv dhe i një reagimi më të ndjeshëm të bankave të sistemit ndaj kushteve të tregut.

Grafik III-25: Tregu i huamarrjes.



Grafik III-26: Tregu i huadhënies.




Mjaft nga bankat janë pozicionuar si huamarrëse, por jo për shkak të mungesave të likuiditeteve, por për një administrim më të mirë, më eficient dhe më fitimprurës të likuiditeteve. Bankat kanë patur pothuajse të njëjtën preferencë si për transaksionet me afat maturimi deri në 7 ditë ashtu dhe për ato mbi 7 ditë. Numri i transaksioneve për gjithë vitin ka qenë 306, duke shënuar nivelin më të lartë në muajin tetor si për numër transaksionesh 58, ashtu dhe për vëllim, 6.67 miliardë lekë. Shuma më e madhe e një transaksioni ka qenë 0.7 miliardë lekë dhe më e vogla 0.9 milionë lekë.

Pjesëmarrësit e këtij tregu kanë qenë të shumtë, por pozicionin më të madh si huadhënës e ka patur Banka e Kursimeve duke zënë 61.4 për qind të pjesës së tregut, ndërsa si huamarrëse spikat Banka Tirana, e cila ka huazuar nga sistemi bankar, për afate të shkurtra maturimi, rreth 57 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tregtuar. Bankat e tjera të sistemit, janë përfshirë të gjitha, në transaksione ndërbankare, duke u pozicionuar herë si huadhënëse dhe herë si huamarrëse.

Përsa i përket normës së interesit të këtij tregu ajo ka pasqyruar normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve dhe lëvizjet e *yield*-it të bonove të thesarit në tregun primar. Për huadhënien ndërbankare njëditore, për gjithë vitin 2001,

Grafik III-27: Vëllimi mujor i transaksioneve në tregun ndërbankar (në milionë lekë).



norma e interesit është luhatur në intervalin 4.25-6.45 për qind. Për transaksionet ndërbankare, me afat maturimi më shumë se një ditë, norma minimale e interesit ka qenë 6.8 për qind, ndërsa ajo maksimale 7.5 për qind.

III.5.3. Tregu Primar i Bonove të Thesarit dhe Marrëdhëniet me Qeverinë

Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë, si agjente financiare e qeverisë, me Ministrinë e Financave, si përfaqësuese e qeverisë, edhe për vitin 2001 janë përqëndruar në ndjekjen e vazhdueshme të llogarisë së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë. Në këtë kuadër nuk kanë munguar nisma e masa të ndryshme me karakter operacional dhe rregullues për respektimin e objektivave të programit monetar të Bankës së Shqipërisë lidhur me financimin e brendshëm të deficitit buxhetor.

Sipas karakteristikave në mbledhjen e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve të qeverisë, në vitin 2001 mund të dallojmë dy momente:

- ❖ Pjesa e parë e vitit është karakterizuar nga një gjendje e mirë likuiditeti në llogarinë e qeverisë, kryesisht si rezultat i mbledhjes me efektivitet të të ardhurave të buxhetit dhe e një shfrytëzimi të mirë të të ardhurave nga

privatizimi. Kështu, në vijim të kërkesës së ulët të buxhetit të shtetit për fonde, vlera e emetimeve të reja të bonove të thesarit në ankandet e rradhës ka qenë më e ulët se vlera e maturimeve. Kërkesa e ulët e qeverisë për financim me bono thesari bëri që *yield*-i i bonove të thesarit të ketë një rënie graduale për gjithë periudhën (gjashtëmujori i parë i vitit), rënie kjo më e ndjeshme për afatet e maturimeve gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore. Kështu, nga muaji janar deri në qershor të vitit 2001 *yield*-i ra me rreth 0.27 për qind, 1.87 për qind dhe 2.05 për qind respektivisht për bonot e thesarit me afat maturimi tre, gjashtë dhe dymbëdhjetë muaj. Duhet vënë në dukje se muaji maj shënoi nivelin më të ulët të *yield*-it të bonove të thesarit për gjithë vitin 2001. Në këtë muaj, *yield*-i gjendej në nivelet 7.47, 9.15 dhe 9.65 për qind përkatësisht për bonot e thesarit tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore. Muaji maj është karakterizuar nga një gjendje e bollshme likuiditetesh në llogarinë e qeverisë, në të cilën ka ndikuar dhe transferimi i një pjese nga fitimi i Bankës së Shqipërisë për vitin 2000 si dhe pjesa e fitimit e planifikuar për t'u derdhur në këtë periudhë të vitit, gjithsej 3.9 miliardë lekë. Po në gjashtëmujorin e parë të vitit 2001, sipas marrëveshjes me Ministrinë e Financave është konvertuar detyrimi i vjetër në masën 9.4 miliardë lekë, është shlyer kredia direkte e vitit 2000 prej 6 miliardë lekësh, si dhe është shlyer përfundimisht detyrimi për obligacionet e kooperativave bujqësore, në masën 1.95 miliardë lekë.

- ❖ Momenti i dytë, që përkon me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2001, ka qenë i ndryshëm, veçanërisht për sa i takon mënyrën së financimit të deficitit buxhetor. Shpenzimet kanë vijuar të jenë më të larta se të ardhurat. Kryesisht për këtë arsye dhe në vazhdimësi të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, ecuria e normave të interesit të bonove të thesarit në tregun primar ka ndaluar rënien, madje ka shënuar një rritje të lehtë. Në fund të muajit shtator, *yield*-i i bonove të thesarit me maturim tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujor ka qenë përkatësisht 7.93, 9.52 dhe 10.49 për qind.

Me afrimin e fundit të vitit dhe **mundësinë e përqendrimit të një pjese të shpenzimeve në këtë periudhë**, synimi kryesor ka qenë të sigurohej një nivel optimal likuiditeti në llogarinë e qeverisë. Në ankandet e fundvitit, vlera e emetimeve të reja ka qenë mesatarisht rreth 2 miliardë lekë më tepër se vlera e maturimeve. Madje, në ankandin e fundit të vitit (25 dhjetor) shuma e kërkuar nga Ministria e Financave nuk është plotësuar dhe për të lejuar një rrjedhë normale të veprimeve të qeverisë është akorduar menjëherë kredia direkte, në masën 2.71 miliardë lekë. Në fund të vitit 2001, *yield*-i i bonove të thesarit me maturitete tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore ka qenë përkatësisht 7.99, 9.74 dhe 10.49 për qind. Deri në fund të muajit tetor, në llogarinë e qeverisë është transferuar fitimi i Bankës së Shqipërisë, sipas marrëveshjes përkatëse. Për sigurimin e një niveli të kënaqshëm të llogarisë së qeverisë në vijim janë zbatuar vendimet e Komitetit të Administrimit të Borxhit të Brendshëm.

Për vitin 2001, vëllimi total i bonove të thesarit të emetuara në tregun primar kap shumën 520.8 miliardë lekë ose rreth 192.9 miliardë lekë më shumë se në vitin

2000. Në këtë rritje, ka ndikuar dhe konvertimi në bono thesari i borxhit për Bankën Kombëtare Tregtare dhe për Bankën e Kursimeve. Vlera totale e bonove të thesarit, të maturuara gjatë vitit 2001, arriti shifrën 468.2 miliardë lekë nga 270.2 miliardë që ishte në vitin 2000.

Pjesëmarrës në tregun primar kanë qenë bankat e nivelit të dytë, institucione të ndryshme financiare jobanka si dhe individë, të cilët në fund të vitit zotëronin rreth 2.5 miliardë lekë bono thesari, të emetuara në tregun primar. Numri total i kërkesave për pjesëmarrje në ankandet e tregut primar ka qenë 2,813.

Duke parë interesin e publikut në investimet e tregut primar të bonove të thesarit dhe për t'iu krijuar lehtësi atyre që hyjnë në këtë treg, në muajin gusht të vitit 2001, Banka e Shqipërisë çeli brenda institucionit të saj sportelin e bonove të thesarit. Ky sportel mundësoi pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të individëve (jo nëpërmjet bankave të nivelit të dytë) në ankandet e bonove të thesarit. Deri në fund të vitit 2001, numri i pjesëmarrësve arriti në 431, ndërkohë që shuma e pjesëmarrjes së tyre kapi nivelin 366.6 milionë lekë. Nga këto, 52 për qind e fondeve janë investuar në bono me afat maturimi dymbëdhjetëmujor, 39 për qind në bono me maturim gjashtëmujor dhe 9 për qind në bono thesari me maturim tremujor.

Banka e Shqipërisë, ka synuar në shndërrimin e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë në një instrument investimi të kënaqshëm dhe të kërkuar nga një masë sa më e gjerë publiku.

III.5.4.Tregu sekondar

Veprimet në tregun sekondar, vijuan të mbeten të kufizuara edhe në vitin 2001. Për gjithë vitin, vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve kapi shifrën 3.8 miliardë lekë, në të 17 transaksionet e kryera, të cilat kanë përfshirë 6 pjesëmarrës. Blerësja kryesore e bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë në këtë treg ka qenë Banka e Kursimeve, fakt i cili shpjegohet me gjendjen e madhe të likuiditeteve të kësaj banke, në kushtet kur ajo është ende e pezulluar nga kredidhënia për sektorin privat.

Zhvillimi i tregjeve dhe i instrumenteve gjatë vitit 2001 lë hapësirë të mendojmë se viti 2002 do të përmirësojë edhe më, si kuadrin institucional ashtu dhe atë teknik të funksionimit të tregut të parasë, duke ndihmuar kështu në konsolidimin e procesit të transmetimit të politikës monetare. Me objektivin për të njohur më mirë nevojat e bankave për likuiditet në të ardhmen, Banka e Shqipërisë është përqendruar dhe në parashikimin e faktorëve që ndikojnë likuiditetin në tregun ndërbankar.

III.5.5.Tregu valutor dhe politika e Bankës së Shqipërisë për rregullimin e tij


III.5.5.1 Kursi i këmbimit

Gjatë vitit 2001, leku është mbiçmuar në këmbimin me valutat kryesore që tregtohen në tregun e brendshëm valutor. Faktorët që kanë ndikuar në këtë ecuri të lekut janë :

- diferenca pozitive e normave të interesit që ofrojnë investimet në lekë krahasuar me ato në valutë;
- prezantimi fizik i njësisë monetare europiane, euro, dhe ndikimi i këtij procesi në rritjen e ofertës së njësive monetare kombëtare europiane, të cilat u zëvendësuan;
- ruajtja e parametrave monetarë dhe fiskalë në nivelet e parashikuara;
- faktorë të tjerë, që gjatë vitit kanë ndikuar në raportet e eksport-importeve shqiptare siç mund të jenë faktorët sezonalë, kriza në FYROM, kriza energjitike në vend etj.;
- dërgesat e larta te emigrantëve.

Lidhur me faktorin e parë theksojmë se viti i kaluar ka shënuar një rënie të vazhdueshme të normave të interesit në tregjet ndërkombëtare financiare, në kushtet e hyrjes së ekonomive kryesore botërore në një fazë ngadalësimi të ndjeshëm të rritjes ekonomike. Ulja e normave të interesit për investimet në valutë, ka qenë më e shpejtë se ritmi i ndryshimit të tyre për investimet në lekë, **veçanërisht në pjesën e parë të vitit kur ato kanë lëvizur në të njëjtin kah.** Në këtë mënyrë, kthimi më i lartë ka forcuar tërheqjen e publikut drejt investimeve në lekë, duke ndikuar në rritjen e kërkesës për njësinë monetare kombëtare.

Grafik III-28: Kursi i këmbimit usd/lek – dem/lek për vitin 2001.



Prezantimi fizik i euros ishte faktori më i rëndësishëm që ndikoi vlerën e jashtme të lekut në periudhën e fundvitit të kaluar. Afrimi i 1 janarit 2002, u shoqërua me rritje të ofertës së njësive monetare europiane si marka gjermane, lireta italiane

apo dhrahmia greke, në tregun e brendshëm të këmbimit. Tendenca e fortë për mbiçmimin e lekut, në periudhën nëntor-dhjetor 2001, si edhe zhvillimet e përshkruara në paragrafin më sipër, dëshmojnë se shitja e këtyre valutave është kryer kryesisht kundrejt lekut. Për të përballuar presionin për mbiçmimin e vlerës së jashtme të lekut në fund të vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimit duke blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë, në llogari.

Stabiliteti i kursit të këmbimit të lekut, edhe gjatë ngjarjeve politike të cilat në të kaluarën kanë patur efekt në ecurinë e tij (përmendim zgjedhjet politike), dëshmon për një rritje të qëndrueshmërisë së tregut shkaktuar kryesisht nga rritja e konkurrencës, rritja e aktivitetit si edhe një politikë e përgjegjshme në sferën monetare dhe fiskale gjatë këtyre periudhave.

Ecuria e kursit të këmbimit të lekut, në periudha të caktuara gjatë vitit, është ndikuar edhe nga faktorë të tjerë të një natyre të përkohshme. Veçojmë faktorët sezonalë që lidhen me ciklin e prodhimit vendas, me flukset e emigrantëve etj.. Gjatë vitit të kaluar përmendim edhe rastin e situatës së vështirë të krijuar në FYROM. Këto zhvillime, mund të kenë krijuar kushte më të favorshme për eksportin e prodhimit shqiptar si një treg alternativ duke ndikuar në kursin e këmbimit të lekut. Gjithashtu, kriza energjitike mund të ketë shërbyer si element frenues i importeve për produkte të caktuara, duke reduktuar kërkesën për valutë.

Gjatë vitit të kaluar, aktiviteti i këmbimit në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore ka shfaqur qëndrueshmëri. Është rritur numri i operatorëve të licencuar që veprojnë si zyra të këmbimit valutor. Në fund të vitit të kaluar, numri i tyre ishte 28. Në bazë të raportimeve të operatorëve të licencuar, rezulton se vëllimi total i veprimeve të kryera prej tyre në blerje dhe shitje të valutës, kap vlerën 1,171.45 milionë dollarë amerikanë. Në mënyrë më të detajuar, vëllimi i aktivitetit valutor sipas tipit të transaksionit dhe operatorit, jepet në tabelën më poshtë:

Tabelë III-13: Transaksionet valutore gjatë vitit 2001.

	Blerje	Shitje	Pozicioni
	(1)	(2)	(1) - (2)
Bankat	472.29	475.59	-3.3
Zyrat e këmbimit	112.79	110.78	2.01
Totali	585.08	586.37	-1.29

Box III-5: Tregu valutor jozyrtar.

Tregu valutor në Shqipëri përbëhet nga dy elemente: tregu zyrtar dhe tregu jozyrtar. Në tregun zyrtar përfshihen operatorët e licencuar për të ushtruar veprimtari valutore.

Në tregun jozyrtar përfshihen një grup individësh, të cilët kryejnë këmbime valutore, por që janë të palicencuar. Si të tillë ata nuk i nënshtrohen zbatimit të asnjë rregulli, që ka miratuar Banka e Shqipërisë për tregun valutor, si edhe nuk raportojnë. Në gjuhën e përditshme këta individë quhen "kambistë të lirë". Ata veprojnë në mënyrë të dukshme që prej fillimit të viteve '90 dhe përgjithësisht janë të vendosur në qendër të Tiranës, pranë godinës së Bankës së Shqipërisë.

Midis këtyre dy tregjeve ose dy grupeve të operatorëve qëndrojnë bizneset dhe individët, të cilët këmbajnë monedhat për nevoja të përditshme, për nevoja investimi apo kursimi. Shkalla e përdorimit të të dy përbërësve të tregut valutor është e ndryshme.

Tre janë tiparet dalluese të tregut jozyrtar:

1. **Kosto e ulët.** Kryerja e transaksioneve në këtë treg ka një kosto më të ulët për shkak të kurseve më të favorshme që ofron në krahasim me operatorët zyrtarë.
2. **Shpejtësi më të lartë veprimi.** Veprimi i këmbimit kryhet menjëherë gjë që kursen kohën duke reduktuar më tepër koston e transaksionit.
3. **Likuiditet më i lartë.** Tregu jozyrtar është mjaft likuid dhe në çdo kohë mund të këmbesh çdo lloj shume (shuma të mëdha apo të vogla) dhe në çdo lloj monedhe. Tregu jozyrtar të ofron mundësinë e këmbimit edhe për monedha të konsideruara si të rralla.


Këto tre tipare rrisin eficiencën e këtij tregu dhe e bëjnë atë mjaft konkurrues. Për këto arsye, këmbimi i monedhave në tregun e lirë preferohet nga 39.6 për qind e operatorëve të tjerë të tregut valutor. Madhësia e këtij tregu, në terma të sasisë së valutës që qarkullon, është e konsiderueshme. Gjatë vitit 2001, në tregun jozyrtar janë kryer mesatarisht 1032 transaksione me një volum total mesatar prej afro 2.1 miliardë dollarësh amerikanë, kundrejt afro 1.2 miliardë dollarëve amerikanë, që kryejnë në një vit, bankat tregtare dhe zyrat e këmbimit valutor. Rreth 39.6 për qind e operatorëve kanë preferuar të operojnë me tregun jozyrtar gjatë vitit 2001, pothuajse në të njëjtën masë sa edhe një vit më parë (39 për qind). Kështu, në tregun jozyrtar vlerësohet të kryhen rreth 1.75 herë më shumë transaksione se në tregun zyrtar.

Krahasuar me një vit më parë vërehet një lloj reduktimi në numrin e transaksioneve dhe rritje në vlerën mesatare të transaksioneve. Ndërsa volumi total i qarkullimit të valutës ka rënë me

Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore, në vitin 2001, ka vazhduar të ketë një rol të rëndësishëm. Në përgjithësi, të intervistuarit janë shprehur kundër vendimit për mbylljen e këtij tregu me arsyetimin kryesor komoditetin që ai krijon në transaksionet valutore. Ky rezultat konfirmon konkluzionin e vrojtimit të bërë në vitin 2000, ku thuhet që tregu nuk duhet të mbyllet me masa administrative dhe në mënyrë të menjëhershme, por duhet synuar në uljen e efikasitetit të tij. Mbyllja administrative mund të mos sjellë zhdukjen e aktivitetit të tij pasi tregu mund të zhvendoset në zona apo në forma jo aq të dukshme sa sot. Në këtë pikëpamje është strategji e përshtatshme ajo e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë për të nxitur licencimin e kambistëve të lirë. Më tepër fushatë në këtë drejtim nga ana e Bankës së Shqipërisë do të ndihmonte në shpejtimin e procesit të mbylljes së tregut. Nga ana tjetër, fakti që po vërehet një rritje e pavarësisë në zhvillimin e aktivitetit të tregut zyrtar krahasuar me atë jozyrtar, nënkupton që masat direkte kundër tregut jozyrtar do të ishin të efektshme në drejtim të ndërprerjes së burimit të furnizimit të këtij tregu me valutë si dhe pasi të jetë zbehur në masë të konsiderueshme leverdia ekonomike e tij.

Duke përjashtuar transaksionet e kryera nga Banka e Shqipërisë në fund të vitit, theksojmë se pjesëmarrja e institucionit tonë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore është kufizuar në veprimet që janë kryer me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë si dhe për të plotësuar një pjesë të nevojave për valutë të Kooperatës Elektroenergjitike Shqiptare.

Grafik III-29: Kursi i këmbimit usd/lek dhe euro/lek për vitin 2001.



Nën ndikimin e faktorëve të mësipërm, raporti usd/lek, i cili në fillim të vitit është çelur në nivelin 143.0, është mbyllur në fund të tij në nivelin 136.80. Mbiçmimi i lekut, i shprehur në vlerë relative, është 4.3 për qind. Kundrejt euros, leku është çelur në fillim të vitit në nivelin 131.4, për t'u mbyllur në fund të tij në nivelin 118.5. Mbiçmimi i lekut, i shprehur në vlerë relative është 10.9 për qind. (Grafiku III-29.)

Box III-6 Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit.

Qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, e matur me devijimet standarde, dëshmohej nga rënia e luhatshmërisë së tij në periudhat kohore. Kështu, ndërsa devijimi standard ndaj një dollari, në periudhën janar 1999-dhjetor 2001, ishte 6.6, ky tregues ka rënë në 3.7 në periudhën janar 2000-dhjetor 2001. Kjo mund të interpretohet si një rënie, gati 100 për qind, e luhatshmërisë së kursit të këmbimit ose e fuqizimit të qëndrueshmërisë së tij në raport me dollarin. E njëjta tendencë pasqyrohet dhe në kursin e këmbimit të lekut në raport me euron. Shkalla e paqëndrueshmërisë duket të ketë qenë më e lartë pas vitit 1999, kur monedha e re nuk ekzistonte fizikisht, ku devijimi standard ishte 9.7 (periudha janar 1999-dhjetor 2001). Pas vitit 2000, leku është paraqitur më i qëndrueshëm në këmbimin e tij me këtë monedhë. Devijimi standard për këtë periudhë (janar 2000-dhjetor 2001) arriti në 3.9. Burimi: Vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Në raport me dollarin amerikan, kursi i këmbimit të tregut në fillim të vitit (sipas kurseve mesatare mujore) ishte 141.74 lek/usd. Monedha kombëtare vazhdoi të humbasë në vlerën e saj ndaj dollarit deri në muajin qershor, kur kursi mesatar i këmbimit u ngjiti në 148.55 lek/usd, periudhë pas së cilës leku filloi të fitojë pikë ndaj dollarit. Në fund të vitit, kursi i këmbimit në raport me dollarin ra në 137.04 lek/usd. Megjithë periudhat zhvlerësuese të lekut në raport me dollarin, të shënuara gati gjatë gjithë gjysmës së parë të vitit, tendenca vjetore mbizotëruese ishte vlerësimi i tij. Vlerësimi mesatar mujor ishte 0.3 për qind, ndërsa në muajin dhjetor në raport me muajin e parë të vitit, shkalla e vlerësimit ishte 3.3 për qind.

Në raport me monedhën e re europiane, euro, tendencat vlerësuese ishin mbizotëruese gati gjatë gjithë vitit. Norma mesatare mujore e vlerësimit ndaj euros ishte 0.77 për qind, ndërsa në fund të vitit vlerësimi arriti në 8.3 për qind, në raport me kursin e këmbimit të muajit janar. Lëvizjet më të rëndësishme në treg u manifestuan sidomos gjatë muajve të fundit të vitit, kur filloi procesi i zëvendësimit fizik të monedhave përbërëse të euros nga sistemi bankar.

Gjatë vitit të kaluar, euro është nënçmuar kundrejt dollarit amerikan në masën 7.2 për qind. Si rezultat, efekti neto i mbiçmimit të lekut ndaj valutave kryesore, në sajë të rritjes së ofertës, është 3.7 për qind.

III.6. TREGU I KAPITALEVE

Viti 2001 shënoi vitin e dytë rresht që në sesionet e Bursës së Tiranës, nuk regjistrohet asnjë transaksion i kryer (apo i ekzekutuar) në letrat me vlerë, objekt kuotimi në të.

Po kështu, gjatë vitit 2001 nuk u realizua shkëputja e Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe themelimi i saj si ent i pavarur si dhe nuk u kuotua ndonjë shoqëri aksionere. Tregjet e kapitaleve janë një ndër fushat ku sistemi financiar shqiptar njihet mangësi të theksuara duke kufizuar përveç të tjerave dhe aftësinë e shoqërive shqiptare për financim.

III.6.1. Tregu i letrave me vlerë

III.6.1.1. Bonot e thesarit

Tregu sekondar i bonove të thesarit në Bursën e Tiranës vazhdon të mos funksionojë për të njëjtat arsye si dhe gjatë viteve të kaluara, si:

- ekzistenca e alternativës së tregut sekondar për shitjen dhe blerjen direkte të bonove të thesarit midis bankave, jashtë Bursës së Tiranës, pavarësisht se rregullorja mbi procedurën e tregtimit në Bursën e Tiranës lehtëson dhe e thjeshton shumë procedurën e tregtimit të bonove të thesarit nga bankat;
- dominimi i pronësisë së bonove të thesarit nga një subjekt i vetëm, siç është Banka e Kursimeve, që natyrshëm do të sjellë probleme lidhur me kërkesën apo ofertën në treg për bono thesari;
- moskryerja e transaksioneve nga ana e subjekteve jobanka. Pavarësisht faktit të licencimit nga Komisioni i Letrave me Vlerë, të shoqërive private për të operuar si *dealer*, këto shoqëri ende nuk janë paraqitur në Bursën e Tiranës për të ekzekutuar ndonjë transaksion gjatë vitit 2001.

III.6.1.2. Aksionet

Në Bursën e Tiranës dhe gjatë vitit 2001 nuk u listua asnjë shoqëri aksionere. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i:

1. mospërbushjes së kriterëve cilësore të kuotimit në bursë, të tilla si: aftësi të spikatura në administrim dhe prodhim raportesh financiare cilësore e transparente;
2. mosekzistencës, në shumë, raste të një pozite të shëndoshë financiare të ndërmarrjeve;
3. mosinteresimit faktik të shoqërive aksionere private për të listuar aksionet e tyre në listën zyrtare të Bursës së Tiranës dhe rrjedhimisht, i mosdëshirës së tyre për t'u kthyer në shoqëri aksionere publike e për të ngritur kapital nëpërmjet Bursës;
4. mosofrimi nga shteti i ndonjë shoqërie aksionere për privatizim nëpërmjet ofertës publike. Qeveria ende nuk ka shprehur interes për privatizimin e pjesës së mbetur të AMC-së me ofertë publike. Si dhe gjatë vitit 2001, nuk u krye privatizimi i Bankës së Kursimeve apo dhe i ALBTELEKOM-it.

III.6.1.3. Obligacionet qeveritare

Lidhur me obligacionet qeveritare, viti 2001 përbën vitin e katërt që kur nuk ekzekutohen transaksione ne Bursën e Tiranës lidhur me këtë instrument. Nëse për vitet 1998, 1999 dhe 2000 shkak i një mungese të tillë kanë qenë termat e pafavorshëm të tregtimit të tyre, për vitin 2001 shkak kryesor i një mungese të tillë ka qenë eliminimi dhe shuarja e këtij instrumenti, pasi në mars të vitit 2001, këto obligacione janë rishlyer përfundimisht nga Qeveria, duke mos ekzistuar më në asnjë portofol.

III.6.2. Ngjarja më e rëndësishme e vitit²⁴⁾

Ngjarja më e rëndësishme për vitin 2001 lidhur me Bursën e Tiranës ishte miratimi nga Kuvendi i ndryshimeve dhe i shtesave në ligjin nr. 8080, datë 01.03.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshime këto që i hapën përfundimisht rrugën ligjore shkëputjes së Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe themelimin e saj si institucion i pavarur.

Gjatë këtij viti vëmendja u përqendrua në vazhdimin e **Fushatës Marketing të Bursës së Tiranës**, gjë që u realizua nëpërmjet një sërë botimesh; organizimit të seminareve me bizneset si dhe kontaktimit të bizneseve me mundësi për t’u listuar.

²⁴ Për më shumë hollësi shihni Box III-7.

Box III-7: Ngjarjet Kryesore 2001

- | | |
|--|--|
| ➤ Legjislacioni
- Miratohen shtesat dhe ndryshimet në ligjin nr. 8080, datë.01.03.1996, “Për letrat me vlerë”. | Mars 2001 |
| ➤ Fushata marketing
- Seminar me biznesin:
“ <i>Avantazhet praktike të kuotimit në Bursën e Tiranës. Hapat proceduralë të kuotimit në Bursën e Tiranës</i> ”. | Shkurt 2001 |
| ➤ Studime & Projekte
- Përfundon Studimi i Fizibilitetit të Bursës së Tiranës (versioni shqip)
- Përfundon Studimi i Fizibilitetit te Bursës së Tiranës (versioni anglisht)
- Përgatitet materiali (studim teknik plus projekt marrëveshje) mbi tregun primar të bonove të thesarit për subjektet fizike, juridike dhe jobanka. | Maj 2001
Korrik 2001
Mars 2001 |
| ➤ Publikimet
- Botohet broshura: “ <i>Bursa e Tiranës dhe Shoqëritë Aksionere</i> ”.
- Botohet broshura: “ <i>Kriteret e Listimit në Bursën e Tiranës</i> ”.
- Botohet analiza vrojtuese “ Biznesi shqiptar përkundrejt Bursës së Tiranës (versioni shqip).
- Botohet analiza vrojtuese “ Biznesi shqiptar përkundrejt Bursës së Tiranës (versioni anglisht). | Shkurt 2001
Shkurt 2001
Maj 2001
Tetor 2001 |

KAPITULLI IV – MBIKËQYRJA BANKARE

IV.1. LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATOR

IV.1.1. Licencimi

Gjatë vitit 2001 i është dhënë miratimi paraprak për të kryer veprimtari bankare Bankës Tregtare të Kuvaitit (të propozuar). Kjo bankë është në procesin e formimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit që do të paraqisë për t'u pajisur me licencën që të fillojë të veprojë si bankë. Numri i bankave që veprojnë në Shqipëri, për vitin 2001 ka mbetur 13, por është shtuar numri i degëve të këtyre bankave brenda vendit, i cili përbën një zhvillim cilësor për sistemin bankar shqiptar.

Tabelë IV-1: Shpërndarje gjeografike e rrjetit të sistemit bankar shqiptar.

Bankat	
1. Banka e Kursimeve	Berat, Kuçovë, Çorovodë, Bilisht, Burrel, Durrës, Elbasan, Gramsh, Peqin, Fier, Ballsh, Gjirokastrë, Tepelenë, Kavajë, Korçë, Ersekë, Krujë, Kukës, Krumë, Laç, Rrëshen, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Përmet, Peshkopi, Bulqizë, Pogradec, Sarandë, Delvinë, Shkodër, Koplik, Pukë, Bajram Curri, Tiranë, Vlorë
2. Banka Italo Shqiptare	Tiranë, Durrës
3. Banka Arabo Shqiptare Islamike	Shkodër
4. Banka Kombëtare Tregtare	Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Lushnjë, Gjirokastrë
5. Banka Dardania	
6. Banka Tirana	Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Gjirokastrë
7. Banka Kombëtare Greke – dega Tiranë	Durrës, Korçë, Tiranë
8. Banka Tregtare Ndërkombëtare	Tiranë
9. Banka Alfa – dega Tiranë	Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë
10. Banka Amerikane e Shqipërisë	Durrës
11. Banka Fefad	Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër
12. Banka e Parë e Investimeve – dega Tiranë	
13. Banka Tregtare e Greqisë	

Mbështetur në kuadrin rregullativ, të miratuar për licencimin e subjekteve financiare jobanka në Republikën e Shqipërisë, janë licencuar si subjekte financiar jobanka: shoqëria Alba-Post (Posta Shqiptare) Sh.a. dhe “Credins” Sh.a.

Posta Shqiptare Sh.a. është licencuar nga Banka e Shqipërisë si “Subjekt financiar jobankë” për të ushtruar veprimtarinë financiare të ofrimit të shërbimeve të arkëtimit dhe të pagesave. Ky veprim do të kryhet vetëm në zyrat e saj në Tiranë.

Gjithashtu, më 13.06.2001, shoqëria “Credins” Sh.a. është licencuar nga Banka e Shqipërisë si “Subjekt financiar jobankë” për të ushtruar veprimtaritë financiare: të kredidhënies; të shërbimit të pagesave dhe arkëtimit; të ndërmjetësimit për transaksione monetare (duke përfshirë valutat); të ofrimit të garancive etj..

Subjekte të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë janë dhe zyrat e këmbimeve valutore, të cilat licencohen dhe veprojnë mbështetur në rregulloren “Për veprimtarinë valutore” dhe udhëzimet e saj. Gjatë vitit 2001, janë licencuar edhe 18 zyra të këmbimeve valutore të reja.

Gjatë vitit 2001 në Shqipëri kanë patur licencë për të vepruar subjektet e mëposhtme:

Banka tregtare dhe degë të bankave të huaja - 13.
Zyra këmbimi valutor - 38.
Subjekte financiare jobanka – 4.

IV.1.2. Shoqëritë e kursim-kreditit

Gjatë vitit 2001 u miratua ligji i ri, nr. 8782, datë 03.05.01 “Për shoqëritë e kursim-kredive”, i cili është një variant i përmirësuar i ligjit të mëparshëm. Përmirësimet kryesore kishin të bënin me përcaktimin më të qartë të pozicionit të Bankës së Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës dhe të pozicionit të unionit të shoqërive të kursim-kreditit, në lidhje me asistencën teknike, me financimin dhe me mbikëqyrjen e anëtarëve të tij. Gjatë vitit 2001, numri i shoqërive të kursim-kreditit të krijuara arriti në 100 me një tendencë për rritje të mëtejshme të tyre si në zonat rurale ashtu dhe në zonat urbane. Banka e Shqipërisë është në procesin e përfundimit të dy projektregulloreve të rëndësishme, “Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” dhe “Për normat e mbikëqyrjes të shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”.

IV.1.3. Kuadri rregullator mbikëqyrës

Gjatë viti 2001, rregullimet bankare kanë synuar të rishikojnë të gjithë kuadrin rregullativ mbikëqyrës. Rishikimi i kuadrit rregullativ mbikëqyrës kishte të bënte me dy aspekte kryesore, e para rishikimin e përgjithshëm të disa rregulloreve dhe e dyta, përmirësimin kuptimor të disa të tjerave.

Në këtë aspekt janë:

A) rishikuar në mënyrë të përgjithshme dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës:

- rregullorja “Për veprimtarinë valutore”, me vendimin nr. 12, datë 21.02.01;
- rregullorja “Për menaxhimin e riskut të kredisë”, me vendimin nr. 13, datë 21.01.01;
- rregullorja “Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare”, me vendimin nr. 42, datë 06.06.01;

B) përmirësuar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës:

1. udhëzimi “Për kapitalin regullator”, me vendimin nr. 40, datë 16.05.01;
2. rregullorja “Për risqet e mëdha”, me vendimin nr. 92, datë 05.12.01;
3. rregullorja “Për risqet e tregut”, me vendimin nr. 98, datë 19.12.01;

C) miratuar si plotësim i kuadrit rregullativ:

- udhëzimi “Për çertifikatat e depozitave” me vendimin 79, datë 03.10.01 të Këshillit Mbikëqyrës.

Hartimi i këtij udhëzimi u bë i nevojshëm në plotësim të “Manualit të Kontabilitetit bankar” për të disiplinuar, në një kuadër më të gjerë emetimin, përdorimin dhe kontabilitetin e çertifikatave të depozitave, si një produkt i ri bankar.

Banka e Shqipërisë, si autoriteti që do të licencojë dhe do të mbikëqyrë shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, është angazhuar në përgatitjen e akteve rregullative për këtë qëllim.

IV.2. ECURIA E SISTEMIT BANKAR

IV.2.1. Anët e forta dhe të dobëta të sistemit bankar shqiptar

Gjatë vitit 2001, sistemi bankar shfaqet me anët e tij të forta dhe të dobëta. Një analizë SWOT (strength, weaknesses, opportunities, threats) nxjerr në pah anët e forta, dobësitë, shanset dhe kërcënimet:

Anët e forta:

- Sistemi bankar shqiptar, i favorizuar nga një situatë makroekonomike e qëndrueshme dhe në përmirësim të vazhdueshëm mbart në vetvete potencial zhvillimi.
- Rrjeti bankar po zgjerohet gjithnjë e më shumë në formën e degëve, të agjencive, të zyrave të shërbimit bankar etj..
- Përmirësimi dhe shtrirja e teknologjisë së shërbimeve bankare.
- Struktura e sistemit bankar paraqitet në favor të kapitalit privat dhe sidomos të atij të huaj (procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve).

- Kapitalizimi i sistemit bankar paraqitet në nivele të kënaqshme.
- Hyrja e institucioneve të tjera financiare në treg (institucionet jobanka dhe institucionet e mikrokredisë).
- Rezultati financiar i sistemit paraqitet pozitiv duke na dhënë imazhet e një sistemi efikas.
- Kreditimi i vazhdueshëm i klientelës nga bankat e sistemit dhe ruajtja e cilësisë së portofolit të kredive.
- Likuiditeti paraqitet në nivele të kënaqshme për aq kohë sa aktivet e sistemit do të jenë të përqendruara në bonot e thesarit dhe në kredidhënie afatshkurtër.

Anët e dobëta:

- Sistemi vuan nga mungesa e një sistemi të zhvilluar pagesash.
- Konkurrenca është akoma e dobët dhe bankat prezantohen akoma joagresive në treg (të ngadalta në shtrirjen në aktivitete me rrezik dhe në prezantimin e një game më të gjerë produktesh).
- Dominimi i një banke në sistem, dobëson akoma më tepër konkurrencën.
- Mungon një treg ndërbankar i zhvilluar.
- Mungojnë politika të mirëzhvilluara të kredidhënies dhe plane strategjike zhvillimi të vetë bankave të sistemit.
- Ka shmangie të disa bankave nga planbizneset e tyre.
- Mungon një kuadër ligjor eficient në vend, që jep ndikimin e vet edhe në sistem.
- Bankat vazhdojnë të ndjehen të sigurt në vendosjet pranë bankave të huaja dhe investimet në bono thesari, duke mos u shtrirë shumë në aktivitetin e kredidhënies.
- Zhvillimi ekonomik i vendit nuk dikton akoma nevojën për hapjen e bankave të specializuara, të investimit, të zhvillimit apo të atyre kooperativë.
- Situata e rënduar në rajon (konflikti i shpërthyer në FYROM, kriza financiare në Turqi).

Shanset:

- Prania e kapitalit të huaj në sistemin bankar sjell kultura të reja në administrimin e bankave si dhe ka rëndësinë e saj për vetë konceptet e reja dhe praktikat që këto banka të huaja prezantojnë.
- Konkurrenca midis bankave të sistemit në fillesat e saj do t'i japë shtysë bankave në perspektivën e tyre nga njëra anë për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e shërbimeve bankare, për përmirësimin e cilësisë së tyre dhe, në anën tjetër, për gjetjen e rrugëve të mundshme të uljes së kostos.

Kërcënimet:

- Rreziku i vendit, ekonomik dhe politik.
- Rritja e shpejtë e kërkesave të publikut për kredi (sidomos afatgjatë).
- Mungesa e ligjit për sigurimin e depozitave.
- Mosfunksionimi i autoritetit përgjegjës për luftën kundër pastrimit të parave.

IV.2.2. Treguesit e sistemit bankar shqiptar

Sistemi bankar shqiptar vazhdon të mbetet segmenti më i madh dhe më i zhvilluar i tregut financiar në vend. Ai paraqitet edhe gjatë vitit 2001 me të njëjtën strukturë si dhe në vitin 2000. Në vend vazhdojnë të operojnë 13 banka ndër të cilat 1 bankë me kapital shtetëror (banka më e madhe e sistemit), 2 banka me kapital të përbashkët dhe 10 banka me kapital privat (përfshirë 3 degë të bankave të huaja).

Gjendja e sistemit bankar paraqitet e mirë dhe me tendencë në përmirësim pothuajse në të gjithë treguesit. Sistemi bankar është në vitin e tretë të tij që paraqitet me rezultat financiar pozitiv. Fitimi i realizuar në fundvitin 2001 rezultoi 4,3 miliardë lekë ose rreth 0,7 për qind të PBB-së. Në fundvitin 2001 janë vetëm dy banka që paraqiten me rezultat financiar negativ.

Tabelë IV-2: Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, rezultati financiar.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Totali i të ardhurave	39.1	31.0	29.2
Totali i shpenzimeve	37.9	25.7	24.9
Rezultati neto (fitimi)	1.2	5.3	4.3

Të ardhurat neto nga aktivitetet kryesore të sistemit bankar rezultojnë 11 miliardë lekë kundrejt 9,9 miliardë lekëve që rezultojnë në fundvitin 2000. Nga këto të ardhura rreth 78,6 për qind e përbëjnë të ardhurat neto nga interesat, të cilat vazhdojnë të japin dhe kontributin kryesor në rezultatin financiar, ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave rrjedh kryesisht nga komisionet dhe veprimtaria valutore.

Tabelë IV-3: Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet kryesore, rezultati neto.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Të ardhurat nga veprimtaria kryesore	37.5	27.0	26.1
Shpenzime për veprimtarinë kryesore	31.1	17.1	15.0
Rezultati neto	6.4	9.9	11.1
Nga kjo: rezultati neto nga interesat	5.2	7.7	8.7

Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë për sistemin bankar paraqiten rreth 800 milionë lekë më të larta se fundi i vitit 2000. Këto shpenzime përbëjnë rreth 19,3 për qind të shpenzimeve financiare dhe janë kryesisht shpenzime personeli

dhe shpenzime të tjera të nevojshme për kryerjen e aktivitetit bankar. Rritja në shpenzimet e veprimtarisë i dedikohet zgjerimit të rrjetit bankar – hapjes së degëve dhe të agjencive të reja bankare, si dhe përmirësimeve dhe rritjes së nivelit të teknologjisë dhe informacionit etj..

Tabelë IV-4: Raporti i efikasitetit.

Treguesi në milione lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	3161.7	3967.6	4796.8
Te ardhurat bruto te veprimtarise	4795.3	11514.0	10367.9
Raporti i efikasitetit (në %)	65.9	34.5	46.3

Tabelë IV-5: Tregues të rentabilitetit në përqindje (viti 2001).

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G1	G3
ROA*	1.5	1.7	0.1	1.3
ROE**	21.6	58.8	0.6	11.4
Të ardhurat neto nga interesat / aktive mesatare gjithsej	3.0	2.6	4.2	3.5
Shpenzime të veprimtarisë / aktive mesatare gjithsej	1.6	1.0	2.7	2.7
Shpenzime për provigjone / aktive mesatare gjithsej	0.2	-0.1	3.1	0.3

Shënim: *Kthyeshmëria nga aktivet.

**Kthyeshmëria nga fondet e veta.

Tabelë IV-6: Tregues të rentabilitetit, ecuria në vite.

Treguesi në %	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
ROA	0.5	2.1	1.5
ROE	15.7	20.6	21.6

Aktivitetet e sistemit bankar janë rritur për 17,6 për qind ose në vlerë absolute për 47,6 miliardë lekë. Një ndikim të ndjeshëm në rritjen e aktiveve kanë dhënë bankat me kapital privat dhe të përbashkët. Rritja e aktiveve të këtyre bankave, në krahasim me vitin 2000 rezultoi 34,5 miliardë lekë dhe është rezultat i rritjes së besueshmërisë të këto banka e, për rrjedhojë, e afrimit pranë tyre të një numri më të madh klientësh, si dhe e shtrirjes së aktivitetit të tyre edhe në rrethe të tjera.

Tabelë IV-7: Totali i aktiveve, ecuria në vite.

Treguesi në miliardë lekë	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5
Në % ndaj PBB	49.2	50.2	53.5

Pavarësisht kontributit në rritje të bankave private në sistem, peshën kryesore në aktivitetet e sistemit vazhdon ta ketë Banka e Kursimeve.

Banka e Kursimeve, si përfaqësuese e vetme e grupit të bankave shtetërore që vazhdon të evidentojë pozicionin dominues në sistem (rreth 59 për qind të aktiveve të sistemit nga 64,8 për qind në vitin 2000) me monopolin e grumbullimit

të depozitave dhe investimeve në bono thesari, po konkurrohet nga bankat private, të cilat po rrisin në mënyrë të ndjeshme peshën e tyre në treg duke u shtrirë më shumë në aktivitete me rrezik dhe më fitimprurëse. Kështu, si një paradoks përkundrejt bankës më të madhe të sistemit, janë bankat private që po investojnë gati trefishin e aktiveve me rrezik të kësaj banke.

Tabelë IV-8: Pësia e grupeve bankare sipas disa treguesve ndaj totalit të sistemit bankar (në përqindje).

Treguesi	G1		G2		G3	
	2000	2001	2000	2001	2000	2001
1. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	69.1	63.5	4.6	4.8	26.3	31.7
2. Kapitali aksioner	27.4	20.9	19.7	18.6	52.9	60.5
3. Kredia neto	8.7	3.2	40.6	22.8	50.1	74.0
4. Bono thesari	84.2	81.2	1.0	0.9	14.8	17.9
5. Vendosi në banka	37.9	40.0	9.9	10.5	52.2	49.5

Viti 2001 evidenton një ecuri të mirë edhe në drejtim të aktivitetit kreditues. Teprica e kredisë në këtë vit është rritur për 10,7 miliardë lekë dhe është përqendruar kryesisht në kredi afatshkurtër (me një rritje prej 140,1 për qind, krahasuar me fundvitin 2000). Megjithatë, në aktivitetin kreditues të disa bankave të veçanta evidentohen përkeqësime në cilësinë e portofolit të kredisë, si sistem bankar treguesi i kredive me probleme ndaj portofolit të kredisë është në nivelin e kënaqshëm, 6,9 për qind.

Tabelë IV-9: Tregues të portofolit të kredive (në përqindje ndaj kredive të klasifikuara).

Treguesi	Sistemi bankar		G1		G2		G3	
	2000	2001	2000	2001	2000	2001	2000	2001
1. Kredite e klasifikuara*	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
- Standarde	59.1	88.3	12.7	72.3	69.3	66.4	90.7	96.0
- në ndjekje	7.4	4.6	1.5	20.3	16.0	14.4	5.3	0.8
- nënstandarde	3.3	4.0	4.9	0.6	4.0	14.0	1.4	1.1
- të dyshimta	4.1	1.7	2.7	0.2	9.1	4.8	1.2	0.8
- të humbura	26.0	1.3	78.1	6.6	1.6	0.3	2.0	1.3
2. Mbulimi me provigjone	30.1	4.4	80.7	8.5	8.5	7.4	5.1	3.3

Shënim: * Kreditë standarde dhe ato në ndjekje klasifikohen si kredi të rregullta, ndërkohë që tre grupet e tjera të kredive trajtohen si kredi me probleme.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar rezulton 35,3 për qind nga 41,9 për qind në fundvitin 2000 dhe 8,2 për qind në fundvitin '99. Kapitalizimi është i lartë edhe në grupet e veçanta të bankave dhe konkretisht: 29,9 për qind për grupin e bankave shtetërore, 40,4 për qind për grupin e bankave me kapital të përbashkët dhe 35,7 për qind për grupin e bankave të tjera.

Në këto raporte të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit (norma minimale e mjaftueshmërisë është 12 për qind), krahas niveleve të larta të kapitalit, ka ndikuar ndjeshëm edhe struktura e aktiveve të sistemit bankar klasifikuar sipas

rrezikut. Sistemi bankar vazhdon të evidentojë një nivel të lartë të investimeve në aktive pa rrezik apo me rrezik të ulët. Çdo ndryshim në strukturën e aktiveve në favor të aktiveve me rrezik të lartë, do të përmirësonte ndjeshëm raportin duke ndikuar njëkohësisht edhe në rritjen e fitimit pa lënë mënjanë ndikimin në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, nëpërmjet një kreditimi më të lartë.

Tabelë IV-10: Struktura e aktiveve të klasifikuara sipas shkallës së rrezikut (në përqindje ndaj totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të klasifikuara sipas rrezikut).

Treguesi	Sistemi bankar	G1	G2	G3
Aktive pa rrezik	68.2	84.6	21.1	47.9
Aktive me rrezik të ulët	20.4	12.4	34.3	31.8
Aktive me rrezik të mesëm	1.8	0.2	13.6	2.5
Aktive me rrezik të lartë	9.6	2.8	31.0	17.8

Gjatë vitit 2001 sistemi bankar ka patur një gjendje të mirë likuiditeti, ndonëse për banka të veçanta dhe në periudha të caktuara janë paraqitur vështirësi në administrimin e likuiditetit. Mjaft tregues, që konsiderohen si matës të likuiditetit paraqiten në nivele të kënaqshme. Një raport mjaft i ulët i tepricës së kredisë neto ndaj totalit të aktiveve (8,5 për qind), i tepricës së kredisë neto ndaj depozitave mesatare (10,8 për qind) si dhe fakti që 55 për qind e totalit të kredive janë kredi afatshkurtra e përforcojnë më së miri konkluzionin e mësipërm.

Kështu, sistemi bankar shqiptar gjatë vitit 2001, i favorizuar dhe nga mjedisi ekonomik, evidentoi një gjendje relativisht të shëndetshme.

Tabelë IV-11: Tregues për sistemin bankar.

Bankat*	Nr.i degëve	Kapitali paguar / Totali i bilancit (%)	Totali i depozitave / Totali i bilancit (%)	Totali i kredive (neto) / Totali i bilancit (%)	Kredi me probleme / Totali i kredive (%)	Bonot thesari në % ndaj sistemit bankar
Grupi I						
1. Banka e Kursimeve	38	0.4	92.4	0.5	7.3	81.2
Grupi I						
2. Banka Italo Shqiptare	2 agjenci	10.5	76.0	37.0	19.2	0.9
3. Banka Arabo Shqiptare Islamike	1	63.4	36.0	6.3	0.0	0.0
Grupi III						
4. Banka Kombëtare Tregtare	101 agjenci	4.9	92.5	0.3	0.0	8.8
5. Banka Dardania		56.4	17.6	0.0	100.0	0.0
6. Banka Tirana	5	5.5	77.2	17.4	4.5	4.3
7. Banka Kombëtare Greke – dega Tiranë	3 agjenci	12.9	83.4	3.4	16.0	0.8
8. Banka Tregtare Ndërkombëtare	1	43.4	55.9	33.5	11.4	0.0
9. Banka Alfa – dega Tiranë	4	7.7	49.7	51.0	0.0	0.9
10. Banka Amerikane e Shqipërisë	1	3.8	92.4	13.1	6.1	1.7
11. Banka Fefad	61 agjenci	8.7	84.1	26.2	2.2	1.2
12. Banka e Parë e Investimeve – dega Tiranë		61.0	13.7	0.2	0.0	0.0
13. Banka Tregtare e Greqisë		48.6	55.2	54.0	0.0	0.2

* Ndarja e bankave në grupe bëhet sipas kriterit të pronësisë së kapitalit. Në grupin e parë përfshihen bankat me kapital tërësisht shtetëror, në grupin e dytë përfshihen bankat me kapital të përbashkët, vendas dhe të huaj, në grupin e tretë përfshihen bankat e tjera.

IV.3. INSPEKTIMET NË VEND

Inspektimi në vend i bankave është një pjesë shumë e rëndësishme e mbikëqyrjes bankare pasi bën vlerësimin e atyre fushave, të cilat nuk mund të vlerësohen nga mbikëqyrja nga jashtë (analiza off-site). Në mënyrë të veçantë, ai bën vlerësime të nivelit të drejtimit dhe të administrimit të bankës, të procedurave që ndiqen për identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rrezeve, sistemin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, inspektimet në vend luajnë një rol të rëndësishëm në saktësimin dhe në përmirësimin cilësor të të dhënave të raportuara në Bankën e Shqipërisë.

Inspektorët e mbikëqyrjes bankare e bazojnë punën e tyre në kontaktet me bankat e inspektuara. Këto kontakte janë shumë të rëndësishme për një zgjidhje pozitive të të gjitha problemeve të zbuluara gjatë ekzaminimit.

Realizimi i inspektimeve në vend është bërë në bazë të një plani, të miratuar që në fillim të vitit. Ai ka si synim kryerjen e inspektimeve të plota të të gjitha bankave gjatë vitit. Ky program është i shoqëruar edhe me inspektime të pjesshme për probleme të veçanta që kanë dalë gjatë vitit.

Gjatë vitit 2001, u realizuan 13 inspektime të plota dhe 10 të pjesshme.

Objektivat më të rëndësishëm të ekzaminimit në bankat e nivelit të dytë, kanë qenë:

- I. Kryerja nga bankat e një veprimtarie të sigurtë e të qëndrueshme.
- II. Identifikimi i bankave apo i veprimtarive bankare të veçanta, që kërkojnë vëmendjen e autoritetit të mbikëqyrjes.
- III. Plotësimi, miratimi dhe mbikëqyrja nga këshillat drejtues, i akteve të brendshme të veprimtarisë së bankës si: politika, procedura etj..

Në përgjithësi, gjendja në sistemin bankar, e vlerësuar nga ekzaminimet në vend, paraqitet e mirë, gjë e cila është një element shumë i rëndësishëm për mbështetjen e ekonomisë në zhvillimet e saj.

Disa nga karakteristikat kryesore që u vunë re në sistemin bankar gjatë vitit 2001 janë:

1. Një rritje e ndjeshme e aktiveve të disa bankave, gjë që tregon për një afrim më të madh të klientëve dhe për një politikë më agresive nga ana e bankave. Kjo rritje ka ardhur dhe si rezultat i zgjerimit të bankave me degë apo me agjenci të reja.
2. Plotësimi nga të gjitha bankat i kapitalit minimal të paguar në shumën 700 milionë lekë. Kjo është një garanci më e madhe për një sistem të shëndoshë bankar, aq më shumë në kushtet e zgjerimit të aktivitetit të tyre. Përgjithësisht, të gjithë aksionerët kanë qenë të gatshëm për plotësimin e kapitalit.
3. Ndryshime në strukturën e aktiveve të bilancit në disa banka, ku paraqitet në rritje zëri: “kredi për klientët” që tregon se bankat po fillojnë të dalin nga gjendja vrojtuese dhe pasive, duke u bërë më aktive në rritjen e ekonomisë së vendit. Përgjithësisht, zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar me një përkeqësim të portofolit të kredisë. Kjo ka ardhur nga disa shkaqe, ku do të veçonim si më kryesoret:
 - Fillimi i aktivitetit kreditues pa siguruar më parë një staf të përgatitur, për t’ju përgjigjur kërkesave të këtij sektori si dhe mungesa e eksperiencës për monitorimin e kredive.
 - Mosmbështetja në politika dhe procedura të plota e të sakta.
 - Ekzistenca e një tregu jo në nivelin e duhur për t’ju përgjigjur detyrimeve të një kredimarrjeje, të paedukuar akoma si duhet me parimet e ekonomisë së tregut.
 - Situata e pastabilizuar në disa sektorë jetikë të ekonomisë, si ai i energjitikës.

- Mosfunksionimi i aspekteve ligjore që kanë të bëjnë me procesin e kreditimit.
4. Ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si vendosje në bankat e tjera apo bono thesari. Bankat, në përputhje me operacionet, shërbimet dhe madhësinë e tyre, kanë patur nën kontroll risqet e normave të interesit (pavarësisht se nuk janë shumë të pranishme në ambjentin korent) apo të kursit të këmbimit, duke tentuar në mbajtjen e niveleve sa më të ulta të *GAP-it*, apo nivele *spread-i* optimale, dhe duke përmirësuar ndjeshëm në krahasim me një vit më parë administrimin e aktiv-pasiveve. Ka një progres në këtë fushë, duke futur metoda bashkëkohore për përgatitjen e një informacioni sa më të plotë dhe të shpejtë.
 5. Përgjithësisht, bankat kanë dalë me rezultat pozitiv dhe me fitim në rritje krahasuar me një vit më parë. Kjo, si rezultat i zgjerimit të tyre, i mbulimit të shpenzimeve të hapjes dhe përmirësimit të strukturës së aktiveve të bilancit me investime në zëra më fitimprurës. Trendi i të ardhurave paraqitet i qëndrueshëm.
 6. Drejtimi i lartë, në përgjithësi, ka reaguar pozitivisht ndaj problemeve të ngritura nga ekzaminimet e kryera, por nuk ka treguar kujdesin e duhur për:
 - përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës;
 - plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës;
 - zbatimin e planbiznesit të bankës.

Gjatë inspektimeve të kryera janë konstatuar gjetje, të cilat nuk janë në përputhje me praktikat e shëndosha bankare. Këto gjetje kanë qenë të natyrave të ndryshme si:

- Shkelje të ligjit për kontabilitetin. Mosmbajtja në monedhën vendase e llogarive të rezultatit financiar, moszbatim me korrektësi i Manualit të Kontabilitetit Bankar për regjistrimin në zëra jashtë bilancit të garancive të marra në formë pronësie si dhe mosregjistrimin si zëra jashtë bilancit të kufirit të lëvruar e të papërdorur për kreditë me kufi .
- Shkelje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neni 20. Në disa banka nuk funksionon komiteti i kontrollit apo njësia e kontrollit të brendshëm.
- Shkelje të kërkesave të ligjit: "Për shoqëritë tregtare", mbi mbajtjen e regjistrit të aksionerëve dhe regjistrimit të ndryshimeve në statut.
- Shkelje të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë si:
 - a) Klasifikimi i portofolit të kredive jo në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë”.
 - b) Llogaritje jo e saktë e pozicionit të hapur valutor si dhe tejkallim të kësaj norme të parashikuar në rregulloren përkatëse.

- c) Tejkalim të përqendrimit në një përfitues të vetëm (bankat jorezidente) mbi limitin e lejuar në rregulloren përkatëse.
- d) Emërimi dhe fillimi nga detyra e administratorëve në disa banka pa marrë më parë miratimin paraprak nga Banka e Shqipërisë.
- e) Dokumentacioni për kryerjen e transfertave nuk i përgjigjet kërkesave të rregullores "Për veprimtarinë valutore".

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, në varësi të shkeljeve të evidentuara, ka përcaktuar masat korrektuese ose ndëshkimore, mbështetur në dispozitat e ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Masat korrektuese dhe ndëshkimore që janë zbatuar në vitin 2001 janë:

- Rekomandime apo sugjerime për të korrigjuar parregullsitë e vogla.
- Kërkesa për paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të një programi masash për rregullimin e gjendjes së bankës, në rast të ndeshjes së parregullsive, duke përcaktuar edhe afatet përkatëse.
- Masa ndëshkuese ndaj administratorëve për shkeljet e konstatuara.

Bankat, në mbështetje të kërkesave dhe të rekomandimeve të dhëna në raportet e ekzaminimit (në krahasim me vitin e kaluar) i kanë kushtuar kujdes plotësimin të akteve të brendshme të tyre në të gjitha fushat e veçanërisht në veprimtarinë kredituese, në administrimin e të drejtave dhe të detyrimeve, në administrimin e rreziqeve të ndryshme etj..

Bankat po familjarizohen me nevojën e respektimit të ligjit, të akteve nënligjore dhe të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë. Këto krijojnë premisa, për zhvillimin e marrëdhënieve korrekte midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë.

KAPITULLI V – BILANCI KONTABËL I BANKËS SË SHQIPËRISË

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë:

Ne kemi audituar bilancin e Bankës së Shqipërisë ("Banka") më 31 dhjetor 2001 dhe 2000, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe pasqyrën e fluksit të parasë. Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të zbatojmë procedurat e auditimit për të dhënë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Një audit përfshin ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështetin shifrat dhe informacionet e tjera të pasqyrave financiare. Auditimi, gjithashtu, përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të parashkimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe jep një opinion të përgjithshëm mbi paraqitjen e pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2001 dhe 2000 dhe rezultatet e aktiviteteve të saj, ndryshimeve në kapitalin e vet dhe fluksit të parasë për fundin e vitit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNK") të modifikuara për parimet kontabël përgjithësisht të pranuar të aplikueshme për bankat qendrore.

Deloitte & Touche, Sh.p.k
Tirana, Albania

21 mars 2002

	Shënim No.	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
AKTIVET			
Aktive të huaja			
Ari	3	977	970
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	20,830	21,808
Depozita në bankat e huaja	5	36,794	57,094
Letra me vlerë	6	52,569	19,712
Aktive të tjera të huaja	7	645	196
Totali i aktiveve të huaja		111,815	99,780
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	32	69
Kredi tranzite	8	6,254	6,549
Kredi ndaj bankave vendase	9	473	-
Kredi ndaj qeverisë	10	2,710	9,429
Investime në letra me vlerë	11	70,437	72,117
Aktive të tjera vendase	12	3,906	2,408
Totali i aktiveve vendase		83,812	90,572
Totali i aktiveve		195,627	190,352
DETYRIMET			
Detyrime të huaja			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	13	20,494	22,883
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	14	7,537 8	7,894 31
Detyrime të tjera të huaja			
Totali i detyrimeve të huaja		28,039	30,808
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	15	121,334	101,409
Detyrime ndaj bankave vendase	16	31,220	32,571
Detyrime ndaj qeverisë	17	2,734	3,935
Detyrime të tjera vendase	18	155	110
Totali i detyrimeve vendase		155,443	138,025
KAPITALI I VET			
Kapitali themeltar		750	750
Rezerva ligjore		3,750	3,750
Rezerva e rivlerësimit	19	57	5,281
Rezerva të tjera	20	7,588	7,426
Fitimi i mbartur		-	4,312
Totali i kapitalit të vet		12,145	21,519
Totali i detyrimeve dhe kapitali i vet		195,627	190,352

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënim No.	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione		4,206	3,699
Shpenzime interesi dhe komisioni		<u>219</u>	<u>196</u>
Totali neto i interesave dhe komisioneve nga veprimet me jorezidentë		<u>3,987</u>	<u>3,503</u>
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	21	6,628	7,570
Shpenzime interesi dhe komisioni		<u>1,367</u>	<u>305</u>
Totali neto i interesave dhe komisioneve nga veprime me rezidentë		<u>5,261</u>	<u>7,265</u>
Të ardhura operative të tjera, neto	22	<u>254</u>	<u>77</u>
Totali neto i të ardhurave operative		<u>9,502</u>	<u>10,845</u>
Shpenzime të tjera jooperative			
Shpenzime personeli	23	249	180
Shpenzime amortizimi		105	90
Shpenzime amortizimi të shtypjes dhe të prerjes së parasë		154	59
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		<u>161</u>	<u>121</u>
Totali i shpenzimeve të tjera jooperative		<u>669</u>	<u>450</u>
FITIMI NETO		<u><u>8,833</u></u>	<u><u>10,395</u></u>

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

në (mln) Lekë	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
31 dhjetor 1999	750	3,750	2,917	7,407	2,233	17,057
Fitimi neto	-	-	-	-	10,395	10,395
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	1,036	-	-	1,036
Rivlerësimi i bonove të thesarit vëndase	-	-	191	-	-	191
Rivlerësimi i bonove të Thesarit Amerikan	-	-	17	-	-	17
Rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	1,143	-	-	1,143
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(23)	-	23	-
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	19	(8,339)	(8,320)
Gjendja më 31 dhjetor 2000	750	3,750	5,281	7,426	4,312	21,519
Fitimi neto	-	-	-	-	8,833	8,833
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe arit	-	-	(5,088)	-	-	(5,088)
Rivlerësimi i bonove të thesarit vëndase	-	-	(104)	-	-	(104)
Rivlerësimi i bonove të Thesarit Amerikan	-	-	(9)	-	-	(9)
Rimarrje e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(23)	-	23	-
Rritje e fondit të pensionit për investime	-	-	-	6	-	6
Shpërndarja e fitimit	-	-	-	156	(13,168)	(13,012)
Gjendja më 31 dhjetor 2001	750	3,750	57	7,588	-	12,145

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënim No.	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Fluksi i parasë nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		8,833	10,395
Zëra jomonetarë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		259	149
Ndryshime në aktivet operacionale			
(Rritja) në letra me vlerë të huaja		(32,867)	(5,904)
Ulja/(rritja) në depozita me FMN		978	(249)
(Rritja) në depozita me bankat e huaja > 3 muaj		(11,150)	(7,655)
(Rritja)/ulja në aktive të tjera të huaja		(209)	43
Ulja/(rritja) në letra me vlerë vendase		1,577	(30,988)
Ulja në kreditë tranzite		295	137
(Rritja) në kredi ndaj bankave vendase		(473)	-
Ulja në kredi ndaj qeverisë		6,719	22,829
(Rritja)/ulja në aktive të tjera vendase		(1,618)	917
Ndryshime në detyrimet operacionale			
(Ulje)/rritje në detyrimet ndaj FMN		(2,389)	1,449
(Ulje) në detyrimet ndaj institucioneve financiare jorezid.		(357)	(224)
(Ulje)/rritje në pasivet e huaja		(23)	12
(Ulje)/rritje në detyrimet ndaj bankave vendase		(1,351)	5,434
(Ulje)/rritje në detyrimet ndaj qeverisë		(1,201)	376
Rritje në pasive të tjera vëndase		45	43
		(32,932)	(3,236)
Efekti i rivlerësimit të kurseve të këmbimit në aktivet dhe pasivet operative		(5,088)	1,036
Paraja neto e përdorur në aktivitete operacionale		(38,020)	(2,200)
Fluksi nga investimet			
Blerja neto e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(139)	(54)
Fluksi i parasë prej financimit			
Shpërndarja e fitimit për qeverinë		(13,168)	(8,339)
Rritja në rezerva të tjera		162	19
Rritje në emetimin e parasë në qarkullim		22,000	21,000
Fluksi neto prej financimit		8,994	12,680
(Ulja)/rritja në para gjatë vitit		(29,165)	10,426
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	23	55,083	44,657
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	23	25,918	55,083

Shënimet mbi pasqyrat financiare janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Informacione të përgjithshme

Banka e Shqipërisë (“Banka”) është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe u themelua sipas ligjit “Mbi Bankën e Shqipërisë” në vitin 1992. Sipas termave të këtij akti përgjegjësitë kryesore të Bankës janë:

- vendosja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- administrimi i parasë në qarkullim;
- administrimi i normave të interesit;
- parashkimi dhe analiza e treguesve të zhvillimeve ekonomike dhe sociale brenda Republikës së Shqipërisë;
- mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit “Mbi Bankën e Shqipërisë”.

përmbledhje e disa parimeve të rëndësishme kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin” dhe me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“SNK”), me përjashtim të SNK 16 dhe SNK 21. Metodologjia e zbatuar për rivlerësimin e ndërtesës qendrore, siç është detajuar në shënimin 12 nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 16 mbi aktivet fikse, në faktin se rivlerësimi nuk u krye nga vlerësues të pavarur profesionalë, flukset e ardhshme të parasë nuk u skontuan dhe nuk u rivlerësuan të gjitha njësitë përbërëse të kategorisë së ndërtesave. Përjashtimi tjetër ka të bëjë me SNK 21 mbi efektet e ndryshimit të kurseve të huaja të këmbimit në faktin se diferencat e porealizuara nga kurset e këmbimit regjistrohen në llogarinë e rezervës së rivlerësimit, në vend që të kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Parimet kontabël më të rëndësishme, të përdorura nga Banka në përgatitjen e pasqyrave financiare janë detajuar si më poshtë:

(a) Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike e modifikuar duke përfshirë rivlerësimin e valutave të huaja, arit dhe të ndërtesës qendrore.

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, Lek Shqiptar (“LEKË”).

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi, e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të qeverisë që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë dhe prerjen e monedhave prej pesë dhe dhjetë lekë. Aktiviteti financiar i Shtypshkronjës nuk është konsoliduar me ato të Bankës për shkak se aftësia e Shtypshkronjës për të shpërndarë fitimet e saj ndaj Bankës është ende e papërcaktuar. Situata financiare e Shtypshkronjës, më 31 dhjetor 2001, është paraqitur e detajuar në shënimin 24 të pasqyrave financiare.

(b) Interesa dhe komisione

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të ardhurat dhe shpenzimet nga interesa regjistrohen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara.

Të ardhura nga komisione regjistrohen kur të ardhurat janë marrë.

Shpenzime komisioni regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

(c) Konvertimi i valutave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe pasivitet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Fitimi ose humbja e përealizuar nga konvertimi i kurseve të këmbimit regjistrohen tek llogaria rivlerësimi i rezervës.

Kursi zyrtar i këmbimit i zbatuar nga Banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në Lekë) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor paraqitet si më poshtë :

	2001	2000
Dollari amerikan ("USD")	136.55	142.64
Monedha europiane ("Euro")	120.73	132.57
Stërlina angleze ("GBP")	197.87	212.23
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("SDR")	171.46	185.76

(d) Investimet

Investime jo të tregtueshme

Këto investime klasifikohen si më poshtë:

- letra me vlerë të mbajtura deri në maturim;
- letra me vlerë të disponueshme për shitje.

Të gjitha investimet shprehen fillimisht me kosto, që konsiderohet çmimi i blerjes përfshirë shpenzimet e lidhura me blerjen e investimit.

Primet dhe skontot për letrat me vlerë, të mbajtura deri në maturim ose të disponueshme për shitje amortizohen në mënyrë sistematike deri në maturim, duke përdorur metodën e interesit faktik dhe regjistrohen si të ardhura nga interesi.

Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim.

Letrat me vlerë të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktuara dhe që mbahen deri në maturim regjistrohen më pas me koston e amortizuar duke zbritur provigjonet në rast uljeje të vlerës. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo skonto ose prim të përfituar në blerje.

Letra me vlerë të disponueshme për shitje.

Pas vlerësimit të parë, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje rivlerësohen me vlerën reale. Rregullimet që çojnë në vlerën reale raportohen si një llogari e veçantë e kapitalit deri sa investimi shitet ose arkëtohet.

Vlera reale

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara, vlera reale përcaktohet duke ju referuar cmimeve të kuotuar në bursë në datën më të afërt me atë të bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke ju referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë. Vlera reale, gjithashtu, mund të bazohet në fluksin e pritshëm të parasë ose mbi bazën e aktivitetit neto për letrën me vlerë në fjalë.

Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare.

Në çdo datë bilanci bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse ekziston një provë objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare mund të ketë pësuar rënie në vlerë. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë përcaktohet, bazuar në vlerën neto aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë që pritet të merret, dhe njihet si diferencë midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës së mbartur si më poshtë:

- për aktivet financiare të regjistruara me kosto të amortizuara – vlera e mbartur e aktivitetit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; dhe
- për aktivet financiare të regjistruara me vlerë reale – në qoftë se humbja është kaluar direkt në kapital si rezultat i uljes së vlerës së aktivitetit në shumën që vlerësohet të merret prej tij, humbja neto e akumuluar, e kaluar në kapital transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(e) Aktivitetet të qëndrueshme

Aktivitetet e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar me përjashtim të ndërtesës qendrore të Bankës, e cila është vlerësuar më 29 mars 2000 (Shënimi 12).

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivitetet fikse bazuar në koston historike. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivitetit. Jetëgjatësia e zbatuar e vlerësuar sipas llojit të aktivitetit është:

Ndërtesa – godina qendrore	50 vjet
Ndërtesat – në degë	33 vjet
Mjete transporti	5 vjet
Pajisje zyre	10 vjet
Programë kompjuteri	3 vjet

Gjatë vitit 1999 jetëgjatësia e vlerësuar e ndërtesave ishte 33 vjet. Pas vlerësimit të godinës qendrore (Shënimi 12), jetëgjatësia e kësaj ndërtese u vlerësua në 50 vjet. Efekti mbi pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të këtij ndryshimi në vlerësimin kontabël më 31 dhjetor 2000, u pasua me një zvogëlim të shpenzimit të amortizimit më 31 dhjetor 2000 prej 11 milionë lekësh.

(f) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive fikse të grupuara dhe amortizohen respektivisht me dy dhe dhjetë vjet.

(g) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe kërkohet me ligj që 100 për qind e fitimit të kalojë direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(h) Rezerva ligjore

Në përputhje me ligjin “Mbi Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën, 25 për qind e fitimit neto të vitit, transferohet derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të kapitalit themeltar.

(i) Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga Drejtimi i Bankës që të bëhen parashikime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve llogaritur për ngjarje të paparashikuara në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportuar. Ky parashikim bëhet sepse rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

(j) Aktive të administruara

Më 31 dhjetor 2001, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra, të emetuara nga Ministria e Financave si edhe ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të Qeverisë. Më 31 dhjetor 2001 vlera e arit në emër të Qeverisë, e vendosur në depozita jashtë vendit është 2,078 milionë lekë që përfaqësojnë 55,036.5 onz ar nga e cila 36,400.69 onz ar është vendosur në depozita me afat. Po më 31 dhjetor 2001, gjendja e arit dhe e metaleve të tjera të çmuara është 1,221 milionë lekë që përfaqësojnë gjendjen e platinit, të argjendit dhe të metaleve të tjera të çmuara në kasafortë me një shumë prej 110 milionë lekësh si dhe ar i pastandardizuar në 1,111 milionë lekë. Meqë Banka luan rolin e një kujdestari për këto asete, ajo nuk ka asnjë lloj rreziku krediti.

Këto aktive janë përjashtuar nga bilanci i Bankës.

ARI dhe metale të Çmuara

Më 31 dhjetor 2001, vlera e rezervave të arit të vendosura në depozita me afat pronë e Bankës ishte 977 milionë lekë nga e cila 25,885.42 janë shufra onz prej ari. Më 31 dhjetor 2000, vlera e rezervave të arit të standardizuara ishte 970 milionë lekë nga e cila 16,923.778 onz ar të vlerësuar në 658 milionë lekë të vendosura në depozita ari me afat, dhe 8,007.88 onz ar të vlerësuar prej 312 milionë lekë në kasafortë në vend.

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga rivlerësimi i arit janë regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2001, një onz ar u vlerësua me 276.5 usd (2000 – usd 272.65).

Ari dhe metale të çmuara, gjithashtu, përfshin gjendjet e platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 29 milionësh lekë më 31 dhjetor 2001 (2000 – 35 milionë lekë) si edhe ar i pastandardizuar në 3 milionë lekë (2000 – 34 milionë lekë).

Depozita tek fondi monetar ndërkombëtar

Në depozitat e Fondit Monetar Ndërkombëtar përfshihen:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Fondi Monetar Ndërkombëtar	9,708	10,972
Special Drawing Rights (SDR)	11,122	10,836
Totali	20,830	21,808

Depozitat nga Fondi Monetar Ndërkombëtar rezultojnë prej anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kjo shumë është e garantuar me një notë premtimi emetuar nga Qeveria. Depozitat në SDR janë të përafërta me kuotën e anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë paguar Fondit Monetar Ndërkombëtar në SDR dhe në lekë, e cila ka si kundraparti huatë e dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar Republikës së Shqipërisë siç paraqitet në shënimin 13. Depozitat në SDR kanë një interes, i cili është i përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor, 2001 ishte 2.23 për qind.

Depozita në Bankat e huaja

Depozitat në bankat e huaja përbëhen nga:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Llogari rrjedhëse	9,752	10,776
Depozita afatshkurtra	27,042	46,318
Totali	36,794	57,094

Depozitat me afat të shkurtër maturohen midis janarit dhe dhjetorit të vitit 2002, dhe me normë interesi që varion nga 1.69 për qind në 5.29 për qind.

Depozitat në bankat e huaja janë kryesisht në euro, usd dhe dem, të cilat sipas çdo monedhë të huaj ju përgjigjen gjendjeve të mëposhtme:

	2001 (në milionë)	2000 (në milionë)
Euro	153	183
Usd	113	137
Gbp	15	-
Dem	-	118

LETRAT ME VLERË të huaja

Më 31 dhjetor 2001, në letrat me vlerë të huaja përfshihen:

Të disponueshme për shitje	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Investime afatmesme të Bank for International Settlements	19,335	-
Nota të skontuara të Qeverisë Amerikane	9,708	-
Bono thesari të Qeverisë Amerikane	6,807	19,064
Nota thesari të agjencive amerikane	6,103	-
Nota të skontuara të agjencive amerikane	2,811	-
Bono thesari të Qeverisë Franceze	6,531	-
Obligacione thesari të Qeverisë Franceze	638	-
	<u>51,933</u>	<u>19,064</u>
Të tjera		
Investime të tjera	<u>636</u>	<u>648</u>
Totali	<u>52,569</u>	<u>19,712</u>

Investimet afatmesme të Bank of International Settlements përbëhen nga letra me kupona fikse, të përcaktuara në Usd dhe Euro me kurse që variojnë nga 4.6 për qind në 5.5 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore ose gjashtëmujore dhe maturimet variojnë midis qershorit të vitit 2002 në qershor të vitit 2006. *Yield*-i varion nga 2.77 për qind në 4.86 për qind.

Notat e skontuara të Qeverisë Amerikane janë të shprehura në Usd dhe kanë kurse kuponash që variojnë nga 2.75 për qind në 5.75 për qind. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore dhe maturimet variojnë nga dhjetor i vitit 2002 në nëntor të vitit 2006. *Yield*-i varion nga 2.13 për qind në 4.75 për qind.

Bonot e thesarit të Qeverisë Amerikane të shprehura në Usd maturohen në data të ndryshme midis janarit të vitit 2002 dhe qershorit të vitit 2002 dhe janë blerë me *yield*, që varion nga 1.78 për qind në 3.59 për qind.

Notat e thesarit të agjencive amerikane, të shprehura në Usd maturohen në data të ndryshme midis janarit të vitit 2002 dhe qershorit të vitit 2002. *Yield*-i i blerë varion nga 1.84 për qind në 3.74 për qind.

Notat e skontuara të agjencive amerikane janë të shprehura në Usd me kurse kuponi që variojnë midis 4 për qind dhe 5.25 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë gusht 2003 dhe mars 2004. *Yield*-et variojnë nga 3.27 për qind në 4.71 për qind.

Bonot e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në Euro dhe maturohen në data të ndryshme midis shkurtit të vitit 2002 dhe tetorit të vitit 2002. Ato janë blerë me *yield*-e që variojnë midis 3.03 për qind dhe 3.22 për qind.

Obligacionet e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në Euro me një kurs kuponi prej 4.5 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore dhe data e maturimit është korrik i vitit 2006. *Yield*-i është 3.63 për qind.

Zëri "Investime të tjera" përfshin pjesëmarrjen në Bankën Europiane për Rikonstruksion dhe Zhvillim (BERZH), në Bankën Botërore dhe në organizata të tjera dhe Bankën Arabe të Zhvillimit.

AKTIVE TË TJERA TË HUAJA

Më 31 dhjetor 2001, aktive të tjera të huaja përbëhen nga arka në valutë me një vlerë 254 milionë lekë (2000 – 14 milionë lekë) dhe interesi i përlogaritur mbi depozitat në bankat e huaja me një vlerë prej 391 milionë lekësh (2000 - 182 milionë lekësh).

Kredi Tranzite

Kreditë tranzite, sipas sektorëve të industrisë, ndahen si më poshtë:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Bujqësi	1,278	1,405
Industri	4,091	4,144
Sektori i shërbimeve dhe të tjera	885	1,000
Totali	6,254	6,549

Kreditë tranzite përfaqësojnë shërbime krediti pa interes, akorduar institucioneve të kreditit për t'iu shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjeje të programeve qeveritarë të zhvillimit (Shënimi 14). Të gjitha huatë janë të garantuara nga Qeveria Shqiptare.

KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kreditë e dhëna bankave vendase deri më 31 dhjetor 2001 janë në shumën 473 milionë lekë.(2000-asnjë). Këto kredi përbëhen nga 273 milionë lekë kredi afatshkurtër "Lombard" të maturuara më 7 janar 2002 me interes prej 13 për qind dhe nga 200 milionë lekë kredi njëditore të maturuara më 3 janar 2002 me interes prej 9.5 për qind. Këto kredi ishin të siguruara me bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare të mbajtura nga huamarrësit.

KREDI NDAJ QEVERISË

Gjatë vitit 2000 kreditë e dhëna Qeverisë në shumën e 9,429 milionë lekë ishin pa interes. Gjatë vitit 2001 huatë u shndërruan në bono thesari pronësi e Bankës. Gjendja më 31 dhjetor 2001 prej 2,710 milionë lekësh i referohet huave me afat të shkurtër, të maturuara më 10 janar 2002 me një interes prej 9.7 për qind.

Investime në letra me vlerë - VENDASE

Investimet në letrat me vlerë përbëhen nga:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Të disponueshme për shitje		
Bono thesari afatshkurtra	69,070	62,782
Bono thesari me marrëveshje riblerjeje	-	81
	<u>69,070</u>	<u>62,863</u>
Të mbajtura deri në maturim		
Bono thesari për mbulimin e buxhetit të shtetit	-	6,006
Obligacione për ish-kooperativat bujqësore	-	1,958
Obligacione zero kupon për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT")	1,367	1,290
	<u>1,367</u>	<u>1,290</u>
Totali	<u>70,437</u>	<u>72,117</u>

Bono thesari afatshkurtër me 31 dhjetor 2001 lidhen kryesisht me bono thesari zero kupon të Qeverisë Shqiptare që maturohen në periudhën janar - gusht 2002. Këto bono fitojnë interes që nga 7.26 për qind deri në 19.94 për qind.

Letrat me vlerë për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë lëshuar nga Qeveria për të zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në Bankës Kombëtare Tregtare. Letrat me vlerë fitojnë një interes prej 6 për qind në vit dhe maturohen në janar të vitit 2006.

AKTIVE TË TJERA VENDASE

Në aktive të tjera vendase përfshihen:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Interes i përllogaritur	3	-
Debitorë të tjerë	1,597	51
Kredi punonjësve	438	392
Aktive fikse neto	1,433	1,399
Inventari	16	16
Aktive të patrupëzuara, net	419	550
	<u>419</u>	<u>550</u>
Totali	<u>3,906</u>	<u>2,408</u>

Zëri "Debitorë të tjerë" përfshin një vlerë prej 949 milionë lekësh, të arkëtueshme nga Banka e Kursimeve e Shqipërisë për blerjen e eurove në fund të vitit.

AKTIVE TË TJERA VENDASE (VAZHDIM)

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme	Pajisje teknike	Mjete transporti	Pajisje zyre dhe kompjuterike	Totali i aktiveve fikse të qëndrueshme
<u>Kosto/Vlerësimi</u>					
Gjendja më 1 janar 2001	1,284	193	103	113	1,693
Shtesat	36	5	45	59	145
Pakësimet	-	(23)	(2)	-	(25)
Gjendja më 31 dhjetor 2001	1,320	175	146	172	1,813
<u>AMORTIZIMI I AKUMULUAR</u>					
Gjendja më 1 janar 2001	57	106	74	57	294
Shpenzimi vjetor	33	19	14	39	105
Pakësimet	-	(17)	(2)	-	(19)
Gjendja më 31 dhjetor 2001	90	108	86	96	380
<u>VLERA KONTABËL NETO</u>					
Gjendja më 31 dhjetor 2001	1,230	67	60	76	1,433
Gjendja më 31 dhjetor 2000	1,227	87	29	56	1,399

Sipas ligjit shqiptar, titulli i pronësisë së ndërtesës së Bankës është i paqartësuar. Drejtuesit e Bankës janë të mendimit që kjo çështje do të zgjidhet me Ministrinë e Financave në një të ardhme të afërt në favor të Bankës.

Ndërtesa qendrore e Bankës, e përfshirë nën kategorinë 'Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme' ishte rivlerësuar gjatë vitit 2000 në shumën 1,413 milionë lekë nga kosto historike plotësisht e amortizuar prej 7 milionë lekësh. Rivlerësimi u bë më 29 mars 2000, me datë efektive 1 janar 2000, nga një komision i brendshëm vlerësuesish. Vlerësimi nuk u bë mbi bazën e flukseve të ardhshme të parasë të paskontuara, bazuar mbi vlerën e përfaqësuar të tregut të dhënie/marrje me qira të pronësisë së patundshme mbi jetëgjatësinë prej 50 vjetësh. Ndërtesa të tjera të Bankës nuk u rivlerësuan. Teprica e rivlerësimit prej 1,143 milionë lekësh u kreditua tek rivlerësimi i rezervës.

AKTIVE TË TJERA VENDASE (VAZHDIM)

Totali neto i aktiveve të patrupëzuara përbëhet si më poshtë:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Programe kompjuterike dhe të tjera	16	10
Kartëmonedha dhe monedha të shtypura	1,895	1,874
Amortizimi i akumuluar	(1,492)	(1,334)
Total	419	550

Detyrime ndaj fondit monetar ndërkombëtar

Detyrimi ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar përbëhet nga:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Shërbime ndihmëse për rregullime strukturale ("ESAF")	11,360	12,533
Letra me vlerë tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	7,309	8,525
Llogari e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Lekë	1,825	1,825
Totali	20,494	22,883

Huatë e ESAF-it janë të lidhura me kuotizacionin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përbëhen nga këto tre komponentë:

- Huaja fillestare e ESAF-it, e tërhequr në vitin 1993, e cila pritet të shlyhet brenda 10 vjetëve duke filluar që nga viti 1999. Gjendja e kësaj huaje më 31 dhjetor 2001 ishte 16,801,000 SDR (2000– 23,013,000) dhe kjo hua do të shlyhet çdo gjashtë muaj me interes 0.5 për qind.
- Një hua shtesë nën këtë marrëveshje (e njohur si Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit) u tërhoq duke filluar në vitin 1999 dhe vazhdoi edhe gjatë vitit 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2001 ishte 45,040,000 SDR (2000 – 35,630,000 SDR). Kjo, gjithashtu, është një hua 10-vjeçare e kthyeshme deri në vitin 2009 në 10 këste çdo gjashtë muaj duke filluar që nga viti 2004. Norma e interesit për t'u paguar pas periudhës pa interes është 0.5 për qind dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.
- Huaja për Shqipërinë 'Asistenca për Emergjencën Pas Konfliktit': shuma prej 8,825,000 SDR akorduar në vitin 1997 e pagueshme me 8 këste brenda 2 vjetëve pas një periudhe trevjeçare pa interes. Norma e interesit përcaktohet sipas normave të tregut, e cila më 31 dhjetor 2001 ishte 2.62 për qind.

detyrimi ndaj institucioneve financiare jövendase

Detyrimi ndaj institucioneve financiare jövendase përfshin:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Hua tranzite (Shënimi 8)	6,256	6,552
Hua e Bankës së Greqisë	1,063	1,169
Detyrim ndaj Bankës Botërore	218	173
Totali	<u>7,537</u>	<u>7,894</u>

Huaja për zhvillim është dhënë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau në Dem e konvertuar në 5,680 milionë lekë (2000 – 5,891 milionë lekë) dhe nga Banka Europiane e Investimeve në usd dhe euro, e konvertuar në 576 milionë lekë (2000 – 661 milionë lekë). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti ndaj siguruesve të financimit.

Huaja e Bankës së Greqisë (hua e Republikës Greke) është dhënë me qëllim të financimit të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma e interesit është caktuar në vit, 1.17 për qind dhe është e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

paraja në qarkullim

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2001, struktura e mëposhtme e monedhave dhe e kartëmonedhave që ishin në qarkullim:

Vlera nominale	31 dhjetor 2001		31 dhjetor 2000	
	Numri në mijë	Vlera Lekë (në mln)	Numri në mijë	Vlera Lekë (në mln)
1	-	-	20,999	21
3	-	-	6,479	19
5	-	-	6,323	32
10	-	-	7,615	76
100	26,083	2,608	19,495	1,949
200	25,305	5,061	26,924	5,385
500	72,836	36,418	68,713	34,356
1,000	55,597	55,597	48,181	48,181
5,000	4,107	20,535	2,023	10,113
Monedha		<u>1,115</u>		<u>1,277</u>
Totali		<u>121,334</u>		<u>101,409</u>

detyrime ndaj bankave vendase

Më 31 dhjetor 2001, detyrimi ndaj bankave vendase përfshin:

	2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (në mln)
Ne monedha të huaja		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	60	71
Rezervë e detyrueshme e bankave të nivelit të dytë	7,895	6,609
	7,955	6,680
Në monedhë vendase (Lek)		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	22,037	20,656
Bono thesari shitur me marrëveshje riblerjeje	-	5,235
Depozita njëditore	780	-
Të tjera	448	-
	23,265	25,891
Totali	31,220	32,571

Banka paguan interes mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme. Interesi llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në Lekë: 50 për qind e *yield*-it të bonove të thesarit tremujore: 4 për qind me 31 dhjetor 2001 (2,6 për qind më 31 dhjetor 2000);
- gjendjet në Usd: 50 për qind e normës së usd libor njëmujore: 0,94 për qind më 31 dhjetor 2001 (2,2 për qind më 31 dhjetor 2000);
- gjendjet në Euro: 50 për qind e normës së euro libor njëmujore: 1.65 për qind më 31 dhjetor 2001 (1.6 për qind më 31 dhjetor 2000).

Banka nuk paguan interes mbi llogaritë rrjedhëse të bankave të nivelit të dytë.

Depozitat me afat njëditor maturohen më 3 janar 2002 dhe me normë interesi prej 4.5 për qind.

detyrimi ndaj qeverisë

Detyrimi ndaj qeverisë përfshinte:

	2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (në mln)
Fitim për t'u derdhur qeverisë	2,100	
Depozita në emër të qeverisë	531	3,850
Të tjera	103	85
Totali	2,734	3,935

Fitimi për t'u derdhur qeverisë ka të bëjë me pjesën e mbetur të fitimit pa ju derdhur akoma qeverisë në fund të vitit. Ky total i është kaluar qeverisë gjatë marsit 2002 bazuar në vendimin numër 16, të datës 13 mars 2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

detyrimi ndaj qeverisë (VAZHDIM)

Depozita në emër të qeverisë përfaqësojnë fonde të donatorëve ndërkombëtarë, të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri.

Zëri "Të tjera" përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit.

detyrime të tjera vendase

Nga totali i detyrime të tjera vendase prej 155 milionë lekësh (2000 – 110 milionë lekë), shuma prej 112 milionë lekësh (2000 – 84 milionë lekë) lidhet me detyrimin ndaj Shtypshkronjës së kontrolluar nga Banka (Shënimi 24).

REZERVAT E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit në fund të vitit janë si më poshtë:

2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (mln)
(1,159)	3,929
119	232
1,097	1,120
57	5,281

Rivlerësimi i monedhës së huaj dhe arit ;
Rivlerësimi i bonove të thesarit ;
Rivlerësimi i ndërtesës në qendër (Shënim 12).

Total

Rezervat për rivlerësimin e monedhave të huaja dhe arit janë pakësuar në një masë të tillë sa që japin një balancë debitore prej 1,159 milionë lekësh më 31 dhjetor 2001. Kjo balancë debitore ka një natyrë të përkohshme për shkak të një forcimi afatshkurtër të lekut më 31 dhjetor 2001. Pas kësaj date leku është dobësuar kundrejt komponentëve të tjerë të mëdhenj në monedhë të huaj në masë të tillë sa balanca debitore është eliminuar. Në 28 shkurt 2002 kurset e këmbimit të lekut ishin :

	28 shkurt dhjetor	31 2002 2001
Dollari amerikan (Usd)	140.75	
136.55		
Monedha Evropiane (Euro)	121.76	
120.72		
Stërlina angleze (Gbp)	199.28	
197.87		
Të drejta të veçanta tërheqjeje (SDR)	174.67	
171.46		

rezerva të tjera

Përbërësit e rezervave të tjera në fund të vitit, janë si më poshtë:

	2001 Lekë (mln)	2000 Lekë (mln)
Rezervë speciale për Bilancin e Pagesave	7,209	7,209
Fondi i investimit	300	170
Fondi i pensionit për personelin	79	47
Total	7,588	7,426

Rezerva speciale ka të bëjë me një grant të dhënë nga Komuniteti European për Bilancin e Pagesave dhe nuk ka patur lëvizje në këtë rezervë që nga viti 1995. Fondi i investimit dhe ai i personelit janë krijuar nga shpërndarjet e fitimeve të kaluara të Bankës, respektivisht nga vitet 1999 dhe 1998.

të ardhura nga Interesat dhe komisionet (rezidentët)

Të ardhurat nga interesat dhe komisionet përbëhen si më poshtë:

	2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (mln)
Interesa nga huatë qeveritare	35	1,378
Të ardhura nga letrat me vlerë	6,501	6,006
Të ardhura të tjera	92	186
Total	6,628	7,570

të ardhura të tjera operative, neto

Të ardhura të tjera operative përfshin:

	2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (në mln)
Fitimi neto nga shitja e investimeve	70	(1)
Rimarrje të ardhurash nga monedha të nxjerra jashtë qarkullimit.	169	-
Të ardhura të tjera	15	78
Totali	254	77

shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, shpenzimet sociale dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe shpenzime të tjera. Më 31 dhjetor 2001, Banka ka patur 344 punonjës (2000 – 334 punonjës).

PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	2001 LEKË (në mln)	2000 LEKË (në mln)
Depozitat në bankat e huaja – Totali.		
	36,794	57,094
Minus: Depozita me bankat e huaja që maturohen pas 3 muajsh.	(18,805)	(7,655)
	17,989	49,439
Monedha vendase.	6,666	4,591
Monedha të huaja.	254	14
Ari i mbajtur jashtë	977	970
Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend.	32	69
	25,918	55,083
Totali		

Shtypshkronja

Siç është e detajuar në shënimin 2, Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2001 paraqitet si më poshtë:

	2001 Lekë (në mln)	2000 Lekë (në mln)
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	41	41
Inventari	50	62
Klientë	4	1
Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 18)	112	84
Shpenzime për t'u shpërndarë në disa periudha	5	-
	212	188
Totali i aktiveve		
KAPITALI I VET		
Kapitali themeltar	52	52
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i pashpërndarë	110	87
	211	188
Totali i kapitalit të vet		
Detyrime të tjera	1	-
	212	188
Totali i kapitali të vet dhe detyrimeve		

angazhime për ngjarje të paparashikuara

Banka është e përfshirë në një numër çështjesh gjyqësore dhe procedurash ligjore, të ngritura gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit. Drejtimi është i mendimit se këto procedura nuk do të kenë një efekt material në pozicionin financiar apo në rezultatet operative të Bankës.

Nuk ka angazhime të tjera të rëndësishme për ngjarje të paparashikuara.

30. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rreziku i likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë monitorion rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme, duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomikë.

Politikat e administrimit të likuiditetit vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, Banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Rreziku i kreditit

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare.

Rreziku i çmimeve

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe
- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivitetet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilin prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivët që paguajnë interes (siç detajohet në shënimin 27 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivitetet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT
Në LEKË (MLN)

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivët								
Ari	948	29	-	-	-	-	-	977
Depozita tek Fondi Monetar	-	-	-	-	11,122	-	9,708	20,830
Depozita në banka të huaja	17,989	604	13,562	4,639	-	-	-	36,794
Letra me vlerë	4,773	4,927	7,189	6,216	28,828	-	636	52,569
Aktive të tjera të huaja	269	-	333	43	-	-	-	645
Ari dhe metalet e cmuara	-	-	-	-	-	-	32	32
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	6,254	6,254
Kredi ndaj bankave vendase	473	-	-	-	-	-	-	473
Kredi ndaj Qeverisë	2,710	-	-	-	-	-	-	2,710
Investime në Letra me Vlerë	18,485	29,882	20,760	20	1,290	-	-	70,437
Aktive të tjera vendase	3	949	-	637	434	-	1,883	3,906
	<u>45,650</u>	<u>36,391</u>	<u>41,844</u>	<u>11,555</u>	<u>41,674</u>	<u>-</u>	<u>18,513</u>	<u>195,627</u>
Detyrimet dhe kapitali								
Detyrime nga FMN	-	-	-	-	11,360	-	9,134	20,494
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo-vendase	-	-	-	-	-	1,063	6,474	7,537
Detyrime të tjera të huaja	-	-	-	8	-	-	-	8
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	121,334	121,334
Detyrime ndaj bankave vendase	31,220	-	-	-	-	-	-	31,220
Detyrime ndaj Qeverisë	-	-	-	-	-	-	634	634
Detyrime të tjera vendase	155	-	-	-	-	-	-	155
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	14,245	14,245
	<u>31,375</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>8</u>	<u>11,360</u>	<u>(1,063)</u>	<u>151,821</u>	<u>195,627</u>
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2001	14,275	36,391	41,844	11,547	30,314	(1,063)	(133,308)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit- 2001	14,275	50,666	92,510	104,057	134,371	133,308	-	-

KAPITULLI VI – AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

VI.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2001 dhe në vazhdim është përfshirë në një projekt mjaft të rëndësishëm, atë të **implementimit të sistemit të automatizuar të tipit RTGS**.

Implementimi i këtij sistemi, që lidhet me shlyerjen e pagesave ndërbankare në lekë, zë një vend të rëndësishëm në strategjinë e Bankës së Shqipërisë. Ky sistem përbën tashmë një standard që funksionon jo vetëm në vendet e zhvilluara, por ai është implementuar së fundi edhe në shumicën e vendeve të Europës Lindore.

Banka e Shqipërisë, duke e vlerësuar këtë projekt si të një rëndësie të veçantë për të gjithë sistemin financiar e bankar të vendit, kërkoi asistencën teknike e financiare të Bankës Botërore në këtë drejtim.

Si rezultat, Banka Botërore përfshiu në kredinë dhënë Qeverisë Shqiptare për Rindërtimin e Instiucioneve Financiare (projekti FSIBTA) edhe implementimin e një Sistemi Pagesash Ndërbankare të tipit RTGS.

Gjatë vitit 2001, projekti RTGS kaloi fazën e parë të prokurimit të përzgjedhjes së kompanisë, e cila do të realizojë implementimin e këtij sistemi. Si rezultat, u shqyrtuan disa zgjidhje teknike të ofruara dhe u arrit në formulimin e paketës së re të kërkesave të biznesit, e cila përmban të gjitha elementet e një sistemi RTGS bashkëkohor dhe që synon një zgjidhje afatgjatë.

Sistemi që Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë, do t'i sjellë përfitime të rëndësishme sistemit bankar siç janë:

- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të pagesave nëpërmjet përsheptimit dhe eficiencës së qarkullimit të fondeve.*

Bankat dhe klientët e tyre do të kenë mundësinë e kryerjes së pagesave në datëvalutën e tyre, në mënyrë të pakthyeshme. Gjithashtu, sistemi u ofron bankave mundësinë e vendosjes dhe të administrimit të prioritetëve për pagesat e tyre; pra, ato mund të diversifikojnë shërbimet që u ofrojnë klientëve, në varësi të shpejtësisë së shlyerjes së tyre.

- *Krijimi i një baze të sigurt për optimizimin e përdorimit nga ana e bankave të likuiditeteve të tyre.*

Sistemi siguron informacion në kohë reale për gjendjen e llogarisë duke lehtësuar administrimin e likuiditeteve për plotësimin e detyrimeve dhe për investimin e rezervave të tepërta.

Përveç kësaj, krijon mundësinë e përdorimit automatik të lehtësirave kredituese që ofron Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë.

- *Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimet e ardhshme në sistemin e pagesave dhe të tregjeve financiare.*

Implementimi i këtij sistemi krijon bazën e nevojshme për 2 projekte të ardhshme të Bankës së Shqipërisë:

Sistemi i Automatizuar i Kleringut ose siç quhet ndryshe sistemi i pagesave me vlera të vogla, implementimi i të cilit do të jetë vazhdim i implementimit të sistemit RTGS dhe Sistemi i Shlyerjes së Letrave me Vlerë, i cili ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e tregut sekondar të letrave me vlerë.

- *Duke ofruar e siguruar shërbime pagesash konform standardeve ndërkombëtare, synohet përmirësimi i imazhit të Shqipërisë nga këndvështrimi i investitorëve të huaj.*

Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2001, ka vazhduar punën për përmirësimin e **bazës rregullatore** për sistemin e pagesave, ku ndër të tjera mund të përmenden:

Në funksion të standardizimit të instrumenteve të pagesave, u arrit nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërbankare për një metodë të unifikuar **kodifikimi të degëve të bankave** sipas varësisë së degëve të Bankës së Shqipërisë.

Është punuar për t'i paraprirë zhvillimeve në fushën e **pagesave elektronike** me kuadrin e përshtatshëm rregullator jo vetëm për bankat, por edhe për institucionet e tjera financiare.

U punua intensivisht në drejtim të përmirësimit të bazës rregullatore për **përdorimin e çekut**. Në këtë proces morën pjesë aktive të gjitha bankat e nivelit të dytë duke organizuar e bashkërenduar punën me strukturat e Komitetit Kombëtar të Pagesave.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të ofrojë shërbimin e organizimit të kleringut dhe të shlyerjes së pagesave ndërbankare për bankat e nivelit të dytë.

Gjatë vitit 2001 shënohet një rritje e ndjeshme e aktivitetit ndërbankar si në vlerë edhe në volum:

Vlera **totale** e qakullimit për vitin 2001 kapi shifrën 1.899 miliardë lekë (rreth 13.906 milionë dollarë²⁵ ose gati dyfishin e vlerës krahasuar me vitin 2000.

Vlera e transaksioneve të kleruara nëpërmjet **kleringut**, gjatë vitit 2001, ishte 61.8 miliardë lekë (rreth 452.6 milionë dollarë amerikanë). Vlerë, e cila përfaqëson 3.2 për qind të vlerës totale të qarkulluar në llogaritë e bankave.

Vlera e **pagesave ndërbankare**, të kryera gjatë vitit 2001 kundrejt vlerës totale të qarkulluar ndërmjet bankave ishte 5.9 për qind.

Instrumentet, që u përdorën më tepër nga klientët e bankave ishin urdhërpagesa dhe çequet, me një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm prej 13.6 për qind, çfarë dëshmon edhe për një afrim të klientëve në banka.

Vlera e **pagesave** të kleruara në vitin 2001 shënoi një rritje prej 13.6 për qind në krahasim me vitin 2000. Rritjen më të madhe e kanë patur pagesat e bëra nëpërmjet urdhërpagesave, vlera e të cilave kapi shifrën 32.9 miliardë lekë (rreth 241 milionë dollarë) dhe përfaqëson një rritje prej 17 për qind në krahasim me vitin 2000. Pagesat me çek, gjithashtu, kanë pësuar rritje (9.6 për qind) kundrejt një viti më parë.

Tabelë VI-1: Volumi i transaksioneve të kleruara në seancat e kleringut gjatë vitit 2001.

Instrumenti	Numri (në njësi fizike)			Vlera (në miliardë lekë)		
	1999	2000	2001	1999	2000	2001
Urdhërpagesa	53357	57500	63000	25.6	28.0	32.9
Çeqe	6000	6500	6700	24.4	26.3	28.9
Totali	59357	64000	69700	50.0	54.4	61.8

Tabelë VI-2: Vlera mesatare e instrumenteve të pagesës (në milionë lekë).

Instrumenti	Për instrument			Mujore		
	1999	2000	2001	1999	2000	2001
Urdhërpagesa	0.5	0.5	0.52	2136.8	2337	2743
Çeqe	4.1	4.1	4.3	2031.0	2195	2407
Totali				4167.9	4532	5150

25. Kursi në fund të vitit 2001 ishte 1 usd= 136,55 lekë.

VI.2. EMISIONI I MONEDHËS

Gjendja e treguesve të monedhës më 31.12.2001, rezulton si më poshtë:

Emisioni	128.000.000.000,00	lekë
Monedha në qarkullim	121.333.521.693,00	“


Emisioni i monedhës, për vitin 2001, u shtua me 22 miliardë lekë, duke mbajtur parasysh plotësimin e nevojave të ekonomisë për para në një strukturë optimale.

Monedha në qarkullim, rezultoi në shumën 121.333.521.693,00 lekë. Krahasuar me fundvitin 2000, ajo është rritur me 19,9 miliardë lekë ose 19,6 për qind. Rritjen më të madhe e ka pësuar në muajin dhjetor, me 11,1 miliardë lekë ose 55,7 për qind të të gjithë shtesës vjetore, nga e cila rreth 6 miliardë lekë është efekti i ndërhyrjes në treg të Bankës së Shqipërisë për blerje valute.


Tabelë VI-3: Ndryshimet mujore të monedhës në qarkullim, viti 2001 (në miliardë lekë).

Nr.	M u a j t	Mujore	Progresive prej fillimit të vitit
1	Janar	- 1457	- 1457
2	Shkurt	- 2639	- 4096
3	Mars	+ 647	- 3449
4	Prill	1 812	- 1637
5	Maj	+ 1129	- 508
6	Qershor	+ 3533	+ 3025
7	Korrik	+ 2408	+ 5433
8	Gusht	+ 1906	+ 7339
9	Shtator	+ 419	+ 7758
10	Tetor	+ 89	+ 7847
11	Nëntor	+ 957	+ 8804
12	Dhjetor	+ 11120	+ 19924

Grafik VI-1: Ndryshimi i gjendjes së monedhës në qarkullim, progresiv prej fillimit të vitit 2001.



Grafik VI-2: Ndryshimi i gjendjes së monedhës në qarkullim për çdo muaj të vitit 2001.



Disa nga faktorët, që vlerësohet të kenë ndikuar në shtesën e monedhës në qarkullim, janë:

- ulja kundrejt fundvitit 2000, e interesave bankare për depozitat me afat në lekë dhe në valutë;
- stabilizimi, në përgjithësi, i kursit të këmbimit dhe niveli i ulët i inflacionit, kanë shtuar besimin e publikut tek monedha kombëtare;
- plotësimi i nevojave të konsumit nga popullata dhe pagesat për qëllime tregtare, kryesisht ato brenda vendit, megjithë zhvillimet, akoma në një masë të konsiderueshme vazhdojnë të kryhen në *cash* etj.;
- hyrja fizike e euros, e cila u shoqërua me ndërhyrje të Bankës së Shqipërisë për të mos lejuar mbiqim artificial të lekut.

Tabelë VI-4: Struktura e monedhës në qarkullim (në %).

Prerjet	1999	2000	2001
5000	0.25	0.98	2.23
1000	21.00	23.30	30.23
500	33.37	33.23	39.60
200	14.44	13.02	13.76
100	9.29	9.43	14.18
10	4.00	3.68	0.0
5	3.32	3.06	0.0
3	3.38	3.13	0.0
1	10.95	10.16	0.0
Totali kartëmonedha	100.00	100.00	100.00
100	0.00	1.98	4.80
50	7.23	4.04	14.96
20	10.11	5.92	26.09
10	10.82	6.57	28.83
5	7.68	4.51	18.94
2	0.26	0.12	0.0
1	10.27	5.00	6.38
0.5	8.71	4.21	0.0
0.2	18.84	9.11	0.0
0.1	22.01	10.65	0.0
0.05	4.08	1.97	0.0
Totali monedha metalike	100.00	100.00	100.00

Mbështetur në studimin e kryer në muajin shkurt 2001 “Për plotësimin e kërkesave afatshkurtra të ekonomisë për para” dhe për ndjekjen e këtij problemi gjatë vitit 2001, struktura e monedhës në qarkullim shënoi përmirësime, duke plotësuar më mirë kërkesat e ekonomisë dhe duke u bërë njëkohësisht, më e pranueshme për publikun dhe qarkullimin e parasë. Kështu, në strukturën e monedhës në qarkullim u rrit peshën e kartëmonedhës të prerjes 5 mijë lekë²⁶ duke ulur peshën e kartëmonedhave të prerjeve 1 mijë lekë, 500 lekë dhe 200 lekë.

Sa i takon fenomenit të falsifikimit të kartëmonedhës, ai është i pranishëm edhe gjatë vitit 2001, por me përmasa më të ulta. Konkretisht, krahasuar me vitin 2000, falsifikimi, në total dhe për çdo prerje, është ulur ndjeshëm.

²⁶ Kartëmonedha e prerjes 5 mijë lekë është relativisht e re në qarkullim. Ajo është hedhur në qarkullim me kurs ligjor më 1 janar të vitit 1999.

Tabelë VI-5: Të dhëna mbi falsifikimin e kartëmonedhave.

Prerjet në lekë	2000 (në cope)		2001 (në cope)		Në %	
	Viti	Progresive nga 1992	Viti	Progresive nga 1992	2001 / 20000	(1992-2001) / (1992-2000)
1000	747	10796	438	11234	58.6	104.1
500	1487	4750	954	5704	64.2	120.1
200 lekë	834	944	259	1203	31.1	127.1
100 lekë	6	6	1	7	16.6	116.6
Gjithsej	3074	16496	1652	18148	53.7	110.0

Më të ekspozuara ndaj falsifikimit, vazhdojnë të jenë prerjet 1000 lekë dhe 500 lekë, emetime të viteve 1994 e 1996 dhe, veçanërisht këtë vit, prerja 200 lekë, emetim i vitit 1996, gjithnjë me fotokopje dhe shtyp offset.

Sa i takon kartëmonedhave të huaja të falsifikuara, kryesisht lireta italiane, drahmi greke dhe marka gjermane, sasia e tyre është e pakonsiderueshme.

VI.3. INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

VI.1.3. Integrimi në kuadrin e bisedimeve për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

Shqipëria është një nga pesë vendet e Europës Lindore, që merr pjesë në procesin e Stabilizim Asocimit me Komunitetin Europian²⁷. Ky proces është i hartuar për të ndihmuar vendosjen e stabilitetit në rajon duke integruar çdo vend në strukturat europiane dhe duke u ofruar perspektivat e anëtarësimit të ardhshëm në Bashkimin Europian. Bashkimi Europian është përfshirë në mënyrë aktive në mbështetjen e reformave në Shqipëri që në vitin 1991 dhe mbështet prioritetet që qeveritë shqiptare kanë përcaktuar për integrimin europian. Në takimin e Zagrebit, të vitit 2000, u vendos që të krijohet një grup i nivelit të lartë i Bashkimit Europian dhe Shqipërisë, i cili do të kryente një vlerësim të ri për mundësitë e Shqipërisë për të marrë angazhime për një Marrëveshje Stabilizim Asocimi. Në këto vlerësime u ra dakord që të ndiqeshin rekomandime që mbulojnë fushën politike, ekonomike, financiare dhe faktorët rajonalë.

Tabelë VI-6: Progresi i negociatave për pranimin në BE të disa vendeve.

Vendi kandidat	Ekonomi tregu	Të aftë për të konkurruar në BE	Kapitujt e mbyllur, rregullat e adoptuara
Bullgaria	Mbyllur	Me kusht	12
Qipro	Po	Po	2
R. Çeke	Po	Me kusht	2
Estonia	Po	Me kusht	19
Hungaria	Po	Me kusht	22
Letonia	Po	Me kushte të forta	18
Lituania	Po	Me kushte të forta	18
Malta	Po	Po	18
Polonia	Po	Me kusht	18
Rumania	Jo	Jo	8
R. Sllovake	Po	Me kushte të forta	20
Sllovenia	Po	Me kusht	21

Burimi: Komisioni i BE, revista "Global Finance", janar 2002

Për Shqipërinë, deri në shtator të vitit 2001, përgjegjëse për ndjekjen e procesit të bisedimeve ka qenë Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërkohë, duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi u krijua Ministria e Integritimit Europian. Një grup i quajtur "task force" është ngritur me koordinatore nga të gjitha institucionet qendrore, dhe Banka e Shqipërisë është anëtare e këtij grupi me përgjegjësinë për të

²⁷ Shtetet e tjera janë FYROM, Republika Federative e Jugosllavisë, Republika e Bosnje-Hercegovinës dhe Republika e Kroacisë.

koordinuar sistemin bankar, politikën monetare, mbikëqyrjen dhe aspektet ligjore, të domosdoshme për një sistem efektiv financiar. Detyra kryesore në bisedimet me Komunitetin Europian është diskutimi i marrëveshjeve për Paktin e Stabilitetit midis vendeve të rajonit të Ballkanit, duke realizuar fillimisht integrimin rajonal dhe më pas atë europian. Në takimet e nivelit të lartë të grupeve konsultative Banka e Shqipërisë ka dhënë kontributin e saj në fushat e:

- licencimit të bankave dhe institucioneve financiare jobankare të huaja;
- bashkëpunimit në luftën kundër pastrimit të parave;
- përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Europian dhe reformës legjislative;
- komentëve rreth bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare, qëndrueshmërisë ekonomike duke përfshirë liberalizimin e tregtisë, investimeve të huaja direkte, lëvizjes së lirë të kapitalit;
- politikës monetare dhe inflacionit;
- bilancit të pagesave etj..

VI.2.3. Marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare dhe me bankat e huaja.

Viti 2001, ishte viti i fundit i marrëveshjes afatmesme të mbështetjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në bazë të artikujve që rregullojnë marrëveshjet e anëtarësimit dhe konsultimet midis vendit anëtar dhe delegacioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, u zhvilluan dy diskutime për Shqipërinë nga drejtorët ekzekutivë të këtij institucioni në Ëashington. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2001 përfundoi edhe procesi paraprak i diskutimeve për strategjinë e uljes së varfërisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Siç dihet, ky proces filloi menjëherë pas kalimit në programin me të njëjtin emër gjë që u realizua gjatë programit të mbështetjes afatmesme 1998 – 2001. E reja në këto diskutime, ishte rritja e bazës së pjesëmarrjes dhe koordinimi me përfshirjen në proces jo vetëm të institucioneve, por edhe të shoqërisë civile.

VI.2.3.1 Marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2001, u zhvilluan në muajt prill dhe korrik konsultimet me misionet e Departamentit për Çështjet Europiane të Fondit Monetar, të cilat u përqendruan në programin afatmesëm në kuadër të Marrëveshjes për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF 2) si dhe në zhvillimet në ekonomi, ato monetare, në bilancin e pagesave, në mbikëqyrjen bankare e në sistemin bankar. Në vijim të diskutimeve nga ana e Bordit Ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtar rreth konkluzioneve të misioneve të EU1, gjatë këtij viti u miratuan në kuadrin e PRGF 2, dy disbursimet e fundit me nga sdr 4,705,000 secila, të livruara në 01.03.2001 dhe në 18.07.2001.

Veç kësaj, në muajt maj e shtator, misione të asistencës teknike nga Departamenti i Çështjeve Monetare dhe të Këmbimit të Fondit Monetar

Ndërkombëtar, ofruan asistencë teknike në lidhje me modelet e parashikimit të likuiditetit të qeverisë duke instaluar një program të përpunimit të të dhënave në sistemin “*book entry*” të bonove të thesarit që përdoret në shumë vende, në lidhje me kalimin në strategjinë monetare të “*inflation targeting*”, në lidhje me kuadrin operacional të politikës monetare etj..

VI.2.3.2 Marrëdhëniet me Grupin e Bankës Botërore.

Në marrëdhëniet me grupin e Bankës Botërore, veç kredive dhe mbështetjeve me projekte të ndryshme për vendin, Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2001, vlerëson punën paraprake të bërë në kuadrin e kredisë për axhustimin e sektorit financiar në Shqipëri (Financial Sector Adjustment Credit), shërbimin e konsulencës në fushën teknike për realizimin e dy projekteve:

- a) të kontabilitetit dhe administrimit të rezervës valutore;
- b) të sistemit RTGS;

dhe përgatitjet për projektin e sistemit të kleringut e të pagesave.

Ndërkohë, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) për aksionet aktuale të saj në bankat e sistemit tonë dhe për mundësi në pjesëmarrje të reja gjatë procesit të privatizimit.

Po kështu, gjatë vitit 2001 dy misione të Bankës Botërore, njëri për Mbikëqyrjen Bankare dhe tjetri për Sektorin Financiar, kanë ofruar ndihmesën e tyre në drejtim të përgatitjes së planit strategjik afatmesëm e afatgjatë të zhvillimit të Departamentit të Mbikëqyrjes, të përgatitjes së akteve rregullative lidhur me kujdestarinë dhe me administrimin e bankave, të zhvillimit të institucioneve financiare jobanka dhe për çështje të privatizimit të Bankës së Kursimeve.

Banka e Shqipërisë, në procesin e koordinimit me institucionet e vendeve të tjera në dobi të zhvillimit të saj është asistuar nga fondacione si FSVC, GTZ dhe USAID duke realizuar vizita të ndërsjellta të konsulentëve amerikanë dhe gjermanë në Shqipëri dhe të specialistëve tanë në institucione të këtyre vendeve.

VI.2.3.3 Marrëdhëniet ndërrajonale.

Në kuadrin e Klubit të Guvernorëve të Bankave Qendrore të vendeve të Rajonit të Ballkanit dhe të Detit të Zi, Guverneri i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë në dy mbledhjet e rradhës, të zhvilluara në muajt maj në Athinë dhe tetor në Rodos të Greqisë. I krijuar në vitin 1998 dhe me një karakter joformal, ky Klub ka për qëllim të nxisë bashkëpunimin rajonal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës më të mirë e trajtimit në tryeza të rrumbullakta në nivel guvernatorësh ose specialistësh, të çështjeve bashkëkohore. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi ishte edhe vizita zyrtare dhe takimet që Guverneri e Bankës së Shqipërisë zhvilloi në Bankën Qendrore të Republikës Turke me Ministrin e Shtetit për Thesarin dhe

Autoritetin e Mbikëqyrjes Bankare të Turqisë, ku u nënshkrua midis dy institucioneve edhe Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes bankare. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi si dhe nisur nga synimet dhe detyrat kryesore afatshkurtra të Bankës së Shqipërisë, janë kryer vizita pune në nivel drejtuesish në banka qendrore me dimensione dhe histori të ngjashme me tonën, që ofrojnë eksperiencë të suksesshme në këtë drejtim, siç janë Bankat Qendrore të Bosnjë-Herzegovinës, të Hungarisë dhe ajo e Rumanisë për çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, me kontrollin e brendshëm, të kontabilitetit, me hartimin e monitorimin e buxhetit.

Ky vit shënoi edhe hapat e parë në marrëdhëniet ndërinstitucionale midis Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit për Banka dhe Pagesa të Kosovës, të cilët nisën me takimin midis titullarëve të dy institucioneve për t'u sanksionuar gjatë vitit që vjen në Protokollin e Bashkëpunimit.